



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 107

Tiranë – E martë, 6 korrik 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 65/2021, datë 20.5.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 9891
Ligj nr. 73/2021, datë 3.6.2021	Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë..... 9895
Ligj nr. 74/2021, datë 3.6.2021	Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil..... 9925
Ligj nr. 78/2021, datë 14.6.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për projektin “Aftësi për punë”, faza 2, 2019–2023..... 9956
Dekret i Presidentit nr. 13119, datë 28.6.2021	Për shpallje ligji..... 9963
Vendim i Kuvendit nr. 59/2021, datë 24.6.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 13 103, datë 11.6.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 65/2021, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, ‘Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”..... 9963
Rezolutë e Kuvendit datë 24.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2020..... 9964
Rezolutë e Kuvendit datë 24.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020..... 9966
Rezolutë e Kuvendit datë 24.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2020..... 9967
Rezolutë e Kuvendit datë 24.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2020..... 9968
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 30.6.2021	Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik..... 9970

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 30.6.2021	Për miratimin e rregullores “Për zhvendosjen (evakuimin), shmangien dhe risistemimin e dokumenteve në kohë të veçantë”.....	9970
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 30.6.2021	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Librazhd, për Njësinë Administrative Librazhd, të pasurisë 8/73, zona kadastrale 2446, dhe për një shtesë në vendimin nr. 1086, datë 28.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Librazhd, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.....	9974
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 388, datë 30.6.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	9977
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 30.6.2021	Për përcaktimin e kriterëve të hollësishme për miratimin dhe kompetencat e trupave certifikuese.....	9977
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 30.6.2021	Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme, kriterëve dhe procedurave specifike për marrjen me qira të ambienteve dhe lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.....	9978
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 7, datë 15.6.2021	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 9, datë 17.6.2020, “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”.....	9983
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 139, datë 2.7.2021	Për delegim kompetencash.....	9985
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 16.6.2021	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë W.T.S.-Energji sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.7.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.....	9985
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturë dhe Energjisë nr. 118/10, datë 6.7.2021	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi projektit “Rigjenerim urban i shëtitorës bregdetare qendrore të Vlorës, sheshit “Isa Boletini” dhe Portit, Bashkia Vlorë”.....	9986



LIGJ
Nr. 65/2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010,
“PËR SEKTORIN MINERAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 19 pas fjalëve “nuk lejohet” shtohen fjalët “kryerja e veprimtarive minerare për lejet ekzistuese dhe”.

2. Në pikën 23 pas fjalës “mineralit” shtohet fjala “të thatë”.

3. Në pikën 32 pas fjalëve “Kadastra minerare” shtohen fjalët “krijohet nga heqja e sipërfaqes nga fondi pyjor e kullësor dhe”; dhe pas fjalëve “zonat e lejuara minerare” shtohen fjalët “të cilat regjistrohen pas heqjes nga fondi pyjor e kullësor.”.

4. Në pikën 37 fjalët “çdo vit” hiqen.

Neni 2

Në nenin 3, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Shteti, për efekt të zbatimit të këtij ligji, përfaqësohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.”.

Neni 3

Në nenin 5, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Sipas nenit 8 të këtij ligji:

a) lejet minerare në zonat minerare, të përcaktuara në programin vjetor minerar si zona konkurruese, u jepen subjekteve të interesuara, fituese të një konkurrimi publik;

b) leja minerare në zonat minerare, të përcaktuara në programin vjetor minerar si zona të hapura, i jepet subjektit që plotëson kushtet e lejimit sipas parimit “i pari në kohë, i pari në të drejta.”.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 4 pas fjalëve “ministria dhe” shtohen fjalët “pas këshillimit me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, zonat e mbrojtura, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse,”.

2. Në pikën 6 fjalët “pas këshillimit me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse” hiqen.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, paragrafi i parë, pas fjalës “teknik” shtohet fjala “mjedisor”.

2. Në pikën 2, shkronja “b”, fjalët “nuk i ka shndërruar në leje shfrytëzimi, edhe pse ka zbuluar rezerva minerare me interes publik” zëvendësohen me fjalët “ka realizuar punimet e investimit sipas projektit, ka zbuluar rezerva me interes ekonomik, ka dorëzuar raport gjeologjik, por nuk ka kërkuar për ta shndërruar në leje shfrytëzimi.”.

3. Në pikën 3 në paragrafin e fundit fjalët “deri në një vit” zëvendësohen me fjalët “ai i përcaktuar në pikën 1 të nenit 14 të këtij ligji”.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 4 në shkronjën “b” fjalët “së paku 90 për qind” zëvendësohen me fjalët “deri në 90 për qind”.



2. Në pikën 4 në shkronjën “c” fjalët “fillimit të vitit të katërt të” zëvendësohen me fjalët “zgjatjes së”.

Neni 7

Në nenin 14 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 fjalitë “Afat i vlefshmërisë mund të zgjatet 2 herë me kërkesë të zotëruesit të lejes. Çdo zgjatje ka afat 1-vjeçar.” zëvendësohen me fjalinë “Afat i vlefshmërisë mund të zgjatet 1 herë me kërkesë të zotëruesit të lejes, për një periudhë 1-vjeçare”.

2. Në pikën 4 fjalja e fundit hiqet.

Neni 8

Në nenin 16, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Zgjatja e afatit miratohet në rast se zotëruesi i lejes së shfrytëzimit i ka plotësuar më parë detyrimet financiare, ka kryer investimet e parashikuara në programin e punës në përputhje me lejen e dhënë, paraqet një program pune shtesë, bindës për ministrin, për vazhdimin e mëtejshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit dhe kur vazhdimi i shfrytëzimit nuk bie ndesh me projekte të tjera që kanë interes publik ose me planifikimin e shpalljes së zonave të reja të mbrojtura.”.

Neni 9

Në nenin 17 në pikën 1, shkronja “d”, fjalët “procedurave të përcaktuara në këtë ligj” zëvendësohen me fjalët “pikës 1 të nenit 17/1 të këtij ligji”.

Neni 10

Në nenin 18 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimi dhe shtesat si më poshtë:

a) në shkronjën “b” fjalët “3 muaj” zëvendësohen me fjalët “6 muaj kalendarikë”; dhe fjalët “tremujorit përkatës” zëvendësohen me fjalët “gjashtëmujorit përkatës kalendarik”;

b) në shkronjën “c” pas fjalës “vit” shtohet fjala “kalendarik”;

c) në shkronjën “ç” në fund shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për lejet e shfrytëzimit me tri koordinata, subjektet duhet të paraqesin planin vjetor të punës, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit kalendarik.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 11

Në nenin 19, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Leja e kërkim-zbulimit ka afat vlefshmërie 1 (një) vit nga hyrja në fuqi e saj, me të drejtë shtyrjeje për 1 (një) vit, me sipërfaqe jo më shumë se 50% të sipërfaqes fillestare.”.

Neni 12

Në nenin 20, në pikën 1 shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) t'i paraqesë strukturës përgjegjëse, në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes, raportin gjeologjik tekniko-ekonomik me një informacion të detajuar për punimet e kryera në zonën e lejuar, investimet e realizuara, rezultatet e provave të marra, sasinë e rezervave dhe materialin grafik ilustrues.”.

Neni 13

Në nenin 22, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Shfrytëzimi i karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligji, bëhet nga subjekti ose subjektet e krijuara nga njësia e qeverisjes vendore, në pronësi dhe në juridiksionin e së cilës ndodhet karriera ose subjekti apo subjektet pjesëmarrëse në realizimin e projektit, të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare, por vetëm pas pajisjes së tyre me leje shfrytëzimi, sipas procedurave të këtij ligji.”.

Neni 14

Në nenin 23, në pikat 1, 3 dhe 5 fjalët “ose subjektit, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare” zëvendësohen me fjalët “subjektet pjesëmarrëse në realizimin e



projektit, të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare”.

Neni 15

Në nenin 24 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 fjalët “të përcaktuar, dhe” hiqen.
2. Në pikën 6 fjalët “është subjekt i një shtese” zëvendësohen me fjalët “me të drejtë shtyrjeje”.

Neni 16

Në nenin 25 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjën “b” fjalët “3 muaj” zëvendësohen me fjalët “6 muaj kalendarikë”; dhe fjalët “tremujorit përkatës” zëvendësohen me fjalët “gjashtëmujorit përkatës kalendarik”.

2. Në shkronjën “c” pas fjalës “vit” shtohet fjala “kalendarik”.

3. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) të njoftojë ose të japë informacione dhe shpjegime, jo më pak se 1 vit para, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar;”.

4. Pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe paragrafi i fundit me këtë përmbajtje:

“dh) të njoftojë jo më pak se 90 ditë kalendarike më parë nëse kërkon ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar;

e) të njoftojë jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë nëse kërkon ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasinë e prodhimit të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse;

ë) t’i raportojë strukturës përgjegjëse, në përfundim të afatit të së drejtës së shfrytëzimit, me një informacion të hollësishëm, siç parashikohet në aktet nënligjore të miratuara nga ministri, për investimet e realizuara gjatë shfrytëzimit, për punimet minerare të kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike;

f) të ketë personel të kualifikuar teknik gjatë gjithë kohëzgjatjes së lejes së shfrytëzimit.

Njoftimi, sipas shkronjave “d”, “dh” dhe “e” të këtij neni, duhet të përmbajë një informacion të hollësishëm për arsyet e pushimit, pezullimit ose të uljes së prodhimit.”.

Neni 17

Në nenin 27, pika 2, shkronja “b”, fjalët “3 muaj” zëvendësohen me fjalët “6 muaj kalendarikë”; dhe fjalët “tremujorit përkatës” zëvendësohen me fjalët “gjashtëmujorit përkatës kalendarik”.

Neni 18

Në nenin 29 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

- a) fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Lejet minerare, të parashikuara në kreun III të këtij ligji, u jepen subjekteve, personave juridikë, që.”

- b) Në fund të shkronjës “c” shtohen fjalët “ose kanë bashkëpunim me një subjekt tjetër me përvojë në fushën minerare.”.

2. Në pikën 3 fjalët “dhe “ë”” hiqen.

Neni 19

Në nenin 30 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 4 fjalët “që përfshijnë shfrytëzimin” zëvendësohen me fjalët “minerare të kërkim-zbulimit, kërkim-zbulim-shfrytëzimit apo të shfrytëzimit”.

2. Në pikën 8 fjalët “që përfshijnë shfrytëzimin” zëvendësohen me fjalët “e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim-shfrytëzimit”.

3. Në pikën 9 fjalët “që përfshijnë kërkim-zbulimin” hiqen.

Neni 20

Në nenin 31 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) në fjalinë e dytë fjalët “çdo vit” hiqen;

- b) në fjalinë e tretë fjalët “Kjo vlerë” zëvendësohen me fjalët “Vlera e saj llogaritet në 10 për qind të vlerës totale të investimit”;

- c) në fjalinë e katërt fjalët “dhe vlera e investimit me afatet për lejet e shfrytëzimit” hiqen.

2. Në pikën 3 fjalët “20 ditëve” zëvendësohen me fjalët “30 ditëve”.

3. Pikat 9 dhe 10 ndryshohen si më poshtë:



“9. Vlera e garancisë financiare për realizimin e investimit për lejet e kërkim-zbulimit i kthehet zotëruesit të lejes në fundin e periudhës së investimeve të përcaktuara sipas programit minimal të punës, kur vlera e investimit është realizuar mbi 90 për qind dhe brenda afatit kohor të parashikuar, pas hartimit të raportit të detajuar të strukturave përgjegjëse e të miratuar nga ministria.

Kthimi i plotë i garancisë financiare të investimit bëhet kur investimi është realizuar 100 për qind dhe brenda afatit kohor të parashikuar.

Kthimi i pjesshëm i garancisë financiare të investimit bëhet kur vlera e investimit është realizuar brenda afatit dhe në nivelin mbi 90 për qind. Në këtë rast kthimi i pjesshëm i garancisë financiare të investimit bëhet në përputhje me përqindjen e realizimit të investimit.

10. Kur zotëruesi i lejes minerare të kërkim-zbulimit ka dështuar në përmbushjen e kushteve të përcaktuara në paragrafin e parë të pikës 9 të këtij neni, atëherë vlera e plotë e garancisë financiare të investimit kalon në favor të shtetit.

Miratimi i formës, i rasteve të kthimit dhe i mënyrës së llogaritjes të garancive financiare përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 21

Në nenin 34, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Në rastet kur në veprimtarinë minerare të një zonë të lejuar minerare krijohen probleme në marrëdhënie me pronarin e tokës, sipërfaqja e zonës së lejuar të lejes minerare shpronësohet. Kriteret dhe procedura e shpronësimit përcaktohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për shpronësimet me interes publik.

Në këtë rast zotëruesi i lejes minerare duhet të aplikojë brenda 30 ditëve për shpronësimin e sipërfaqes përkatëse.

Ministria ka të drejtë të pezullojë lejen minerare në rast se vërtetohet se problematika e marrëdhënies së tokës është e tillë që pengon ushtrimin e të drejtës minerare. Pezullimi vijon deri në përfundimin e procedurave të shpronësimit ose vendimit të formës së prerë të gjykatës që përcakton vlerën e dëmit.”.

Neni 22

Në nenin 35 në pikën 3 në fund shtohen paragrafët si më poshtë:

“Në rastet kur në veprimtarinë minerare të një zone të lejuar minerare krijohen probleme në marrëdhënie me pronarin e tokës së pronës fqinje, kjo sipërfaqe mund të shpronësohet. Kriteret dhe procedura e shpronësimit përcaktohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për shpronësimet me interes publik.

Ministria ka të drejtë të pezullojë lejen minerare në rast se vërtetohet se problematika e marrëdhënies së tokës është e tillë që pengon ushtrimin e të drejtës minerare. Pezullimi vijon deri në përfundimin e procedurave të shpronësimit ose vendimit të formës së prerë të gjykatës që përcakton vlerën e dëmit.”.

Neni 23

Në nenin 40, pika 2, pas fjalës “mineralit” shtohet fjala “të thatë”.

Neni 24

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

Transferimi i të drejtave minerare nga zotëruesi

1. Lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, janë të transferueshme vetëm pas një periudhe 5-vjeçare nga data e dhënies së lejes dhe transferohen vetëm pas miratimit paraprak të ministrit. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm. Lejet minerare për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese nuk janë të transferueshme.

2. Lejet e tjera minerare, të dhëna sipas procedurave të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994, “Ligji mineralar i Shqipërisë”, të ndryshuar, janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm.

3. Miratimi ose refuzimi i ministrit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet brenda një afati prej 60 ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës së transferimit nga zotëruesi i lejes minerare.



4. Kriteret dhe rregullat e transferimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

5. Akti i transferimit depozitohet pranë strukturës përgjegjëse dhe transferimi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve si ndryshime të titullit të lejes, duke e plotësuar me të dhënat e identifikimit të zotëruesit të ri. Data e transferimit është data e regjistrimit. Akti i transferimit depozitohet edhe në regjistrin minerar.

6. Ndërtimet dhe instalimet e tjera, që mbështesin operacionet kryesore, vlerësohen si veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës minerare dhe transferohen bashkë me të.

Neni 25

Në nenin 57, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për të drejtat minerare të fituara në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994, “Ligji minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar, sipërfaqja e zonës së lejuar dhe afati i miratuar nuk ndryshojnë me hyrjen në fuqi të këtij ligji deri në përfundim të afatit të miratuar.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve metalore ka të drejtën e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë dy herë: shtesa e parë me të drejtë shtyrjeje 10 vjet dhe shtesa e dytë me të drejtë shtyrjeje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohej çdo herë të paktën 365 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore ka të drejtën e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë tri herë: shtesa e parë me të drejtë shtyrjeje 10 vjet, shtesa e dytë me të drejtë shtyrjeje 10 vjet dhe shtesa e tretë me të drejtë shtyrjeje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohej çdo herë të paktën 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Afati i aplikimit është prekluziv dhe me kalimin e këtij afati zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit.

Në çdo rast të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan të hollësishëm me afate për zhvillimin e veprimtarisë minerare, në bazë të kërkesave të legjislacionit minerar në fuqi. Ky plan përfshin tërësinë e dokumentacionit teknik, ekonomik, financiar, social, mjedisor, si dhe vlerën

e investimit me afatet për lejet e shfrytëzimit, duke garantuar financimin për realizimin e tij.

Plani miratohet nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tij. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Përmbajtja e planit të punës dhe dokumentet e tjera të nevojshme që e shoqërojnë duhet të jenë në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga ministri.”.

Neni 26

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 20, pika 3, dhe 24, pika 4, të tij.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.5.2021.

LIGJ

Nr. 73/2021

PËR HEDHJEN NË TREG DHE MBIKËQYRJEN E ARTIKUJVE PIROTEKNIKË¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

- Direktivën 2013/29/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 12 qershor 2013, “Për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të artikujve piroteknikë”. Numri CELEX 32013L0029, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 178, datë 28.06.2013, f. 27-65.



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton:

1. Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të artikujve piroteknikë, në mënyrë që të garantojnë e të sigurojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore, mbrojtjen e interesave të publikut, shëndetit e sigurisë së njerëzve dhe konkurrencën e drejtë në tregun vendas.

2. Kushtet dhe kriteret për prodhimin, tregtimin, transportimin, transferimin, magazinimin, përdorimin, importimin, eksportimin, tranzitim, asgjësimin, kërkimin, testimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së artikujve piroteknikë, si dhe kriteret për mbikëqyrjen dhe aplikimin e këtij ligji, me qëllim mbrojtjen e njerëzve, pasurisë dhe mjedisit.

3. Mënyrën e organizimit, të drejtat dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për kontrollin, mbikëqyrjen dhe sigurinë gjatë zinxhirit të furnizimit deri te përdoruesi fundor.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi i akreditimit për organin e vlerësimit të përputhshmërisë, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara sipas legjislacionit në fuqi për standardizimin dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të përputhshmërisë.

2. “Artikuj piroteknikë për automjete” janë komponentë të pajisjeve të sigurisë në automjete,

që përmbajnë lëndë piroteknike, të cilat përdoren për të aktivizuar ato ose pajisje të tjera.

3. “Artikuj piroteknikë teatralë” janë artikujt piroteknikë të projektuar për t’u përdorur në skena të hapura ose të mbyllura, duke përfshirë produksionet e filmave dhe televizionit ose përdorime të ngjashme.

4. “Artikull piroteknik” është çdo artikull që përmban lëndë shpërthyes ose një përzierje të lëndëve shpërthyes të projektuara për të prodhuar nxehtësi, dritë, tingull, gaz ose tym ose një kombinim të këtyre efekteve nëpërmjet reaksioneve kimike ekzotermike që shkaktojnë vetë.

5. “Asgjësimi i artikujve piroteknikë” është shkatërrimi përfundimtar përmes detonimit dhe/ose incinerimit, ose përmes konvertimit të tyre në lëndë joplasëse me anë të procedurave të tjera.

6. “Autorizim” është vendimi i marrë nga autoriteti shtetëror që i njeh titullarit të drejtën të kryejë një ose disa veprime për lejimin e transferimit, eksportimit, importimit, tranzitimit, magazinimit, përdorimit ose asgjësimit të artikujve piroteknikë dhe që lëshohet pas pajisjes së operatorit ekonomik me licencën përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

7. “Eksport” është i njëjti kuptim me atë të dhënë në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

8. “Eksportues” është personi fizik/tregtar ose juridik që eksporton artikuj piroteknikë nga territori i Republikës së Shqipërisë.

9. “Fishekzjarr” është artikull piroteknik i synuar për qëllime zbavitëse.

10. “Bërje e disponueshme e produktit në treg (hedhje në treg)” është çdo furnizim i artikullit piroteknik në treg për shpërndarje, konsum ose përdorim të tij gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

11. “Inspektim” është çdo formë kontrolli që kryen organi publik për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

12. “Import” është i njëjti kuptim me atë të dhënë në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

13. “Importues” është personi fizik/tregtar ose juridik që importon artikuj piroteknikë në territorin e Republikës së Shqipërisë.



14. “Kthim i artikullit piroteknik” është çdo masë që synon kthimin mbrapsht të një artikulli piroteknik, i cili është hedhur në treg për përdoruesit fundorë.

15. “Licencë” është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë të prodhojë dhe të tregtojë artikuj piroteknikë ose të pajiset me autorizim për transferimin, tranzitimin, eksportimin, importimin e artikujve piroteknikë dhe që lëshohet sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

16. “Magazinim” është ruajtja e artikujve piroteknikë gjatë prodhimit, tregtimit dhe përdorimit në ambientet e synuara për atë qëllim.

17. “Markimi CE” është markimi me të cilin prodhuesi tregon se artikulli piroteknik është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

18. “Masa për sigurinë nga rënia e zjarrit” është tërësia e masave të marra për parandalimin e zjarreve të mundshme, duke kompletuar objektet e prodhimit, magazinimit dhe tregtimit me pajisje të diktimit-sinjalizimit, si dhe me mjete të shuarjes së zjarreve, automatike dhe/ose manuale konform standardeve të Bashkimit Evropian.

19. “Mbikëqyrje e tregut” janë veprimtaritë e kryera dhe masat e marra nga struktura përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, të përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji, për të garantuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore lidhur me të, me qëllim që të mos rrezikohen shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të interesit publik.

20. “Municionet” janë predhat e mbushjet hedhëse dhe municionet manovër të përdorura tek armët e zjarrit që mund të mbahen me vete, armë të tjera të zjarrit dhe artileri;

21. “Ndalim i tregtimit” është çdo masë e marrë përgjatë të gjithë zinxhirit të furnizimit për të parandaluar hedhjen në treg të artikullit piroteknik.

22. “Objekte për magazinimin dhe prodhimin e artikujve piroteknikë” janë objekte të mbyllura dhe të kontrolluara të synuara për prodhimin, magazinimin, ngarkimin e shkarkimin e artikujve piroteknikë, të cilat janë të ndërtuara dhe të pajisura në mënyrë të tillë që të garantojnë mbrojtjen e jetës e të shëndetit të njerëzve, mbrojtjen e pronës dhe të mjedisit.

23. “Operator ekonomik” është prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi, shpërndarësi dhe çdo person tjetër fizik/tregtar apo juridik, i cili ka si objekt të veprimtarisë së tij magazinimin, përdorimin, transferimin, importimin, eksportimin, tregtimin ose asgjësimin e artikujve piroteknikë.

24. “Organizëm evropian i notifikuar” është organizmi i vlerësimit të përputhshmërisë, i miratuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, i notifikuar prej këtij të fundit në Komisionin Evropian (KE) dhe i regjistruar në faqen zyrtare të KE-së si një strukturë kompetente për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të përputhshmërisë së produktit për vendosjen e markimit CE.

25. “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organi sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

26. “Person me njohuri të specializuar” është individ, i cili për të trajtuar dhe/ose përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë fishekzjarrë të kategorisë F4, artikuj piroteknikë teatralë të kategorisë T2 dhe/ose artikuj të tjerë piroteknikë të kategorisë P2:

a) ka eksperiencë mbi 2 (dy) vjet në trajtimin dhe/ose përdorimin dhe/ose prodhimin e këtyre kategorive të artikujve piroteknikë;

b) është trajnuar për masat e sigurisë dhe përdorimit nga një person fizik/juridik vendas ose i huaj, i cili operon në fushën e artikujve piroteknikë për këto kategori të artikujve piroteknikë.

27. “Prodhues” është çdo person fizik/tregtar ose juridik, i cili prodhon një artikull piroteknik ose që bën të mundur projektimin ose prodhimin e një artikulli të tillë e që e tregon atë me emrin ose markën e tij tregtare.

28. “Siguri publike” në kuptim të këtij ligji është marrja e masave për parandalimin e përdorimit të artikujve piroteknikë për qëllime që bien në kundërshtim me rendin publik;

29. “Siguri” është marrja e masave për parandalimin e aksidenteve dhe atëherë kur parandalimi dështon të minimizohen pasojat e tyre.

30. “Specifikim teknik” është dokumenti, i cili përshkruan kriteret teknike që duhen përmbushur nga një artikull piroteknik.

31. “Standard i harmonizuar shqiptar” është standardi shqiptar, që transpozon një standard të harmonizuar evropian, në mbështetje të këtij ligji dhe të rregullave teknike, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e



Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të ministrisë së linjës, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

32. “Subjekti i inspektimit” është çdo person fizik/tregtar apo juridik, privat ose publik, që ka sipas ligjit detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.

33. “Shitës me pakicë” janë të gjithë tregtarët, të ndryshëm nga prodhuesit dhe importuesit e artikujve piroteknikë.

34. “Shpërndarës” është çdo person fizik/tregtar ose juridik i përfshirë në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit dhe importuesit që bën të disponueshëm produktin në treg.

35. “Transferim” është çdo lëvizje fizike e artikullit piroteknik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe transportin tokësor, detar, ajror të artikujve piroteknikë, që hyjnë e kalojnë përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, me destinacion një vend jashtë Republikës së Shqipërisë dhe pa ndërruar pronësinë e mallrave, përveç lëvizjeve brenda kantierit ose vendit të punës.

36. “Tranzit” është i njëjti kuptim me atë të dhënë në Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

37. “Tregtim i artikujve piroteknikë” është shitja, blerja, shpërndarja dhe autorizimi për shitje të mëtejshme të artikullit piroteknik.

38. “Tërheqje nga tregu” është çdo masë e marrë nga operatorët ekonomikë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, që synon parandalimin e hedhjes në treg të artikullit piroteknik në zinxhirin e furnizimit, si dhe kthimin mbrapsht të produkteve që ndërkohë janë bërë të disponueshme të përdoruesi i fundit.

39. “Vërtetim besueshmërie” është akti administrativ i organit përgjegjës të ministrisë përgjegjëse për rendin e sigurinë publike, ku dokumentohet procesi i verifikimit të të dhënave të individit në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të të gjitha institucioneve shtetërore.

40. “Vendosja në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e artikullit piroteknik në tregun e Republikës së Shqipërisë.

41. “Vlerësimi i përputhshmërisë” është procesi i verifikimit nëse janë plotësuar ose jo kriteret

thelbësore të sigurisë të përcaktuara në këtë ligj, që kanë të bëjnë me artikullin piroteknik.

Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për artikujt piroteknikë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

a) artikujt piroteknikë të synuar për përdorim jotregtar nga strukturat shtetërore të sigurisë dhe mbrojtjes në përputhje me legjislacionin e brendshëm;

b) pajisjet që përfshihen në fushën e veprimtarisë detare dhe mbulohen nga legjislacioni përkatës;

c) artikujt piroteknikë të synuar për përdorim në industrinë aerohapësinore;

ç) kapsulat ndezëse të synuara në mënyrë specifike për lodrat, që përfshihen në fushën e zbatimit të legjislacionit përkatës;

d) lëndët plasëse që përfshihen në fushëveprimin e legjislacionit përkatës;

dh) municionet.

Neni 4 Vendosja në treg dhe bërja e disponueshme e artikujve piroteknikë

1. Autoritetet shtetërore, të përcaktuara në nenet 24 e 26 të këtij ligji, nuk ndalojnë, kufizojnë ose pengojnë vendosjen në treg të artikujve piroteknikë, të cilët përmbushin kërkesat e këtij ligji.

2. Autoritetet shtetërore, të përcaktuara në nenet 24 e 26 të këtij ligji, mund të marrin të gjitha masat për të ndaluar ose për të kufizuar zotërimin, përdorimin dhe/ose shitjen për publikun e gjerë të fishekzjarrëve të kategorive F2 e F3, artikujve piroteknikë teatralë dhe artikujve të tjerë piroteknikë kur këto masa justifikohen për arsye të sigurisë publike, shëndetit dhe sigurisë ose mbrojtjes së mjedisit.

3. Autoritetet shtetërore, të përcaktuara në nenet 24 e 26 të këtij ligji, lejojnë shfaqjen dhe përdorimin e artikujve piroteknikë, që nuk janë në përputhje me këtë ligj, në panairt tregtare, ekspozita dhe demonstrime për tregtimin e artikujve piroteknikë, me kusht që të ketë një shenjë të dukshme ku të tregohet qartë emri dhe data e panairit tregtar, ekspozitës ose demonstrimit



në fjalë, si dhe mospërputhja e mosvendosja në shitje e artikujve derisa të sigurohet përputhshmëria e tyre. Gjatë këtyre aktiviteteve merren të gjitha masat e përshtatshme të sigurisë në përputhje me çdo kërkesë të përcaktuar nga autoriteti shtetëror.

4. Autoritetet shtetërore, të përcaktuara në nenet 24 e 26 të këtij ligji, lejojnë lëvizjen e lirë dhe përdorimin e artikujve piroteknikë të prodhuar për qëllime kërkimi shkencor, zhvillimore dhe testimi e që nuk janë në përputhje me këtë ligj, me kusht që të ketë një shenjë të dukshme që tregon qartë mospërputhshmërinë e tyre dhe mosdisponueshmërinë për qëllime të tjera, përveç kërkimit shkencor, zhvillimor e testimit.

Neni 5

Kategoritë e artikujve piroteknikë

1. Artikujt piroteknikë kategorizohen nga prodhuesi sipas llojit të përdorimit ose qëllimit dhe nivelit të rrezikut, duke përfshirë edhe nivelin e tyre të zhurmës. Organizmi evropian i notifikuar konfirmon kategorizimin si pjesë e procedurave për vlerësimin e përputhshmërisë, të parashikuara në këtë ligj.

2. Kategoritë e artikujve piroteknikë janë si më poshtë:

a) fishekzjarrët:

i. kategoria F1: fishekzjarrët që paraqesin rrezik shumë të ulët e nivele zhurme të papërfillshme dhe që kanë për qëllim të përdoren në ambiente të izoluara, duke përfshirë fishekzjarrët që kanë për qëllim të përdoren brenda vendbanimeve;

ii. kategoria F2: fishekzjarrët që paraqesin rrezik të ulët e nivele të ulëta zhurme dhe që kanë për qëllim të përdoren jashtë në ambiente të izoluara;

iii. kategoria F3: fishekzjarrët që paraqesin rrezik të mesëm, të cilët kanë për qëllim të përdoren në ambiente të hapura dhe të mëdha e që kanë nivel të zhurmës, e cila nuk dëmton shëndetin e njeriut;

iv. kategoria F4: fishekzjarrët që paraqesin rrezik të lartë, të cilët kanë për qëllim të përdoren vetëm nga personat me njohuri të specializuara (zakonisht njihen si fishekzjarrë për përdorim profesional) dhe që kanë nivel të zhurmës që nuk dëmton shëndetin e njeriut;

b) artikujt piroteknikë teatralë:

i. kategoria T1: artikuj piroteknikë për përdorim skenik që paraqesin rrezik të ulët;

ii. kategoria T2: artikuj piroteknikë për përdorim skenik, që kanë për qëllim të përdoren vetëm nga persona me njohuri të specializuara;

c) artikuj të tjerë piroteknikë:

i. kategoria P1: artikuj piroteknikë që nuk u përkasin kategorive të fishekzjarrëve ose artikujve piroteknikë teatralë dhe që paraqesin rrezik të ulët.

ii. kategoria P2: artikuj piroteknikë që nuk u përkasin kategorive të fishekzjarrëve ose artikujve piroteknikë teatralë, të cilët kanë për qëllim të përdoren ose trajtohen vetëm nga persona me njohuri të specializuara.

Neni 6

Kufijtë e moshës dhe kufizime të tjera

1. Artikujt piroteknikë nuk u shiten ose u vihen në dispozicion konsumatorëve nën kufijtë e mëposhtëm të moshës për:

a) fishekzjarrët:

i. kategoria F1: 12 vjeç;

ii. kategoria F2: 16 vjeç;

iii. kategoria F3: 18 vjeç;

b) artikujt piroteknikë teatralë, kategoria T1: 18 vjeç;

c) artikujt e tjerë piroteknikë, kategoria P1: 18 vjeç.

2. Për arsye të sigurisë publike mund të rriten kufijtë e moshës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Operatorët ekonomikë, sipas kuptimit të këtij ligji, u shesin ose u vënë në dispozicion vetëm personave me njohuri të specializuar artikujt e mëposhtëm piroteknikë:

a) fishekzjarrët e kategorisë F4;

b) artikujt piroteknikë teatralë të kategorisë T2;

c) artikujt e tjerë piroteknikë të kategorisë P2.

4. Artikujt e tjerë piroteknikë të kategorisë P1 për automjetet, përfshirë jastëkët e ajrit dhe sistemet e tendosjes së rripave të sigurimit, nuk i vihen në dispozicion publikut të gjerë nëse nuk janë të inkuorporuara në një automjet ose në një pjesë të ndarë të automjetit.



KREU II
DETYRIMET E OPERATORËVE
EKONOMIKË

Neni 7

Detyrimet e prodhuesve

1. Prodhuesit, kur hedhin në treg artikujt piroteknikë, sigurohen që ata të jenë projektuar e prodhuar në përputhje me kriteret kryesore të sigurisë, të parashikuara në shtojcën I që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Prodhuesit hartojnë dokumentacionin teknik, të cilit i referohet shtojca II që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe ndjekin procedurën e përshtatshme të vlerësimit të përputhshmërisë sipas nenit 19 të këtij ligji.

3. Pasi të jetë ndjekur procedura sipas nenit 19 të këtij ligji, prodhuesi harton një deklaratë të përputhshmërisë së BE-së dhe vendos markimin CE.

4. Prodhuesit e ruajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e përputhshmërisë së BE-së për një periudhë 10-vjeçare pasi artikulli piroteknik është vendosur në treg.

5. Prodhuesit sigurohen që zbatimi i procedurave për prodhimin në seri të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

6. Modifikimet në projektim ose ato të lidhura me karakteristikat e artikullit piroteknik, si dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara apo ndryshimet e specifikimeve të tjera teknike duhet të reflektohen në dokumentacionin shoqërues të produktit.

7. Prodhuesit, në varësi të risqeve që paraqet një artikull piroteknik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit e të sigurisë së konsumatorëve, në vijim të kërkesës së justifikuar tek autoritetet kompetente dhe pas marrjes së miratimit përkatës, kryejnë testimin e mostrës së artikujve piroteknikë, të cilët kanë dalë në treg.

8. Prodhuesit, për artikujt e hedhur në treg nga ata, hetojnë dhe mbajnë një regjistër të ankesave për artikujt piroteknikë e që nuk plotësojnë kriteret e sigurisë, si dhe rastet e kthimit të artikullit piroteknik dhe i mban shpërndarësit të informuar për një monitorim të tillë.

9. Prodhuesit sigurohen që artikujt piroteknikë të vendosur në treg të etiketohen sipas përcaktimeve në nenet 9 e 10 të këtij ligji.

10. Prodhuesit vendosin tek artikulli piroteknik:

a) emrin e tyre;

b) emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare;

c) adresën postare;

i. në rast se një gjë e tillë është e pamundur, këto të dhëna vendosen te paketimi i tij ose te një dokument shoqërues i artikullit piroteknik;

ii. adresa tregon një vendndodhje të vetme ku mund të kontaktohet prodhuesi. Të dhënat e kontaktit duhet të jenë në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit fundorë dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

11. Prodhuesit sigurohen që artikulli piroteknik të shoqërohet nga të dhënat për mënyrën e përdorimit, të mirëmbajtjes dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e tyre, në gjuhën shqipe që kuptohet lehtë nga konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë fundorë. Të dhënat për mënyrën e përdorimit, të mirëmbajtjes dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e tyre, si edhe etiketimi të jenë të kuptueshme dhe të qarta.

12. Prodhuesit që konsiderojnë se artikulli piroteknik, të cilin ata e kanë vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë ligj, marrin menjëherë masat e domosdoshme për rregullimin e mospërputhshmërisë dhe, nëse është e nevojshme, e tërheqin ose e kthejnë artikullin nga tregu.

13. Në rast se ky artikull piroteknik paraqet risk, prodhuesit informojnë autoritetet kompetente të mbikëqyrjes së tregut duke dhënë hollësi, sidomos për mospërmbushjen e kriterëve dhe për masat korrektuese të ndërmarra.

14. Prodhuesit, në vijim të një kërkesë të arsyetuar nga ana e strukturave shtetërore, japin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në formë shkresore ose elektronike që nevojitet për të demonstruar përputhshmërinë e artikullit piroteknik me dispozitat e këtij ligji. Prodhuesit duhet të bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rreziqeve që paraqitet nga artikujt piroteknikë, të cilët i kanë vendosur në treg.

15. Prodhuesit në fazën e projektidesë për prodhimin e artikujve piroteknikë duhet t'i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), si dhe të sigurojnë lejet përkatëse mjedisore për prodhimin e artikullit piroteknik përpara vënies në punë të instalimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për



vlërësimin e ndikimit në mjedis dhe të atij për lejet e mjedisit.

Modifikimet në projektim ose në instalimet e prodhimit, që janë të lidhura me karakteristikat/standardet e harmonizuara të artikullit piroteknik apo ndryshimet në specifikimet teknike, duhet të jenë pjesë e VNM-së dhe lejes përkatëse të mjedisit.

Neni 8

Gjurmueshmëria

1. Për lehtësimin e gjurmueshmërisë së artikujve piroteknikë, prodhuesit i etiketojnë ato me një numër regjistrimi që caktohet nga organizmi evropian i notifikuar, që kryen vlerësimin e përputhshmërisë sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Rregullat dhe procedurat e krijimit të sistemit të gjurmimit të artikujve piroteknikë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

2. Prodhuesi dhe importuesi mbajnë dhe ruajnë deri në 10 vjet regjistrat e numrave të artikujve piroteknikë që vendosin në treg dhe, sipas kërkesës, këtë informacion e vendosin në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut.

Neni 9

Etiketimi i artikujve piroteknikë

1. Prodhuesit garantojnë që artikujt piroteknikë të etiketohen në gjuhën zyrtare në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe që nuk fshihet. Etiketimi të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i thjeshtë.

2. Etiketimi i artikujve piroteknikë përfshin minimalisht informacionin për prodhuesin, siç parashikohet në nenin 7 të këtij ligji, dhe, në rast se prodhuesi nuk ndodhet në Republikën e Shqipërisë, duhet të japë informacionin për prodhuesin dhe importuesin për:

- a) emrin dhe llojin e artikullit;
- b) numrin e tij të regjistrimit dhe të produktit;
- c) numrin e ngarkesës ose të serisë;
- ç) kufijtë minimalë të moshës, siç përcaktohet në këtë ligj;
- d) kategorinë përkatëse dhe udhëzimet për përdorim;

dh) vitin e prodhimit për kategoritë F3 e F4 dhe, kur është e përshtatshme, largësinë minimale të sigurisë;

e) sasinë neto (NEC) të lëndës shpërthyes.

3. Për fishekzjarrët të jepet minimalisht informacioni i mëposhtëm:

a) kategoria F1: “Për përdorim në ambient të brendshëm dhe të jashtëm” dhe “Largësia/largësitë minimale të sigurisë”;

b) kategoria F2: “Vetëm për përdorim në ambient të jashtëm” dhe, sipas rastit, “Largësia/largësitë minimale të sigurisë”;

c) kategoria F3: “Vetëm për përdorim në ambient të jashtëm” dhe “Largësia/largësitë minimale të sigurisë”;

ç) kategoria F4: “Të përdoret vetëm nga persona me njohuri të specializuara” dhe “Largësia/largësitë minimale të sigurisë”.

4. Artikujt piroteknikë teatralë të përmbajnë informacionin minimal si më poshtë:

a) kategoria T1: “Për përdorim në ambient të brendshëm dhe të jashtëm” dhe “Largësia/largësitë minimale të sigurisë”;

b) kategoria T2: “Të përdoret vetëm nga persona me njohuri të specializuara” dhe “Largësia/largësitë minimale të sigurisë”.

5. Nëse artikulli piroteknik nuk ka hapësirë të mjaftueshme për plotësimin e kërkesave të etiketimit, të përmendura në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, informacioni jepet në ambalazhin e paketimit më të vogël.

Neni 10

Etiketimi i artikujve piroteknikë për automjetet

1. Etiketimi i artikujve piroteknikë për automjete përfshin informacionin për prodhuesin, siç përcaktohet në nenin 9 të këtij ligji:

- a) emrin dhe llojin e artikullit piroteknik;
- b) numrin e tij të regjistrimit dhe produktit;
- c) numrin e ngarkesës apo të serisë dhe, kur është e nevojshme, udhëzimet për sigurinë.

2. Nëse artikulli piroteknik nuk ka hapësirë të mjaftueshme për kërkesat e etiketimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni, informacioni jepet tek ambalazhi.



Neni 11

Detyrimet e importuesve

1. Importuesit vendosin në treg vetëm artikujt piroteknikë që përmbushin kriteret e përputhshmërisë.

2. Përpara hedhjes në treg të artikujve piroteknikë, importuesit sigurohen që:

a) prodhuesi të ketë kryer procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) prodhuesi të ketë hartuar dokumentacionin teknik;

c) artikulli piroteknik të ketë të vendosur markimin CE;

ç) artikulli piroteknik të shoqërohet me dokumentet e nevojshme për hedhjen në treg;

d) prodhuesi të ketë plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji.

3. Kur importuesi vlerëson se një artikull piroteknik nuk është në përputhje me kërkesat kryesore të sigurisë të përcaktuara në shtojcën I të këtij ligji, nuk e vendos në treg artikullin piroteknik derisa të jetë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë.

4. Në rast se artikulli piroteknik paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturat e mbikëqyrjes së tregut për këtë fakt.

5. Importuesit tek artikulli piroteknik në gjuhën shqipe vendosin:

a) emrin e tyre;

b) emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare;

c) adresën ku mund të kontaktohen ose, nëse një gjë e tillë është e pamundur, e vendosin atë te paketimi apo te një dokument shoqërues i artikullit piroteknik.

6. Importuesit sigurohen që artikulli piroteknik të shoqërohet nga udhëzimet dhe informacioni për sigurinë në një gjuhë që mund të kuptohet lehtë nga përdoruesit e tjerë fundorë.

7. Importuesit sigurohen që gjatë kohës që artikulli piroteknik është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk rrezikojnë përmbushjen e kriterëve kryesore të sigurisë të përcaktuara në shtojcën I të këtij ligji.

8. Në rast se një artikull piroteknik paraqet risk, importuesit, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, në vijim të kërkesës së justifikuar nga autoritetet kompetente, kryejnë testimin e

mostrës së artikujve piroteknikë që kanë vendosur në treg, mbajnë një regjistër të ankesave dhe kthimeve për artikujt piroteknikë që nuk përmbushin kriteret e sigurisë dhe i mbajnë shpërndarësit të informuar për një monitorim të tillë.

9. Importuesit që vlerësojnë se artikulli piroteknik i hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, menjëherë marrin masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë në përputhje me kërkesat, për ta tërhequr ose për ta kthyer, nëse një gjë e tillë është e përshtatshme. Në rast se artikulli piroteknik paraqet rrezik, importuesit informojnë për këtë çështje menjëherë strukturat e mbikëqyrjes së tregut duke dhënë hollësi, sidomos për çështjen e mospërputhjes dhe çdo masë korrigjuese të ndërmarrë.

10. Importuesit duhet të mbajnë një kopje të deklarates së përputhshmërisë deri në 10 (dhjetë) vjet pas daljes në treg të artikullit piroteknik, të cilën, në vijim të kërkesës, ua vënë në dispozicion autoriteteve të mbikëqyrjes.

11. Importuesit:

a) në bazë të kërkesës së arsyetuar nga ana e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, japin në gjuhën shqipe të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në formë shkresore ose elektronike, që nevojitet për të provuar përputhshmërinë e artikullit piroteknik me dispozitat e këtij ligji;

b) bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga artikujt piroteknikë, të cilët i kanë hedhur në treg.

Neni 12

Detyrimet e shpërndarësve

1. Shpërndarësit duhet të përmbushin dispozitat e këtij ligji kur hedhin në treg një artikull piroteknik.

2. Përpara hedhjes në treg të artikullit piroteknik, shpërndarësit duhet të verifikojnë nëse:

a) artikulli piroteknik ka markimin CE;

b) artikulli piroteknik shoqërohet me dokumentet e nevojshme, si udhëzimet dhe informacionet e sigurisë në gjuhën shqipe.

3. Kur shpërndarësi vlerëson se artikulli piroteknik nuk është në përputhje me kërkesat kryesore të sigurisë të parashikuara në shtojcën I të



këtij ligji, ai nuk e vendos në treg derisa ajo lëndë të jetë në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Në rast se artikulli piroteknik paraqet rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin, si edhe strukturat e mbikëqyrjes së tregut.

4. Shpërndarësit sigurojnë që për aq kohë sa artikulli piroteknik është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit apo të transportit nuk cenojnë përputhshmërinë dhe përmbushjen e kriterëve të sigurisë të parashikuara në shtojcën I të këtij ligji.

5. Kur shpërndarësit vlerësojnë se artikulli piroteknik i hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ata sigurojnë marrjen e masave korrigjuese të nevojshme për ta sjellë atë në përputhje me konformitetin, për ta tërhequr apo për ta kthyer atë, sipas rastit. Në rast se artikulli piroteknik paraqet rrezik, shpërndarësit informojnë menjëherë strukturat e mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë hollësi për çështjen e çdo masë korrektuese të ndërmarrë.

6. Shpërndarësit:

a) bazuar në kërkesën e arsyetuar të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, paraqesin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në formë shkresore ose elektronike për të provuar përputhshmërinë e artikullit piroteknik;

b) bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga artikujt piroteknikë, të cilët i kanë hedhur në treg.

Neni 13

Rastet ku detyrimi i prodhuesve zbatohet për importuesit dhe shpërndarësit

Një importues ose shpërndarës konsiderohet si prodhues për qëllim të këtij ligji dhe u nënshtrohet detyrimeve që ka prodhuesi nëse vendos në treg një artikull piroteknik me emrin e tij, markën e tij tregtare apo nëse modifikon artikullin piroteknik të hedhur në treg në atë mënyrë që mund të ndikojë te përputhshmëria me dispozitat e këtij ligji.

Neni 14

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, sipas kërkesës, identifikojnë tek autoritetet e mbikëqyrjes së tregut:

a) çdo operator ekonomik që i ka furnizuar ata me artikull piroteknik;

b) çdo operator ekonomik që ata kanë furnizuar me artikull piroteknik.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni për një periudhë kohore 10-vjeçare pas furnizimit me artikull piroteknik dhe për një periudhë 10-vjeçare, pasi ata të kenë furnizuar një operator tjetër ekonomik me artikull piroteknik.

Neni 15

Shitja me pakicë dhe përdorimi i artikujve piroteknikë

1. Personat juridikë dhe fizikë/tregtarë mund të angazhohen në shitjen me pakicë të artikujve piroteknikë të kategorive F1, F2, F3, P1 dhe T1 në dyqanet e artikujve piroteknikë që janë të pajisur me leje nga njësia administrative, ku është i vendosur ambienti i shitjes. Personat e përfshirë në shitje në këto dyqane duhet të jenë të aftë dhe të kenë kualifikimet teknike për ushtrimin e këtij aktiviteti.

2. Artikujt piroteknikë të kategorive F2 dhe F3 mund të shiten nga 15 dhjetori deri më 1 janar te qytetarët me moshë mbi 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

3. Artikujt piroteknikë të përmendur në pikën 2 të këtij neni, mund të përdoren nga personat mbi 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç gjatë periudhës 27 dhjetor deri më 1 janar.

4. Ndalohet përdorimi në ambiente të brendshme ose në hapësira të populluara i artikujve piroteknikë të kategorive F2, F3, T1 dhe P1.

5. Qytetarët nuk blejnë ose përdorin artikuj piroteknikë të kategorive F4, P1, P2, T1 dhe T2 për nevojat e tyre personale.

6. Lejohet shitja dhe përdorimi i artikujve piroteknikë të kategorive F2, F3, T1 dhe P1, të cilët përdoren për qëllime të shpëtimit të njerëzve dhe të kafshëve ose në transportin rrugor, hekurudhor, detar, ajror dhe në ujërat e brendshme ose në teatro, bujqësi dhe aktivitete të ngjashme gjatë gjithë vitit nga persona që i paraqesin një vërtetim



shitësit lidhur me ushtrimin e aktivitetit për të cilin blihen këta artikuj ose vërtetim të pronësisë së mjetit lundrues për blerjen e artikujve piroteknikë të kategorisë P1.

7. Qytetarët mund të mbajnë artikuj të kategorive F1 dhe/ose F2 dhe/ose F3, me peshë maksimale neto deri në 2 (dy) kg lëndë piroteknike.

8. Lejohet shitja me pakicë e artikujve piroteknikë të kategorisë F1 për personat mbi 14 (katërmëdhjetë) vjeç nga kioskat ose dyqanet e tjera gjatë gjithë vitit.

9. Lejohet përdorimi i artikujve piroteknikë, të përmendur në pikën 8 të këtij neni, për personat mbi 14 (katërmëdhjetë) vjeç, gjatë gjithë vitit.

10. Në kioska lejohet mbajtja e artikujve piroteknikë të kategorisë F1, me peshë maksimale neto deri në 3 (tre) kg përbërje piroteknike.

11. Në dyqane të tjera lejohet mbajtja e artikujve piroteknikë të kategorisë F1, F2 dhe F3, me peshë maksimale neto deri në 15 (pesëmbëdhjetë) kg përbërje piroteknike.

12. Sasi më të mëdha të artikujve piroteknikë të kategorisë F1, F2 dhe F3 mund të mbahen në përputhje me dispozitat për magazinimin e artikujve piroteknikë.

13. Kushtet dhe kriteret për përdorimin e magazinimin e artikujve piroteknikë për shitje me pakicë përcaktohen me rregullore të veçantë të ministrisë që mbulon çështjet e rendit dhe sigurisë.

Neni 16

Masat e sigurisë

1. Gjatë kryerjes së veprimtarive të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, operatorët ekonomikë kujdesen që të mbrojnë jetët e shëndetin e njerëzve dhe pronën e tyre, si dhe të marrin të gjitha masat e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj e në rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji.

2. Operatorët ekonomikë rregullojnë mënyrën e zbatimit të masave të përmendura në pikën 1 të këtij neni me anë të një rregulloreje të brendshme, e cila duhet të jetë në përputhje me rregulloren e përgjithshme të miratuar nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen.

3. Rregullorja e brendshme, sipas pikës 2 të këtij neni, duhet të përmbajë, gjithashtu, një plan veprimi në rast aksidenti apo emergjence tjetër (shpërthim, zjarr, vjedhje etj.).

4. Operatorët ekonomikë u njoftojnë masat e përcaktuara në rregulloren e tyre të brendshme, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, të gjithë personave që kryejnë për llogari të tyre veprimtari të lidhura me artikuj piroteknikë dhe u ofrojnë atyre trajnimin e duhur për të vepruar në rast aksidenti.

5. Objektet për prodhimin ose magazinimin e artikujve piroteknikë duhet të jenë nën mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike, në përputhje me rregulloren e veçantë që rregullon fushën e mbrojtjes fizike e teknike.

6. Operatorët ekonomikë që prodhojnë, magazinojnë, transportojnë artikuj piroteknikë, duhet të organizojnë dhe të mbikëqyrin zbatimin e masave mbrojtëse të parashikuara.

7. Operatorët ekonomikë, për objektet ku prodhojnë, magazinojnë, tregtojnë, duhet të pajisen me Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri (CSZ).

8. Paketimi i artikujve piroteknikë nuk përdoret për qëllime të tjera, përveç paketimit të destinuar për artikujt piroteknikë.

9. Gjatë transportit të artikujve piroteknikë përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, operatorët ekonomikë që kanë autorizimin përkatës, kanë detyrimin që, në rast aksidenti, të veprojnë sipas mënyrës së përcaktuar për trajtimin e artikujve piroteknikë.

10. Operatorët ekonomikë të angazhuar në prodhimin, tregtimin ose magazinimin e artikujve piroteknikë, përpara se të ndërpresin kryerjen e veprimtarisë në fjalë, duhet t'i asgjësojnë apo t'i ashezin ose transferojnë ata personit juridik ose fizik/tregtarit që ka licencë për prodhimin, tregtimin ose magazinimin, si dhe të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

Neni 17

Trajnimet/kualifikimet

1. Personat/individët, të cilët për nevojat e operatorit ekonomik angazhohen në prodhimin, importin, eksportin, tregtimin, transportin, transferimin, magazinimin, përdorimin, asgjësimin, duke përdorur ose duke trajtuar drejtpërdrejt artikuj piroteknikë, duhet të jenë të aftë nga ana shëndetësore, të kualifikuar teknikisht, të trajnuar për kryerjen në mënyrë të sigurt të këtyre



veprimtarive dhe për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

2. Aftësia shëndetësore, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të mbështetet edhe nga një vërtetim i gjendjes shëndetësore, lëshuar nga organi kompetent pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetin publik.

3. Trajnimi i kualifikimit teknik për punën me artikujt piroteknikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, do të ofrohet sipas programit dhe mënyrës së parashikuar nga një organizëm privat, i akredituar sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin.

4. Trajnimi i kualifikimit teknik të drejtuesve të mjeteve për transportimin e artikujve piroteknikë, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, dhe pajisja me certifikatën përkatëse të kualifikimit për transportin e mallrave të rrezikshme, do të kryhen nga institucioni i licencuar nga ministri përgjegjës për transportin.

5. Pavarësisht përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni, individët e angazhuar në veprimtari ndihmëse në lidhje me prodhimin, tregtimin, magazinimin, transportin ose përdorimin e artikujve piroteknikë (transferimi, ngarkimi, shkarkimi etj.) nuk kanë nevojë të kenë kualifikim teknik dhe vërtetim të aftësisë dhe ata mund të përfshihen në veprimtaritë e përmendura në nenin 1 të këtij ligji vetëm nën mbikëqyrjen e personit përgjegjës të kualifikuar teknikisht dhe me kusht që të deklarojnë me shkrim se janë informuar rreth rreziqeve dhe rregullave të sigurisë në vendin e punës.

KREU III

VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Neni 18

Prezumimi i përputhshmërisë së artikujve piroteknikë

Artikujt piroteknikë, që janë në përputhje me standardet shqiptare, me standardet e harmonizuara ose me një pjesë të këtyre standardeve, referencat e të cilave janë të botuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, prezumohen se janë në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë së këtyre standardeve ose të një pjese të tyre të paraqitura në shtojcën I të këtij ligji.

Neni 19

Procedura e vlerësimit të përputhshmërisë

Për vlerësimin e përputhshmërisë së artikujve piroteknikë, prodhuesi ndjek një nga procedurat e mëposhtme të përcaktuara në shtojcën II të këtij ligji:

a) kontrolli i tipit EU (moduli B) dhe, sipas zgjedhjes së prodhuesit, një nga procedurat e mëposhtme:

i. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te kontrolli i brendshëm i produktit, si edhe kontrollet shtesë të mbikëqyrjes në intervale rastësore (moduli C2);

ii. përputhshmëria sipas tipit e bazuar te siguria e cilësisë së procesit të prodhimit (moduli D);

iii. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te siguria e cilësisë së produktit (moduli E).

b) përputhshmëria e bazuar te verifikimi i njësisë së produktit (moduli F);

c) përputhshmëria e bazuar te siguria e plotë e cilësisë (moduli G), që kanë të bëjnë me fishekzjarrët e kategorisë F4.

Neni 20

Vlerësimi i përputhshmërisë

Vlerësimi i përputhshmërisë së artikujve piroteknikë bëhet nga vetë prodhuesi nëpërmjet një organizmi evropian të notifikuar, kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të përputhshmërisë së produktit për vendosjen e markimit CE.

Kur një organizëm evropian i notifikuar tregon përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në standardet e harmonizuara, vërteton që artikulli piroteknik përmbush të gjitha standardet e sigurisë për t'u hedhur në treg.

Neni 21

Deklarata e përputhshmërisë

1. Deklarata e përputhshmërisë dëshmon përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë të parashikuara në shtojcën I të këtij ligji.

2. Deklarata e përputhshmërisë së BE-së hartohet sipas modelit të parashikuar në shtojcën III të këtij ligji, përmban elementet e përcaktuara te modulet përkatëse të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht sipas rastit.



Deklarata e përputhshmërisë së BE-së hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe.

3. Duke hartuar deklaratën e përputhshmërisë, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 22

Parimet e përgjithshme të markimit CE

Markimi CE do të realizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 23

Rregullat dhe kushtet për vendosjen e markimit CE dhe markimet e tjera

1. Markimi CE vendoset në mënyrë të dukshme tek artikulli piroteknik, i lexueshëm dhe i pamundur për t'u fshirë.

2. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk është e garantuar për shkak të natyrës së artikullit piroteknik, markimi vendoset në ambalazh dhe në dokumentet shoqëruese.

3. Markimi CE fiksohet përpara se artikulli piroteknik të hidhet në treg.

4. Markimi CE shoqërohet nga një numër identifikimi i organizmit të notifikuar, i cili është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit.

5. Numri i identifikimit të strukturës së akredituar vendoset nga vetë organi ose, sipas udhëzimeve të tij, nga ana e prodhuesit ose përfaqësuesi i autorizuar i këtij të fundit.

6. Markimi CE dhe numri i strukturës së akredituar, kur është e mundur, shoqërohet edhe nga një shenjë tjetër që tregon rrezik ose përdorim të veçantë.

KREU IV

ADMINISTRIMI I ARTIKUJVE PIROTEKNIKË DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Neni 24

Autoritetet shtetërore

1. Artikujt piroteknikë lejohen të hyjnë/dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, si

dhe të prodhohen brenda vendit vetëm sipas licencës së lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Ky autoritet verifikon që produktet, të cilat do të hyjnë/dalin dhe prodhohen të kenë markimin përkatës CE dhe deklaratën EU të përputhshmërisë.

Përjashtim nga detyrimi për licencim kanë artikujt piroteknikë, të cilët përdoren në industrinë automobilistike (jastëk ajri, rripa sigurimi etj.).

Pas miratimit të licencës, operatorët ekonomikë mund të importojnë ose eksportojnë artikuj piroteknikë duke u pajisur me autorizimin përkatës të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për sasinë e mallit që përcaktohet, sipas marrëveshjes ekonomike ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Artikujt piroteknikë tranzitohen sipas autorizimit të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Autoriteti doganor është përgjegjës për kontrollin e artikujve piroteknikë në pikat doganore të hyrjes dhe të daljes.

Kontrolli konsiston në verifikimin e markimit CE dhe të deklaratës së BE-së të përputhshmërisë. Në rast mospërputhjeje, njoftohet autoriteti licencues.

2. Transferimi, magazinimi dhe asgjësimi i artikujve piroteknikë do të lejohet sipas autorizimit të strukturave përgjegjëse në Policinë e Shtetit, sipas kompetencave territoriale, që kontrollojnë dhe verifikojnë se artikujt piroteknikë janë magazinuar sipas kushteve të sigurisë dhe janë hedhur në treg sipas qëllimit të tyre, pa rrezikuar shëndetin e njeriut.

Përjashtim nga detyrimi për autorizim për magazinim dhe transferim kanë artikujt piroteknikë, të cilët përdoren në industrinë automobilistike (jastëk ajri, rripa sigurimi).

3. Njësitë administrative janë përgjegjëse për licencimin e shitësve me pakicë brenda territorit të juridiksionit të tyre.

4. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut në ministrinë përgjegjëse për tregtinë është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut të brendshëm dhe verifikimin e produktit, sipas kërkesave të këtij ligji për përputhshmërinë dhe markimin CE.

5. Ministria përgjegjëse për mjedisin është përgjegjëse për vlerësimin e ndikimit në mjedis për



prodhimin, shkatërrimin e fishekzjarrëve dhe asgjësimin, duke dhënë miratimin përkatës.

6. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, veçmas ose në bashkëpunim, kryejnë këto veprime:

a) inspektime dhe verifikime në importin/eksportin, prodhimin e produkteve piroteknike dhe në pikat e shitjes së produkteve piroteknike;

b) marrin kampione për të analizuar dhe për të vlerësuar sigurinë e produktit;

c) kthejnë produktet piroteknike edhe kur kanë markimin CE, në rast se ato përbëjnë rrezik për shëndetin e sigurinë;

ç) organizojnë, në bashkëpunim me operatorët ekonomikë, tërheqjen nga tregu të produkteve piroteknike në rast se ato përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë.

d) kontrollojnë për masat e kompletimit me mjete dhe pajisje të shuarjes së zjarrit të objekteve ku prodhohen, magazinohen dhe tregtohen produktet piroteknike.

Kostot ekonomike që mund të rezultojnë nga veprimet në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike mbulohen nga operatorët ekonomikë.

Neni 25

Kushtet e administrimit

1. Kushtet e posaçme të licencimit dhe autorizimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë apo autorizim, afati i vlefshmërisë së licencës dhe autorizimit, procedurat e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e shfuqizimit/pezullimit të licencave e autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, tranzitimin dhe asgjësimin e artikujve piroteknike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrive dhe strukturave përgjegjëse, sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji.

2. Ministritë dhe strukturat e ngarkuara, sipas nenit 24 të këtij ligji, në bazë të aplikimit të kërkesës, i japin këtij licencën ose autorizimin përkatës në mbështetje të kriterëve të kualifikimit profesional dhe të gjendjes shëndetësore dhe gjyqësore të personit fizik/tregtarit ose administratorit të personit juridik, që ka selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Licencat dhe autorizimet e dhëna nuk u transferohen personave të tjerë.

4. Licencat dhe autorizimet e përcaktuara në këtë ligj përfshihen në fushën I të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Licencat dhe autorizimet e dhëna publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Neni 26

Mbikëqyrja e tregut të brendshëm dhe kontrolli i artikujve piroteknikë

1. Mbikëqyrja e tregut për zbatimin e këtij ligji bëhet nga:

a) struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen gjatë prodhimit të artikujve piroteknikë;

b) struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen dhe autoritetet doganore gjatë hyrjes e daljes së artikujve piroteknikë, kohë gjatë së cilës këta artikuj janë nën mbikëqyrje doganore;

c) struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit gjatë magazinimit, shpërndarjes dhe përdorimit të artikujve piroteknikë;

ç) struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut në ministrinë përgjegjëse për tregtinë dhe njësitë administrative në dyqanet me pakicë dhe pikat e shitjes;

d) struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi në fushën mjedisore;

dh) organet e tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në përputhje me kompetencat e veta.

Këto struktura në mënyrë individuale ose në bashkëpunim kryejnë inspektimet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin, për të verifikuar përputhshmërinë e artikujve piroteknikë dhe përmbushjen e kriterëve e të kërkesave të këtij ligji.

2. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që artikujt piroteknikë mund të vendosen në treg vetëm nëse do të ruhen në mënyrë të përshtatshme dhe përdoren për qëllimin e prodhuar dhe kur nuk rrezikojnë shëndetin e sigurinë e personave.



Neni 27

Procedurat për trajtimin e artikujve piroteknikë, të cilët paraqesin një rrezik publik

1. Kur autoritetet e mbikëqyrjes së tregut kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se artikulli piroteknik paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave, mallrave ose mjedisit, vlerësojnë artikullin piroteknik duke iu referuar kërkesave të parashikuara në këtë ligj.

2. Operatorët përkatës ekonomikë duhet të bashkëpunojnë me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për këtë qëllim nëse është e nevojshme.

3. Në rast se autoriteti i mbikëqyrjes së tregut gjatë vlerësimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni konstaton se artikulli piroteknik nuk përmbush kërkesat e përcaktuara sipas këtij ligji, ai i kërkon menjëherë operatorit përgjegjës të marrë të gjitha masat korrigjuese të domosdoshme për ta sjellë artikullin piroteknik në përputhje me këto kërkesa, ta tërheqë nga tregu brenda 20 (njëzet) ditësh, në përputhje me natyrën e rrezikut, të përcaktuar nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

4. Në rast se autoritetet e mbikëqyrjes së tregut konstatojnë se mospërputhja nuk kufizohet vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, ata njoftojnë edhe autoritetet homologe të tyre në shtetet e tjera për rezultatet e vlerësimit dhe për veprimet që i kanë kërkuar operatorit ekonomik të ndërmarrë.

5. Operatori ekonomik siguron marrjen e të gjitha masave korrigjuese në lidhje me artikullin piroteknik, që është vendosur në treg.

6. Në rast se operatori përkatës ekonomik nuk merr masat e duhura korrigjuese brenda periudhës së përmendur në pikën 3 të këtij neni, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr masat e nevojshme provizore për të ndaluar ose kufizuar artikullin piroteknik që vendoset në treg, e tërheq nga tregu ose e kthen atë.

7. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut informon institucionet përgjegjëse licencuese në kuptim të këtij ligji për masat e marra.

8. Informacioni i referuar në pikën 7 të këtij neni përfshin:

- a) të dhënat e nevojshme për identifikimin e artikullit piroteknik, i cili nuk plotëson kriteret;
- b) origjinën e artikullit piroteknik;
- c) natyrën e mosplotësimit të pretenduar dhe rrezikun e përfshirë;

ç) natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të marra; dhe

d) argumentet e parashtruara nga operatori përkatës ekonomik.

9. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut shprehet nëse mospërputhja është për shkak të:

a) mospërmbushjes së kërkesave të artikullit piroteknik, sa u përket kërkesave në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e personave ose aspektet e tjera të mbrojtjes së interesit të mallrave apo mjedisit;

b) mospërmbushjes së standardeve të harmonizuara, të cilat bëjnë të mundur prezumimin e përputhshmërisë.

10. Në rast se operatori ekonomik nuk është dakord me masën e marrë, paraqet kundërshtimet me shkrim pranë autoritetit mbikëqyrës që ka dhënë masën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga njoftimi i masës.

11. Në rast se brenda 3 (tre) muajve nga marrja e informacionit të mësipërm nuk ngrihet asnjë kundërshtim nga operatorët ekonomikë lidhur me masën e përkohshme të marrë nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, kjo masë konsiderohet e ligjshme.

12. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut sigurohen që masa kufizuese e tërheqjes së artikullit piroteknik nga tregu të zbatohet pa vonesë.

13. Në rast se në përfundim të procedurës ngrihen kundërshtime lidhur me masat e marra nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut ose në rastin kur masat e marra bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut bashkëpunon me operatorët ekonomikë për vlerësimin e këtyre masave.

14. Në rast se vlerësimet e konstatuara qëndrojnë, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr masat për të siguruar tërheqjen e artikullit piroteknik nga tregu.

15. Në rast se vlerësimet e konstatuara nuk qëndrojnë, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut shfuqizon masën e marrë.

Neni 28

Artikujt piroteknikë që përmbushin kriteret e përputhshmërisë, por që paraqesin një risk ndaj shëndetit dhe sigurisë

1. Në rastin e kryerjes së vlerësimit, sipas parashikimeve në pikën 1 të nenit 27, të këtij ligji,



kur autoriteti i mbikëqyrjes së tregut konstaton se artikulli piroteknik është në përputhje me parashikimet e këtij ligji, por paraqet rrezik për shëndetin, sigurinë e njerëzve, mallrave ose mjedisit, atëherë i kërkon operatorit ekonomik përgjegjës:

a) të marrë të gjitha masat për të siguruar që artikulli piroteknik në fjalë në momentin e hedhjes në treg nuk paraqet rrezik; ose

b) të tërheqë artikullin piroteknik nga tregu; ose

c) të kthejë ose të ndalojë tregtimin e artikullit piroteknik për një afat kohor të arsyeshëm në raport me natyrën e rrezikut të përcaktuar nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

2. Operatorët ekonomikë duhet të garantojnë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të gjithë artikujt piroteknikë që janë hedhur në treg.

3. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut jep informacione, të cilat duhet të përfshijnë të gjitha të dhënat e disponueshme, veçanërisht detaje të domosdoshme për identifikimin e artikullit piroteknik, origjinën, zinxhirin e furnizimit të artikullit piroteknik, natyrën e rrezikut të përfshirë, natyrën e kohëzgjatjes e masave të marra.

4. Operatorët ekonomikë marrin pjesë në konsultimet për konstatimet, me qëllim vlerësimin nga ata të masave të marra nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

Neni 29

Rregullimi i mospërputhshmërisë

1. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut i kërkon operatorit ekonomik të rregullojë mospërputhshmërinë kur konstaton se:

a) markimi CE është vendosur në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;

b) markimi CE nuk është vendosur;

c) numri i identifikimit të autoritetit akreditues në rastet kur ai organ është i përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit, është dhënë në kundërshtim me këtë ligj ose nuk është dhënë fare;

ç) nuk është hartuar deklarata e përputhshmërisë së BE-së;

d) deklarata e përputhshmërisë së BE-së nuk është hartuar në mënyrë të saktë;

dh) dokumentacioni teknik ose nuk është i disponueshëm ose është i paplotë;

e) dokumentacioni i parashikuar në lidhje me gjurmimin apo kriteret e sigurisë mungon, është i pasaktë apo i paplotë;

ë) nuk janë plotësuar parashikimet ligjore të përcaktuara në këtë ligj.

2. Në rast se mospërputhshmëria e parashikuar në pikën 1 të këtij neni vazhdon, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar apo për të ndaluar hedhjen në treg të artikullit piroteknik ose për t'u siguruar që kjo lëndë të tërhiqet nga tregu.

Neni 30

Ndalimi i tregimit të produkteve dhe bllokimi

1. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut mund të vendosë të ndalojë përkohësisht hedhjen e produktit në treg në rastet kur:

a) ka dyshime se produkti nuk përmbush kërkesat kryesore ose kërkesat e tjera të sigurisë së artikullit piroteknik;

b) produkti nuk ka markën CE ose është markuar në mënyrë të paligjshme dhe/ose nuk është shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm ndaj këtij produkti;

c) është konstatuar rasti i mospërputhshmërisë si në pikën 1 të nenit 29 të këtij ligji dhe operatori ekonomik nuk ka përmbushur masat e urdhëruara brenda afatit kohor të vendosur nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut dhe produkti mund të paraqesë rrezik për përdoruesin e fundit;

ç) prodhimi, magazinimi, përdorimi ose tregtimi mund të paraqesë rrezikshmëri;

d) autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në vende të tjera të Bashkimit Evropian kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm dhe/ose jo në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara për produktin.

2. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut shfuqizon vendimin për ndalimin e përkohshëm të tregimit kur operatori ekonomik vërteton se ai plotëson kushtet e parashikuara nga ky ligj.

3. Vendimi i ndalimit të përkohshëm mund të shoqërohet, nëse është e nevojshme, me detyrimin e operatorit ekonomik për lajmërimin e përdoruesit të fundit për rrezikun.

4. Struktura përgjegjëse urdhëron ndalimin e përhershëm të tregimit në qoftë se kontrollet ose testimet provojnë se artikulli piroteknik paraqet



rrezik dhe/ose nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë ose, pavarësisht përputhshmërisë, ai mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjera publike.

5. Vendimi për ndalimin e tregtimit mund të merret nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut në qoftë se:

a) të njëjtat masa janë marrë nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ku është tregtuar produkti;

b) prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm ose nuk është në përputhje me legjislacionin përkatës.

6. Vendimi shoqërohet me një ose me disa nga masat e mëposhtme:

a) lajmërimin e tregtarëve/përdoruesve të fundit, duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit publik për rrezikun që paraqet artikulli piroteknik;

b) urdhërimin për ndalimin e menjëhershëm të tregtimit në qoftë se produkti është tashmë në treg ose kthimin mbrapsht të tij;

c) urdhërimin e bërjes jofunksional të artikullit piroteknik ose asgjësimin e tij.

7. Lajmërimi i klientëve dhe i përdoruesve të fundit, si dhe kthimi i artikullit piroteknik duhet të kryhen nga operatorët ekonomikë nën mbikëqyrjen e autoritetit të mbikëqyrjes së tregut.

8. Në rast se masat e marra nga operatorët ekonomikë konsiderohen si të pamjaftueshme, veprimet e sipërpërmendura kryhen nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut dhe shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

9. Asgjësimi i produktit ose bërja jofunksionale kryhet nga operatori ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve nëpërmjet operatorëve të licencuar për asgjësimin e këtij produkti. Shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

Neni 31 Inspektimi

1. Gjatë inspektimit nëpunësit e strukturave të mbikëqyrjes së tregut, të përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji, sipas fushave të kompetencës, janë të autorizuar të kryejnë, pa njoftuar paraprakisht

operatorin ekonomik, subjekt i inspektimit, veprimet e mëposhtme:

a) inspektimin e strukturave, hapësirave dhe shesheve të ndërtimit, ku prodhohen, ruhen, përdoren, asgjësohen ose shiten artikuj piroteknikë, si dhe të hapësirave të tjera që dyshohen se ruajnë artikuj piroteknikë;

b) kontrollin e dokumentacionit për artikullin piroteknik dhe kualifikimet teknike të personave;

c) verifikimin e identitetit të personave që gjenden në vendet ku përdoren, prodhohen e ruhen artikuj piroteknikë;

ç) kryerja e aktiviteteve të tjera në përputhje me qëllimin e inspektimit.

2. Nëpunësit e përmendur në pikën 1 të këtij neni kryejnë inspektimin në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në rast se nëpunësit e përmendur në pikën 1 të këtij neni gjatë kryerjes së inspektimit konstatojnë se artikujt piroteknikë janë përdorur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara mbi bazën e tij kanë të drejtë:

a) të urdhërojnë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda periudhës së specifikuar;

b) të ndërpresin prodhimin, përdorimin, trajtimin, ruajtjen e artikujve piroteknikë në rast se janë kryer parregullsi të rënda në lidhje me zbatimin e masave të sigurisë, të cilat vendosin në rrezik jetët dhe shëndetin e njerëzve, pronën e tyre dhe mjedisin dhe/ose;

c) të urdhërojnë marrjen e masave të tjera për prodhimin, tregtimin, ruajtjen dhe përdorimin, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, pasurisë së tyre dhe mjedisit.

4. Masat e mësipërme pasqyrohen edhe në procesverbalin e inspektimit.

5. Struktura përgjegjëse që ka autorizuar inspektimin i njofton operatorin ekonomik procesverbalin e njoftimit, në formë të shkruar, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e përfundimit të inspektimit. Operatori ekonomik, subjekt i inspektimit, ka të drejtën të paraqesë me shkrim ose me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 (tetë) ditë nga data e njoftimit të procesverbalit.



Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit.

6. Ankimi administrativ kundër vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit paraqitet 10 (dhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit nga operatori ekonomik i inspektuar dhe shqyrtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Kundër vendimit, që shprehet për ankimin administrativ, lejohet ankim në gjykatën kompetente brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke nisur nga dita e njohjes me vendimin e arsyetuar.

7. Operatorët ekonomikë, ndaj të cilëve zbatohen dispozitat e këtij ligji, kanë detyrimin të lejojnë inspektimin e të bashkëpunojnë me autoritetet shtetërore të përcaktuara në këtë ligj, si dhe të japin informacionin e nevojshëm e të identifikojnë operatorët, të cilët i kanë furnizuar me artikujt piroteknikë dhe ato që kanë furnizuar.

8. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, që ka kryer kontrollin, merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit.

Neni 32

Ekzekutimi i vendimeve

Ekzekutimi i vendimeve, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 33

Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga operatorët ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Gjjobitet me 200 000 (dyqind mijë) – 500 000 (pesëqind mijë) lekë operatori ekonomik, i cili:

a) përfshihet në testimin e artikujve piroteknikë ose aktivitetet e specializuara në procesin e vlerësimit të përputhshmërisë pa leje nga struktura përgjegjëse;

b) prodhon ose tregton artikuj piroteknikë, të cilët nuk janë testuar e markuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

c) prodhon artikuj piroteknikë pa licencë për prodhimin e tyre;

ç) angazhohet në tregtimin e artikujve piroteknikë pa marrë autorizimin përkatës;

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1 të këtij neni dhe që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës, mund të vendoset edhe masa plotësuese e ndalimit për 1 (një) vit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje.

2. Gjjobitet me 100 000 (njëqind mijë) lekë operatori ekonomik biznes i vogël dhe me 100 000 (njëqind mijë) – 200 000 (dyqind mijë) lekë operatori ekonomik biznes i madh, i cili:

a) nuk miraton një rregullore të përgjithshme që të përmbajë planin e veprimit për masat e sigurisë ose nuk vepron në përputhje me këtë rregullore;

b) nuk ua njofton masat e parashikuara në rregullore të gjithë personave që kryejnë aktivitetet me artikuj piroteknikë për llogari të tij ose nuk u ofron atyre trajnimin për të vepruar në rast aksidenti;

c) nuk garanton mbrojtje të përhershme fizike ose teknike të ambienteve për prodhimin ose magazinimin e artikullit piroteknik;

ç) lejon përdorimin e artikujve piroteknikë nga persona pa kualifikim teknik dhe jo të aftë;

d) lejon një person, i cili nuk është i kualifikuar teknikisht, nuk zotëron vërtetim të aftësisë, nuk punon nën mbikëqyrjen e personit përgjegjës teknikisht të kualifikuar dhe nuk ka deklaruar me shkrim se i njeh rreziqet e rregullat e sigurisë në vendin e punës, të përfshihet në aktivitete ndihmëse lidhur me prodhimin, tregtimin, transportin, magazinimin;

dh) gjatë ekzaminimit të artikujve piroteknikë, laborator i akredituar zbulon se ato nuk përmbushin kërkesat teknike, por nuk ia raporton këtë fakt autoritetit përkatës që lëshon licencën e prodhimit;

e) magazinon artikuj piroteknikë në struktura dhe ambiente që nuk janë krijuar për magazinimin e tyre ose i magazinon ato në sasi që tejkalojnë kapacitetin maksimal të magazinës;

ë) magazinon në magazinën e përkohshme artikuj piroteknikë që tejkalojnë kapacitetin maksimal ose artikuj piroteknikë të ruajtur në magazinën e përkohshme, i përdor për aktivitete që nuk lidhen me objektin në të cilin është ndërtuar magazina;



f) është përgjegjës për mbajtjen e të dhënave për gjurmimin e artikujve piroteknikë dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore;

g) angazhohet në transportin e artikujve piroteknikë, duke mos respektuar rregullat për transportin e artikullit piroteknik;

gj) pengon inspektorin që të kryejë mbikëqyrjen inspektuese ose nuk i siguron atij akses në dokumentacionin e kërkuar dhe/ose nuk i jep informacionin dhe të dhënat e nevojshme.

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës mund të vendoset edhe masa plotësuese e ndalimit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje për 6 (gjashtë) muaj.

3. Gjjobitet me 10 000 (dhjetë mijë) – 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë operatori ekonomik biznes i vogël dhe me 10 000 (dhjetë mijë) – 100 000 (njëqind mijë) lekë operatori ekonomik biznes i madh, i cili:

a) ambalazhin e synuar për paketimin e artikullit piroteknik e përdor për qëllime të tjera;

b) nuk njofton strukturat përgjegjëse që kanë lëshuar licencat/autorizimet për ndërprerjen e aktiviteteve të lejuara nga ky ligj apo ndryshime të tjera në status dhe në kushtet e kriteret me të cilat është përfituar licenca/autorizimi brenda 8 (tetë) ditëve nga data e ndodhjes së tyre;

c) nuk u dorëzon strukturave përkatëse të dhënat e shtetasit që synon të angazhojë në kryerjen e aktiviteteve lidhur me artikujt piroteknikë;

ç) transferon, tregton e përdor artikuj piroteknikë në ambalazh që nuk është testuar dhe markuar në përputhje me rregullat për transportin e mallrave të rrezikshme dhe rregullat për markimin e artikujve piroteknikë;

d) nuk mban të dhënat për dokumentacionin teknik, deklaratat e përputhshmërisë, sistemit të gjurmimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj;

dh) nuk raporton pranë strukturave përgjegjëse, të cilat kanë miratuar licencat/autorizimet, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj ose akteve nënligjore në zbatim të tij;

e) nuk ia kthen artikujt piroteknikë prodhuesit ose nuk i shkatërron ato me shpenzimet e tij brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit për ndalimin e tregtimit dhe përdorimit të artikujve piroteknikë;

ë) zotëron artikuj piroteknikë për të cilët ka dijeni se nuk janë në përputhje me kërkesat teknike e me strukturën përkatëse;

f) strukturat për prodhimin dhe magazinimin e artikujve piroteknikë nuk janë ndërtuar dhe nuk kanë pajisjet e duhura për të siguruar mbrojtjen e jetës e të shëndetit të njerëzve, pronës së tyre dhe mjedisit;

g) magazinon artikuj piroteknikë në magazina të përkohshme për instalimin dhe shfrytëzimin e të cilave nuk është marrë autorizimi përkatës;

gj) nuk i dorëzon strukturës përgjegjëse të dhënat e mbajtura në përputhje me këtë ligj brenda 8 (tetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit që shfuqizon lejen për prodhimin e artikujve piroteknikë;

h) magazinon artikull piroteknik të nevojshëm për kryerjen e aktiviteteve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, në sasi që tejkalojnë kapacitetin e disponueshëm të magazinës.

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës, mund të vendoset edhe masa plotësuese e ndalimit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje për 6 (gjashtë) muaj.

4. Përveçse kur parashikohet ndryshe, struktura përgjegjëse për dhënien e licencës/autorizimit urdhëron shfuqizimin e saj/tij:

a) kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të;

b) kur rrethanat janë të tilla që s'do të kishte kuptim apo mundësi për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

c) në rast të moszbatimit të urdhërimeve brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;

ç) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtrim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi.

d) kur titullari dënohet me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është licencuar/autorizuar apo që cenon jetën dhe shëndetin e njeriut;

dh) kur titullari gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është licencuar/autorizuar shkel rregullat teknike duke rrezikuar jetën e njerëzve, kafshëve dhe/ose mjedisit.



5. Shkeljet me karakter administrativ konstatohen e sanksionohen nga strukturat përgjegjëse, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 26, sipas fushës së kompetencës.

6. Të ardhurat që burojnë nga vjelja e gjobave kalojnë në buxhetin e shtetit.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË
FUNDIT

Neni 34
Dispozita kalimtare

1. Për procedurat e licencimit, kontrollit, raportimeve të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Licencat, lejet, autorizimet, të cilat janë lëshuar në bazë të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të mbeten në fuqi deri në 1 (një) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Brenda këtij afati, operatorët ekonomikë duhet të marrin masat për licencim sipas këtij ligji.

Brenda kësaj kohe, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin parashikimet e dispozitave të ligjit për sigurinë e artikujve piroteknikë.

3. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 35
Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton aktet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 dhe në pikën 1 të nenit 25.

Ministri përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton aktin e përcaktuar në pikën 13 të nenit 15.

Ministri përgjegjës për mbrojtjen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 16.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 3.6.2021.

SHTOJCA I

KRITERET KRYESORE TË SIGURISË

1. Çdo artikull piroteknik duhet të plotësojë karakteristikat e performancës që prodhuesi i ka specifikuar organit të notifikuar, me qëllimin për të garantuar siguri dhe besueshmëri maksimale.

2. Çdo artikull piroteknik duhet të projektohet dhe prodhohet në mënyrë të tillë që të mund të asgjësohet në mënyrë të sigurt nëpërmjet një procesi të qëndrueshëm me ndikim minimal në mjedis.

3. Çdo artikull piroteknik duhet të funksionojë siç duhet gjatë përdorimit për qëllimin e synuar.

Çdo artikull piroteknik duhet të testohet në kushte reale. Nëse testimet nuk kryhen në laborator, ato duhet të kryhen në kushtet ku do të përdoret artikulli piroteknik.

Sipas rastit, duhet të merren në konsideratë ose të testohen informacioni dhe veçoritë e mëposhtme:

a) disenjimi, ndërtimi dhe veçoritë karakteristike, duke përfshirë përbërjen e hollësishme kimike (masa dhe përqindja e substancave të përdorura) dhe përmasat;

b) qëndrueshmëria fizike dhe kimike e artikullit piroteknik në të gjitha kushtet normale dhe të parashikueshme mjedisore;

c) ndjeshmëria gjatë trajtimit dhe transportimit të zakonshëm të parashikueshëm;

ç) pajtueshmëria e të gjithë komponentëve për sa i përket qëndrueshmërisë kimike të tyre;

d) rezistenca e artikullit piroteknik ndaj lagështirës në rastet kur është parashikuar të përdoret në lagështi ose në kushte lagështie dhe kur lagështia mund të ndikojë negativisht në sigurinë ose besueshmërinë e tij;

dh) rezistenca ndaj temperaturave të ulëta dhe të larta në rastet kur artikulli piroteknik është



parashikuar për t'u mbajtur ose për t'u përdorur në temperatura të tilla dhe kur siguria ose besueshmëria e tij mund të dëmtohet nga ftohja ose nxehja e përbërësve ose e të gjithë artikullit piroteknik;

e) elementet e sigurisë të parashikuara për parandalimin e aktivizimit ose të ndezjes së parakohshme ose të pakujdesshme;

ë) udhëzimet dhe, kur është e nevojshme, prania e shenjave të duhura për trajtimin, magazinimin, përdorimin (duke përfshirë distancat e sigurisë) e asgjësimin.

f) aftësia që ka artikulli piroteknik, ambalazhi ose komponentë të tjerë të tij për të mos u prishur gjatë kushteve normale, të parashikueshme të magazinimit;

g) specifikimi i të gjithë mekanizmave e aksesorëve që nevojiten dhe udhëzimet e përdorimit për funksionimin e sigurt të artikullit piroteknik.

Gjatë transportit dhe trajtimit normal, përveçse kur specifikohet ndryshe në udhëzimet e prodhuesit, artikujt piroteknikë duhet të përmbajnë përbërje piroteknike.

4. Artikujt piroteknikë nuk duhet të përmbajnë lëndë shpërthyes, përveç barutit të zi ose përbërjes së flakës, përveç artikujve piroteknikë të kategorisë P1, P2, T2 dhe fishekzjarrëve të kategorisë F4, të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) lënda shpërthyes nuk nxirret lehtë nga artikulli piroteknik;

b) për kategorinë P1, artikulli piroteknik nuk funksionon në një mënyrë shpërthyes dhe nuk ndez shpërthyes të dytë, ashtu siç është disenjuar dhe prodhuar;

c) për kategoritë F4, T2 dhe P2, artikulli piroteknik është disenjuar dhe ka për qëllim që të mos funksionojë në një mënyrë shpërthyes ose, nëse është disenjuar për të shpërthyer, ai nuk ndez shpërthyes të dytë, siç është disenjuar dhe prodhuar.

5. Grupet e ndryshme të artikujve piroteknikë duhet të përmbushin të paktën kërkesat e renditura më poshtë.

A. Fishekzjarrët

1. Prodhuesi duhet t'i ndajë fishekzjarrët në kategori të ndryshme, sipas nenit 5 të këtij ligji, të karakterizuara nga përmbajtja neto e lëndëve plasëse, distancat e sigurisë, niveli i zhurmës ose

kritere të ngjashme. Kategoria duhet të cilësohet qartë në etiketë.

a) Fishekzjarrët e kategorisë F1 duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

i. distanca e sigurisë duhet të jetë të paktën 1 (një) m. Megjithatë, sipas rastit, distanca e sigurisë mund të jetë më e vogël;

ii. niveli maksimal i zhurmës nuk duhet të tejkalojë 120 (njëqind e njëzet) dB (A, imp) ose çdo nivel zhurme të barasvlershëm të matur me një metodë tjetër të përshtatshme, në distancën e sigurisë;

iii. kategoria F1 nuk duhet të përfshijë kapsollat, bateritë kapsolla, kapsollat me flakë dhe bateritë kapsolla me flakë;

iv. artikujt e kategorisë F1 nuk duhet të përfshijnë më shumë se 2,5 (dy presje pesë) mg fulminat argjendi.

b) Fishekzjarrët e kategorisë F2 duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

i. distanca e sigurisë duhet të jetë të paktën 8 (tetë) m. Megjithatë, sipas rastit, distanca e sigurisë mund të jetë më e vogël;

ii. niveli maksimal i zhurmës nuk duhet të tejkalojë 120 (njëqind e njëzet) dB (A, imp), ose çdo nivel zhurme të barasvlershëm të matur me një metodë tjetër të përshtatshme, në distancën e sigurisë.

c) Fishekzjarrët e kategorisë F3 duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

i. distanca e sigurisë duhet të jetë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) m. Megjithatë, sipas rastit, distanca e sigurisë mund të jetë më e vogël;

ii. niveli maksimal i zhurmës nuk duhet të tejkalojë 120 (njëqind e njëzet) dB (A, imp) ose çdo nivel zhurme të barasvlershëm të matur me një metodë tjetër të përshtatshme, në distancën e sigurisë.

2. Fishekzjarrët mund të ndërtohen vetëm nga materiale që minimizojnë rrezikun për shëndetin, pronën dhe mjedisin nga mbetjet.

3. Metoda e ndezjes duhet të jetë qartësisht e dukshme ose duhet të cilësohet në etiketim ose udhëzime.

4. Fishekzjarrët nuk duhet të lëvizin në mënyrë të çrregullt dhe të paparashikueshme.

5. Fishekzjarrët e kategorisë F1, F2 dhe F3 duhet të mbrohen nga ndezja keqdashëse, qoftë përmes një mbulese mbrojtëse, përmes ambalazhit ose projektimit të artikullit. Fishekzjarrët e



kategorisë F4 duhet të mbrohen nga ndezja keqdashëse nëpërmjet metodave të specifikuara nga prodhuesi.

B. Artikujt të tjerë piroteknikë

1. Artikujt piroteknikë duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të minimizojnë rrezikun për shëndetin, pronën dhe mjedisin gjatë përdorimit normal.

2. Metoda e ndezjes duhet të jetë qartësisht e dukshme ose duhet të cilësohet në etiketim ose udhëzime.

3. Artikulli piroteknik duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të minimizojë rrezikun për shëndetin, pronën dhe mjedisin nga mbetjet kur ndizet me qëllime keqdashëse.

4. Kur është e përshtatshme, artikulli piroteknik duhet të funksionojë siç duhet deri në datën e shënuar “të përdoret përpara”, të specifikuar nga prodhuesi.

C. Mekanizmat e ndezjes

1. Mekanizmat e ndezjes duhet të jenë në gjendje që të ndizen në mënyrë të besueshme dhe të kenë aftësi të mjaftueshme ndezëse, sipas të gjitha kushteve normale të parashikueshme të përdorimit.

2. Mekanizmat e ndezjes duhet të jenë të mbrojtura nga shkarkimet elektrostatische në kushte normale, të parashikueshme të magazinimit dhe përdorimit.

3. Ndezësit elektrikë duhet të jenë të mbrojtur nga fushat elektromagnetike në kushte normale të parashikueshme të magazinimit e të përdorimit.

4. Veshja izoluese e fitilave ndezës duhet të ketë qëndrueshmërinë e duhur mekanike dhe të mundësojë mbrojtjen e duhur për mbushjen plasëse gjatë ekspozimit në tension mekanik.

5. Parametrat për kohën e djegies së fitilave ndezës duhet të njoftohen bashkë me artikullin.

6. Karakteristikat elektrike (për shembull, rryma e mosshpërthimit, rezistenca etj.) të ndezësve elektrikë duhet të njoftohen bashkë me artikullin.

7. Telat e ndezësve elektrikë duhet të jenë mjaftueshëm të izoluar dhe me qëndrueshmëri mekanike të mjaftueshme, duke përfshirë edhe qëndrueshmërinë e lidhjeve në ndezës, në varësi të përdorimit të parashikuar.

SHTOJCA II

**PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË
PËRPUTHSHMËRISË**

MODULI B

Kontrolli i tipit EU

1. Kontrolli tip EU është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë, ku një organ i notifikuar ekzaminon projektimin teknik të një artikulli piroteknik dhe verifikon e vërteton nëse projektimi teknik i atij artikulli piroteknik plotëson kërkesat e këtij ligji për rastet kur ajo përdoret.

2. Kontrolli tip EU kryhet si një vlerësim për përshtatshmërinë e projektimit teknik të artikullit piroteknik përmes kontrollit të dokumentacionit teknik dhe evidencës mbështetëse, të përcaktuar në pikën 3 të këtij moduli, si edhe kontrollin e mostrës, përfaqësuesit të produktit të përcaktuar, kontrollin e të gjithë produktit (kombinimin e llojit të produktit me llojin e projektimit).

3. Aplikimi për kontrollin tip EU duhet të paraqitet nga prodhuesi te një organ i notifikuar, i zgjedhur prej tij. Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit;

b) një deklaratë me shkrim, ku thuhet se i njëjti aplikim nuk është paraqitur te ndonjë organ tjetër i notifikuar;

c) dokumentacionin teknik:

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë vlerësimin e përputhshmërisë së artikullit me kërkesat e aplikueshme të këtij ligji dhe duhet të përfshijë analizën dhe vlerësimin e duhur të riskut. Gjithashtu, dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e aplikueshme dhe përfshin, për sa kohë që është relevante për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e artikullit piroteknik.

Dokumentacioni teknik përmban, kur është e mundur, të paktën elementet e mëposhtme:

i. një përshkrim të përgjithshëm të artikullit piroteknik;

ii. projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrame të komponentëve, nënkomplete, qarqe etj.;

iii. përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar skicimet dhe diagramet, si dhe funksionimin e artikullit piroteknik;

iv. listën e standardeve të harmonizuara që zbatohen plotësisht ose pjesërisht, referencat, të



cilat janë botuar në Fletoren Zyrtare dhe, në rast të mosaplikimit të standardeve, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë të këtij ligji, duke përfshirë specifikimet relevante teknike që janë aplikuar. Në raste të zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë aplikuar;

v. rezultatet e llogaritjeve të bëra në lidhje me projektin, ekzaminimet e kryera etj.;

vi. raportet e testit;

ç) mostrat përfaqësuese të produktit të paraparë. Organi i notifikuar mund të kërkojë mostra të tjera, nëse nevojiten për të kryer programin e testimit;

d) evidenca mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektimit teknik. Kjo evidencë mbështetëse përmend çdo dokument që është përdorur, sidomos në rastin kur standardet relevante të harmonizuara nuk janë aplikuar në mënyrë të plotë. Evidenca mbështetëse përfshin, në rastet e nevojshme, rezultatet e testeve, të kryera në përputhje me specifikimet e tjera relevante nga ana e laboratorit të prodhuesit apo nga ana e një laboratorit tjetër testues në emër ose nën përgjegjësinë e tij.

4. Organizmi i notifikuar

4.1 Për artikujt piroteknikë:

Ekzaminon dokumentacionin dhe evidencën mbështetëse për të verifikuar përputhshmërinë e projektimit teknik të artikullit piroteknik.

4.2 Për mostrën/mostrat:

Verifikon nëse tipi/at janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe identifikon elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat e aplikueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara, si dhe elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat specifikimet e tjera përkatëse teknike.

4.3 Kryen ose urdhëron kryerjen e ekzaminimeve dhe testeve për të kontrolluar, nëse janë zbatuar siç duhet standardet e harmonizuara përkatëse, në rastet kur prodhuesi ka zgjedhur t'i zbatojë ato.

4.4 Kryen ekzaminime dhe testime të përshtatshme ose i kryen ato për të kontrolluar nëse zgjidhjet e bëra nga prodhuesi, në rastet kur nuk janë aplikuar standardet relevante të harmonizuara, duke përfshirë edhe ato raste e specifikime të tjera relevante teknike të aplikuara, i plotësojnë ose jo kërkesat e sigurisë të këtij ligji.

4.5 Bie dakord me prodhuesin për vendin ku do të kryhen ekzaminimet dhe testet.

5. Organizmi i notifikuar përpilon një raport vlerësues, i cili regjistron veprimtarinë e bërë në përputhje me pikën 4 të këtij moduli dhe rezultatet e tyre. Pa paragjykuar detyrimet e saj *vis-à-vis* autoritetet notifikuese, organi i notifikuar lëshon përmbajtjen e atij raporti, të plotë ose të pjesshëm, vetëm me anë të marrëveshjes me prodhuesin.

6. Në rastet kur lloji plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji, që zbatohet për artikujt piroteknikë në fjalë, organi i notifikuar duhet t'i japë aplikantit një certifikatë ekzaminimi të tipit EU. Certifikata duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, rezultatet e ekzaminimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë dhe të dhënat e domosdoshme për identifikimin e tipit të miratuar. Certifikata e ekzaminimit të tipit EU mund të ketë një apo më shumë shtojca të bashkëngjitura.

Certifikata e ekzaminimit të tipit EU dhe shtojcat e saj përmbajnë të gjithë informacionin relevant për të mundësuar ekzaminimin e përputhshmërisë së artikujve të prodhuar piroteknikë e të atyre të ekzaminuar dhe të mundësojë kontrollin gjatë shërbimit.

Në rastet kur tipi nuk përmbush mjaftueshëm kërkesat e aplikueshme të këtij ligji, organi i notifikuar refuzon lëshimin e certifikatës ekzaminuese të tipit EU dhe informon aplikuesin për këtë gjë, duke dhënë hollësi dhe arsye për këtë refuzim.

7. Organizmi i notifikuar duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim të asaj që konsiderohet gjerësisht si moderne dhe që mund të tregojë se tipi i miratuar nuk është më në përputhje me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji dhe organi i notifikuar përcakton nëse ndryshime të tilla kërkojnë hetime të mëtejshme. Nëse është kështu, organi i notifikuar duhet të informojë prodhuesin në mënyrën e duhur.

Prodhuesi informon organin e notifikuar që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën ekzaminuese tip EU, për të gjitha modifikimet e artikullit të miratuar, që mund të cenojnë përputhshmërinë e artikullit piroteknik me kërkesat kryesore të sigurisë së këtij ligji ose me kushtet për vlefshmërinë e kësaj certifikate. Modifikimet e tilla kërkojnë miratim të mëtejshëm në formën e një certifikate ekzaminuese shtesë të tipit EU, përveç origjinale.



8. Çdo organizëm i notifikuar duhet të informojë autoritetin e tij notifikues, në lidhje me certifikatat e ekzaminimit tip EU dhe/ose çdo shtojcë që ka lëshuar apo, dhe që në mënyrë periodike sipas kërkesës, vë në dispozicion të autoriteteve të saj notifikuese listën e certifikatave të tilla dhe/ose çdo shtojcë të refuzuar, të pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organizëm i notifikuar duhet të informojë organet e tjera të notifikuara, në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të tipit EU dhe/ose çdo shtojcë që ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar dhe, sipas kërkesës, lidhur me certifikatat dhe/ose plotësimet e tyre, të cilat i ka lëshuar.

Autoritet shtetërorë, sipas kërkesës, mund të marrin një kopje të certifikatave të ekzaminimit të tipit EU dhe/ose shtesa e tyre. Sipas kërkesës, ato mund të marrin një kopje të dokumentacionit teknik e të rezultateve të ekzaminimeve të kryera nga organi i notifikuar. Organi i notifikuar mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit tip EU, shtojcat dhe shtesat e tij, si dhe dosjen teknike, duke përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi, deri në skadimin e vlefshmërisë së asaj certifikate.

9. Prodhuesi duhet të mbajë një kopje të certifikatës ekzaminuese tip EU, shtojcat e saj, së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve të vendit, për një periudhë prej të paktën 10 (dhjetë) vjet pas daljes në treg të artikullit në fjalë.

MODULI C2

Përputhshmëria me tipin e bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm, si edhe kontrollet e mbikëqyrura të produktit në intervale të rastësishme kohore

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm, si edhe kontrollet e mbikëqyrura të produktit në intervale të rastësishme kohore janë pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë, ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij moduli, siguron dhe deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se artikujt piroteknikë në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji që aplikohen për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë që artikujt piroteknikë të prodhuar të përputhen me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe me kërkesat e këtij ligji, që aplikohen për to.

3. Kontrollat ndaj produktit

Organizmi i notifikuar i zgjedhur nga prodhuesi kryen ekzaminime të artikullit në intervale jo të rregullta të përcaktuara nga organi për të kontrolluar cilësinë e kontrolleve të brendshme të artikujve piroteknikë, duke marrë parasysh, ndër të tjera, kompleksitetin teknologjik të artikujve piroteknikë dhe sasinë e prodhimit. Për të kontrolluar përputhshmërinë e artikullit piroteknik me certifikatën ekzaminuese tip EU dhe me kërkesat e këtij ligji, një mostër e përshtatshme e artikujve përfundimtarë, e marrë në vendin e prodhimit nga organi i notifikuar përpara se të dalë në treg, duhet të ekzaminohet dhe duhet të kryhen testet e përshtatshme të përcaktuara të specifikimit e tjera relevante. Në rast se një mostër nuk përputhet me nivelin e pranueshëm të cilësisë, organi merr masat e duhura.

Procedura që aplikohet për pranimin e mostrës ka për qëllim të përcaktojë nëse procesi i prodhimit të artikullit piroteknik bëhet brenda kufijve të pranueshëm, duke pasur parasysh sigurimin e përputhshmërisë me artikullin piroteknik.

Gjatë procesit të prodhimit, prodhuesi, nën përgjegjësinë e organit të notifikuar, duhet të vendosë numrin e identifikimit të organit të notifikuar.

4. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë së BE-së

4.1 Prodhuesi bën markimin CE për secilin artikull piroteknik që është në përputhje me tipin e paraparë në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e aplikueshme të këtij ligji.

4.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë EU me shkrim për përputhshmërinë e secilit produkt dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 (dhjetë) vjet, që nga dalja në treg e artikullit piroteknik. Deklarata e përputhshmërisë EU identifikon artikullin piroteknik për të cilin ajo është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë EU vihet në dispozicion të autoriteteve relevante, në vijim të kërkesës.



MODULI D

Përputhshmëria me tipin e bazuar në garantimin e cilësisë së procesit të prodhimit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë, ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 5, të këtij moduli, siguron dhe deklaron me përgjegjësi vetëm të tij, se artikujt piroteknikë në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji që aplikohen për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar cilësie për inspektimin dhe testimin e artikujve përkatës piroteknikë, siç specifikohet në pikën 3 të këtij moduli, dhe ai i nënshtrohet monitorimit të përmendur në pikën 4 të këtij moduli.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi i paraqet organit të notifikuar, të zgjedhur prej tij, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për artikujt e tij piroteknikë.

Aplikimi përmban:

- a) emrin dhe adresën e prodhuesit;
- b) një deklaratë me shkrim që aplikimi i njëjtë nuk është dorëzuar në asnjë organ tjetër të notifikuar;
- c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e paraparë të artikullit piroteknik;
- ç) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

d) dokumentacionin teknik për tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip EU.

3.2 Sistemi i cilësisë siguron që artikujt piroteknikë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që përmbush kërkesat e direktivës që aplikohen për to.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentimi lidhur me sistemin e cilësisë mundëson një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave për cilësinë.

Ato duhet të përmbajnë sidomos një përshkrim të saktë:

a) të objektivave të cilësisë, si dhe të strukturës organizative, përgjegjësi e kompetencave të drejtuesve në lidhje me cilësinë e produktit;

b) teknikat dhe proceset korresponduese të prodhimit, kontrollit të cilësisë e garancisë dhe veprimet sistematike që do të përdoren;

c) ekzaminimet dhe testet që do të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe sa shpesh do të kryhen ato;

ç) dokumenteve të cilësisë, si raportet e inspektimit e të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit dhe raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.;

d) mjetet e monitorimit të realizimit të cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimin efikas të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i notifikuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.2 të këtij moduli.

Ai duhet të prezumojë përputhshmërinë me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet e standardit relevant të harmonizuar.

Përveç përvojës me sistemet e menaxhimit të cilësisë, grupi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë në vlerësim për fushën relevante të prodhimit dhe të teknologjisë së saj e të ketë njohuri të kërkesave të zbatueshme të këtij ligji. Auditimi përfshin edhe një vizitë vlerësuese në mjediset e prodhuesit. Ekipi i auditimit shqyrton dokumentacionin teknik të paraparë në pikën 3.1(d) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e artikullit piroteknik me këto kërkesa.

Prodhuesi njoftohet për vendimin. Njoftimi përmban përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta mbajë atë në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë vazhdimisht të informuar organin e notifikuar, që ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të propozuar të sistemit të cilësisë.

Organi i notifikuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i ndryshuar do të vazhdojë t'i



përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 të këtij moduli, apo nëse nevojitet rivlerësim.

Vendimi i arsyetuar i vlerësimit duhet t'i bëhet i ditur prodhuesit. Njoftimi përmban rezultatet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të notifikuar.

4.1 Qëllimi i monitorimit është garantimi që prodhuesi i përmbush siç duhet detyrimet që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi lejon organin e notifikuar që të hyjë në mjediset e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit për qëllime inspektimi dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentet lidhur me sistemin e cilësisë;

b) raportet e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrit, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.;

4.3 Organi i notifikuar kryen auditime periodike për të garantuar që prodhuesi mirëmban e zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë atij raportin e auditimit.

4.4 Përveç këtij, organi i notifikuar mund të bëjë vizita të panjoftuara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i notifikuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste ose të caktojë të tjerë për kryerjen e tyre, me qëllimin për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon siç duhet. Organi i notifikuar duhet t'i japë prodhuesit raportin për vizitën e kryer dhe, nëse janë kryer teste, raportin e testimeve.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë EU.

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të notifikuar, të cilit i referohet pika 3.1 e këtij moduli, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit te çdo artikull piroteknik që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë EU për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 (dhjetë) vjet që nga koha kur artikulli piroteknik është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë EU identifikon artikullin piroteknik për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë EU vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Prodhuesi vë në dispozicion të autoriteteve të vendit, për një periudhë 10-vjeçare pas vendosjes në treg të artikullit piroteknik, si më poshtë vijon:

a) dokumentacionin e përmendur në pikën 3.1 të këtij moduli;

b) informacionin që ka të bëjë me ndryshimin e përmendur në pikën 3.5 të këtij moduli, të miratuar;

c) vendimet dhe raportet e organit të notifikuar të përmendur në pikat 3.5, 4.3 e 4.4 të këtij moduli.

7. Çdo organ i notifikuar informon autoritetet notifikuese për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të tërhequra dhe në mënyrë periodike apo në vijim të kërkesës, vë në dispozicion të autoriteteve notifikuese listën e sistemit të cilësisë, të miratuar, refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i notifikuar informon organet e tjera të notifikuara për miratimet e sistemit të cilësisë, të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr apo kufizuar dhe, në vijim të kërkesës, vë në dispozicion miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

MODULI E

Përputhshmëria me tipin bazuar në garantimin e cilësisë së produktit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë, ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 5 të këtij moduli, dhe siguron e deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se artikujt piroteknikë në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji, që aplikohen për ato.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar cilësie për inspektimin dhe testimin e artikujve përkatës piroteknikë, siç specifikohet në pikën 3 të këtij moduli, dhe ai i nënshtrohet monitorimit të përmendur në pikën 4 të këtij moduli.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi i paraqet organit të notifikuar, të zgjedhur prej tij, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për artikujt e tij piroteknikë.

Aplikimi përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit;



b) një deklaratë me shkrim që aplikimi i njëjtë nuk është dorëzuar në asnjë organ tjetër të notifikuar;

c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e paraparë të artikullit piroteknik;

ç) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

d) dokumentacionin teknik për tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip EU.

3.2 Sistemi i cilësisë siguron që artikujt piroteknikë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që përmbush kërkesat e direktivës që aplikohen për ato.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentimi në lidhje me sistemin e cilësisë mundëson një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave për cilësinë.

Ato duhet të përmbajnë sidomos një përshkrim të saktë të:

a) objektivave të cilësisë, si dhe të strukturës organizative, përgjegjësive dhe kompetencave të drejtuesve në lidhje me cilësinë e produktit;

b) ekzaminimet dhe testet që do të kryhen pas prodhimit;

c) dokumentimi i cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit dhe raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.;

ç) mjetet e monitorimit të funksionimit efikas të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i notifikuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.2 të këtij moduli.

Ai duhet të prezumojë përputhshmërinë me këto kërkesa lidhur me elementet e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet e standardit relevant të harmonizuar.

Përveç përvojës me sistemet e menaxhimit të cilësisë, grupi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë në vlerësim për fushën relevante të prodhimit dhe teknologjisë së saj dhe të ketë njohuri të kërkesave të zbatueshme të këtij ligji. Auditimi përfshin edhe një vizitë vlerësuese në mjediset e prodhuesit. Ekipi i auditimit shqyrton dokumentacionin teknik të paraparë në pikën 3.1

(d) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e artikullit piroteknik me këto kërkesa.

Prodhuesi njoftohet për vendimin. Njoftimi përmban përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta mbajë atë në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë vazhdimisht të informuar organin e notifikuar që ka miratuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të propozuar të sistemit të cilësisë.

Organi i notifikuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i ndryshuar do të vazhdojë t'i përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 të këtij moduli, apo nëse nevojitet rivlerësim.

Vendimi i arsyetuar i vlerësimit duhet t'i bëhet i ditur prodhuesit. Njoftimi përmban rezultatet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të notifikuar

4.1 Qëllimi i monitorimit është garantimi që prodhuesi i përmbush siç duhet detyrimet që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi e lejon, për qëllime vlerësimi, organin e notifikuar që të hyjë në mjediset e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit për qëllime inspektimi dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

b) raportet e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë.

4.3 Organi i notifikuar kryen auditime periodike për të garantuar që prodhuesi mirëmban e zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë atij raportin e auditimit.

4.4 Përveç këtij, organi i notifikuar mund të bëjë vizita të panjoftuara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i notifikuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste ose të caktojë të tjerë për kryerjen e tyre, me qëllimin për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon siç duhet. Organi i notifikuar duhet t'i japë prodhuesit



raportin për vizitën e kryer dhe, nëse janë kryer teste, raportin e testimeve.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë EU

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe, nën përgjegjësinë e organit të notifikuar, të cilit i referohet pika 3.1 e këtij moduli, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit të çdo artikull piroteknik që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë EU për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 (dhjetë) vjet që nga koha kur artikulli piroteknik është hedhur në treg. Deklarata e përputhshmërisë EU identifikon artikullin piroteknik për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë EU vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Prodhuesi vë në dispozicion të autoriteteve të vendit për një periudhë 10-vjeçare pas vendosjes në treg të artikullit piroteknik si më poshtë:

a) dokumentacionin e përmendur në pikën 3.1, të këtij moduli;

b) informacionin që ka të bëjë me ndryshimin e përmendur në pikën 3.5, të këtij moduli, të miratuar;

c) vendimet dhe raportet e organit të notifikuar të përmendura në pikat 3.5, 4.3. dhe 4.4, të këtij moduli.

7. Çdo organ i notifikuar informon autoritetet notifikuese për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të tërhequra dhe në mënyrë periodike apo në vijim të kërkesës vë në dispozicion të autoriteteve notifikuese listën e sistemit të cilësisë, të miratuar, refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i notifikuar informon organet e tjera të notifikuara për miratimet e sistemit të cilësisë, të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr apo kufizuar dhe në vijim të kërkesës vë në dispozicion miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

MODULI F

Përputhshmëria e bazuar te verifikimi i njësisë

1. Përputhshmëria e bazuar te verifikimi i njësisë është procedura e vlerësimit të përputhshmërisë me

anë të së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 5 të këtij moduli, dhe garanton e deklaron me përgjegjësinë e tij të vetme se artikulli piroteknik në fjalë, objekt i dispozitave të pikës 4 të këtij moduli, është në përputhje me kërkesat e këtij ligji, që aplikohen për të.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi përpilon dokumentacionin teknik dhe e vë atë në dispozicion të organit të notifikuar të përmendur në pikën 4 të këtij moduli. Dokumentacioni mundëson vlerësimin e përputhshmërisë së artikullit piroteknik me kërkesat përkatëse dhe duhet të përfshijë një analizë adekuate dhe vlerësimin e riskut. Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe, sa i përket vlerësimit, ai përfshin projektimin, prodhimin e funksionimin e artikullit piroteknik. Dokumentacioni teknik, kudo që është i zbatueshëm, duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të përgjithshëm të artikullit piroteknik;

b) projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrame të komponentëve, nënkomplete, qarqe etj.;

c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato projekte dhe skicime, si dhe funksionimin e artikullit piroteknik;

ç) listën e standardeve të harmonizuara që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, referencat që janë botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe, në rast të moszbatimit të standardeve të harmonizuara, të japë përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë të këtij ligji, duke përfshirë edhe një listë tjetër përkatëse të specifikimeve teknike të aplikuara. Në rast të zbatimit të pjesës së standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët të cilat janë zbatuar;

d) rezultatet e llogaritjeve të projektit dhe ekzaminimet e kryera etj.;

dh) raportet e testit.

Prodhuesi ruan dokumentacionin teknik dhe e vë në dispozicion të autoriteteve përkatëse të vendit për 10 (dhjetë) vjet, pasi artikulli piroteknik ka dalë në treg.

3. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhshmërinë e artikullit të



prodhuar piroteknik me kërkesat e aplikueshme të këtij ligji.

4. Verifikimi

Një organ i notifikuar, i zgjedhur nga prodhuesi, kryen ekzaminimet dhe testet përkatëse, të përcaktuara të standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikime të tjera teknike, për të kontrolluar përputhshmërinë e artikullit piroteknik me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji, ose t'i kryejë përmes të tjerëve. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi në fjalë i notifikuar vendos për kryerjen e testeve të duhura.

Organi i notifikuar lëshon një certifikatë përputhshmërie në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe vendos numrin e identifikimit tek artikulli piroteknik i miratuar ose e vendos atë numër me anë të të tjerëve nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi ruan certifikatat e përputhshmërisë dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve të vendit për inspektim për 10 (dhjetë) vjet, pasi artikulli piroteknik të jetë vendosur në treg.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë EU

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe, nën përgjegjësinë e organit të notifikuar, të cilit i referohet pika 4 e këtij moduli, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit të çdo artikulli piroteknik, që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU e që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë EU për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 (dhjetë) vjet që nga koha kur artikulli piroteknik është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë EU identifikon artikullin piroteknik për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë EU vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

MODULI G

Përputhshmëria e bazuar në garantimin e plotë të cilësisë

1. Përputhshmëria e bazuar në garantimin e plotë të cilësisë është procedura e vlerësimit të përputhshmërisë, ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 5 të këtij

moduli, siguron e deklaron me përgjegjësi vetëm të tij, se artikujt piroteknikë në fjalë përmbushin kërkesat e këtij ligji që aplikohen për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar cilësie për projektim, prodhim dhe inspektim përfundimtar të produktit e të artikujve përkatës piroteknikë, siç specifikohet në pikën 3 të këtij moduli, dhe ai i nënshtrohet monitorimit të përmendur në pikën 4 të këtij moduli.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi i paraqet organit të notifikuar, të zgjedhur prej tij, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për artikujt e tij piroteknikë.

Aplikimi përmban si më poshtë:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit;

b) dokumentacionin teknik për një model të secilës kategori të artikullit piroteknik që do të prodhohet. Dokumentacioni teknik, në rastet e zbatueshme, përmban të paktën elementet e mëposhtme:

- një përshkrim të përgjithshëm të artikullit piroteknik;

- projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrame të komponentëve, nënkomplete, qarqe etj.;

- përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar skicimet dhe diagramet, si dhe funksionimin e artikullit piroteknik;

- listën e standardeve të harmonizuara që zbatohen plotësisht ose pjesërisht, referencat, të cilat janë botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, si dhe në rast të mosaplikimit të standardeve, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë të këtij ligji, duke përfshirë një listë të specifikimeve përkatëse teknike që janë aplikuar. Në raste të zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë aplikuar;

- rezultatet e llogaritjeve të bëra në lidhje me projektin, ekzaminimet e kryera etj.;

- raportet e testit.

- c) dokumentacioni në lidhje me sistemin e cilësisë;

- ç) një deklaratë me shkrim që aplikimi i njëjtë nuk është dorëzuar në asnjë organizëm tjetër të notifikuar.



3.2 Sistemi i cilësisë siguron që artikujt piroteknikë janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentimi në lidhje me sistemin e cilësisë mundëson një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave për cilësinë.

Ato duhet të përmbajnë një përshkrim të saktë:

a) të objektivave të cilësisë, si dhe të strukturës organizative, përgjegjësisve dhe kompetencave të drejtuesve lidhur me projektimin e cilësinë e produktit;

b) specifikimet e projektimit teknik, duke përfshirë standardet që do të zbatohen dhe, në rast se standardet e harmonizuara nuk do të zbatohen në mënyrë të plotë, të përshkruajë mjetet që do të përdoren për të përmbushur kërkesat kryesore të sigurisë të këtij ligji;

c) kontrollin e projektimit e teknikat e verifikimit të projektimit, proceset dhe veprimet sistematike që do të përdoren gjatë projektimit të artikujve piroteknikë që lidhen me kategoritë përkatëse të artikullit piroteknik;

ç) teknikat korresponduese të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që do të kryhen;

d) ekzaminimet e testet që do të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe sa shpesh do të kryhen ato;

dh) dokumentacionin e cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.;

e) mjetet e monitorimit për realizimin e projektimit të kërkuar dhe cilësisë së produktit dhe funksionimin efikas të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i notifikuar duhet të vlerësojë sistemin e cilësisë për të përcaktuar, nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.2 të këtij moduli.

Ai duhet të prezumojë përputhshmërinë me këto kërkesa lidhur me elementet e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet e standardit relevant të harmonizuar.

Përveç përvojës me sistemet e menaxhimit të cilësisë, grupi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë në vlerësim për fushën relevante

të prodhimit e teknologjisë së saj dhe të ketë njohuri të kërkesave të zbatueshme të këtij ligji. Auditimi përfshin edhe një vizitë vlerësuese në mjediset e prodhuesit. Ekipi i auditimit shqyrton dokumentacionin teknik të paraparë në pikën 3.1 (b), të këtij moduli, për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e artikullit piroteknik me këto kërkesa.

Prodhuesi njoftohet për vendimin.

Njoftimi përmban përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta mbajë atë në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë vazhdimisht të informuar organin e notifikuar që ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të propozuar të sistemit të cilësisë.

Organi i notifikuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i ndryshuar do të vazhdojë t'i përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 të këtij moduli, apo nëse nevojitet rivlerësim.

Vendimi i arsyetuar i vlerësimit duhet t'i bëhet i ditur prodhuesit. Njoftimi përmban rezultatet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Monitorimi nën përgjegjësinë e organit të notifikuar

4.1 Monitorimi i KE-së ka si qëllim të garantojë që prodhuesi i përmbush siç duhet detyrimet që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi duhet ta lejojë organin e notifikuar që të hyjë në mjediset e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit për qëllime vlerësimi dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentacionin lidhur me sistemin e cilësisë;

b) raportet e cilësisë, sipas sistemit të cilësisë për fushën e zhvillimit, si p.sh.: rezultatet e analizave, përlllogaritjeve dhe testeve etj.;

c) raportet e cilësisë, të siguruara sipas sistemit të cilësisë për fushën e prodhimit, si p.sh.: raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrimit dhe raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.



4.3 Organi i notifikuar duhet të kryejë kontrole periodike për të garantuar që prodhuesi mirëmban e zbaton sistemin e cilësisë dhe i jep atij raportin e kontrollit.

4.4. Përveç kësaj, organi i notifikuar mund të bëjë vizita të panjoftuara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i notifikuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste ose të caktojë të tjerë për kryerjen e tyre, me qëllimin për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon siç duhet. Organi i notifikuar duhet t'i japë prodhuesit raportin për vizitën e kryer dhe, nëse është kryer ndonjë test, raportin e testeve.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë EU

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe, nën përgjegjësinë e organit të notifikuar, të cilit i referohet pika 3.1 e këtij moduli, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit te çdo artikull piroteknik, që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë EU për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 (dhjetë) vjet, që nga koha kur artikulli piroteknik ka dalë në treg. Deklarata e përputhshmërisë EU identifikon artikullin piroteknik për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë EU vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Prodhuesi vë në dispozicion të autoriteteve të vendit, për një periudhë 10-vjeçare, pas daljes në treg të artikullit piroteknik si më poshtë:

a) dokumentin e përmendur në pikën 3.1 të këtij moduli;

b) dokumentin që ka të bëjë me sistemin e cilësisë së përmendur në pikën 3.1 të këtij moduli;

c) informacionin që ka të bëjë me ndryshimin e përmendur në pikën 3.5 të këtij moduli, të miratuar;

ç) vendimet dhe raportet e organit të notifikuar të përmendura në pikat 3.5 dhe 4.3 të këtij moduli.

7. Çdo organ i notifikuar informon autoritetet notifikuese për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të tërhequra dhe në mënyrë periodike apo në vijim të kërkesës, vë në dispozicion të autoriteteve notifikuese listën e sistemit të cilësisë, të miratuar, refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i notifikuar informon organet e tjera të notifikuara për miratimet e sistemit të cilësisë, të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr apo kufizuar dhe, në vijim të kërkesës, vë në dispozicion miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

SHTOJCA III

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË EU (NR.XXXX)

1. Numri i regjistrimit në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;

2. Numri i prodhimit, tregtimit dhe numrin e serisë;

3. Emri dhe adresa e prodhuesit;

4. Kjo deklaratë e përputhshmërisë lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit;

5. Objekti i deklaratës (identifikimi i produktit që mundëson gjurmimin e artikullit piroteknik);

6. Objekti i deklaratës i përshkruar më lart është në përputhje me legjislacionin harmonizues përkatës të Bashkimit Evropian;

7. Referencat lidhur me standardet e përdorura relevante të harmonizuara apo referencat e specifikimeve të tjera teknike në lidhje me përshtatshmërinë e deklaruar;

8. Organi i notifikuar ... (emri, numri) ka kryer ... (përshkrimi i ndërhyrjes) dhe lëshon certifikatën:

9. Informacione shtesë:

E nënshkruar për dhe në emër të:

(vendi dhe data e lëshimit)

(emri, funksioni)

(nënshkrimi)

**LIGJ**
Nr. 74/2021**PËR HEDHJEN NË TREG DHE**
MBIKËQYRJEN E LËNDËVE PLASËSE
PËR PËRDORIM CIVIL²

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton:

1. Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil, në mënyrë që të garantohet dhe të sigurohet përputhshmëria e tyre me kërkesat ligjore në drejtim të sigurisë, shëndetit, mbrojtjes së interesave të publikut dhe konkurrencës së drejtë në tregun vendas.

2. Kushtet dhe kriteret për prodhimin, importimin, eksportimin, tregtimin, transportimin, transferimin, magazinimin, përdorimin, transitin, asgjësimin, kërkimin, testimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse, si dhe kriteret për mbikëqyrjen dhe aplikimin e këtij ligji me qëllim mbrojtjen e njerëzve, pasurisë dhe mjedisit.

3. Mënyrën e organizimit, të drejtat dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për kontrollin, mbikëqyrjen dhe sigurinë gjatë zinxhirit të furnizimit deri te përdoruesi final.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për lëndët plasëse për përdorim civil.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

a) lëndët plasëse, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin vendas në fushën e mbrojtjes, sigurisë kombëtare dhe rendit publik nga Forcat e Armatosura ose Policia e Shtetit;

b) artikujt piroteknikë;

c) municionet, të cilat përdoren sipas legjislacionit vendas.

3. Shtojca I përmban një listë të artikujve piroteknikë dhe municioneve të referuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni dhe në pikën 17 të nenit 3, që identifikohen respektivisht sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara për transportimin e mallrave të rrezikshme.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara, siç jepet në legjislacionin në fuqi për standardizimin dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

2. “Asgjësimi i lëndëve plasëse” është shkatërrimi përfundimtar i lëndëve plasëse përmes detonimit dhe/ose incinerimit ose përmes konvertimit të tyre në lëndë joplasëse, me anë të procedurave të tjera, duke respektuar kriteret e sigurisë dhe kriteret e përcaktuara për vlerësimin e ndikimit në mjedis të substancave shpërthyes.

3. “Autorizim” është vendimi i marrë nga autoriteti shtetëror, që i njeh titullarit të saj të drejtën të kryejë një ose disa veprime për lejimin e transferimit, eksportimit, importimit, transimit, magazinimit, përdorimit ose asgjësimit të lëndëve plasëse. Kusht për marrjen e autorizimit është pajisja e operatorit ekonomik me licencën përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me Direktivën 2014/28/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”. Numri CELEX 32014L0028 Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 96, datë 29.3.2014, faqe 1–44.



4. “Certifikatë e përdoruesit fundor” është një dokument i lëshuar me kërkesë të përdoruesit fundor, i certifikuar nga një organ kompetent i vendit të përdoruesit fundor të lëndës plasëse.

5. “Eksport” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në Kodin Doganor.

6. “Eksportues” është çdo person fizik/tregtar ose juridik, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili eksporton lëndë plasëse që prodhohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

7. “Bërje e disponueshme e produktit në treg/hedhje në treg” është çdo furnizim i lëndës plasëse në treg për shpërndarje, konsum ose përdorim të tij gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

8. “Import” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në Kodin Doganor.

9. “Importues” është çdo person fizik/tregtar ose personi juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili vendos në treg një lëndë plasëse që vjen nga një vend i huaj.

10. “Inspektim” është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

11. “Kthim i produktit” është çdo masë për kthimin mbrapsht të një lënde plasëse, që është bërë ndërkohë e disponueshme te përdoruesi i fundit.

12. “Lëndë jofunksionale” është lënda plasëse, e cila nëpërmjet një procesi teknologjik kthehet në lëndë joplasëse dhe humbet totalisht fuqinë shpërthyes.

13. “Lëndë plasëse” janë të gjitha ato bashkime ose përzierje të ndryshme kimike, të cilat pa praninë e oksigjenit, nën ndikimin e ngacmimeve të jashtme, pësojnë ndryshime shumë të shpejta fiziko-kimike, të shoqëruara me temperaturë të lartë dhe çlirim gazrash në sasi e presion të lartë, të afta për të kryer punë, që plotësojnë standardet e përdorimit në veprimtari civile, si dhe materialet dhe artikujt që konsiderohen lëndë plasëse sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave të rrezikshme dhe që kategorizohen në klasën 1 të këtyre rekomandimeve.

14. “Licencë” është vendimi i marrë nga autoriteti shtetëror që i njeh titullarit të saj të drejtën të ushtrojë veprimtari si operator ekonomik për të prodhuar, importuar, eksportuar dhe tregtuar lëndë plasëse ose të pajiset me autorizim për

transferimin, transitin, eksportin dhe importin e lëndëve plasëse.

15. “Magazinë e përkohshme” është një dhomë, kriteret e ndërtimit, ato teknike dhe të sigurisë të së cilës përcaktohen me rregullore të veçantë nga struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon çështjet minerare dhe që synohet të përdoret për magazinimin e lëndëve plasëse.

16. “Magazinim” është mbajtja e lëndëve plasëse gjatë prodhimit, tregtimit dhe përdorimit në mjediset e synuara për atë qëllim.

17. “Markim CE” është markimi me të cilin prodhuesi tregon që produkti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon vendosjen e këtij markimi.

18. “Mbikëqyrje e tregut” janë veprimtaritë e kryera dhe masat e marra nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut (më poshtë “struktura përgjegjëse”) për të garantuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore në lidhje me të, me qëllim që të mos rrezikohen shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik.

19. “Municione” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për armët.

20. “Ndalim i tregtimit” është çdo masë e marrë përgjatë të gjithë zinxhirit të furnizimit për të parandaluar hedhjen në treg të lëndës plasëse.

21. “Numri i Kombeve të Bashkuara” është numri identifikues dhe shkalla e rrezikshmërisë së materialeve të rrezikshme, ndezëse dhe shpërthyes, të renditura në tabelën e Marrëveshjes Evropiane për Transportimin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme.

22. “Objekte për magazinimin dhe prodhimin e lëndëve plasëse” janë objekte të mbyllura dhe të kontrolluara, të synuara për prodhimin, magazinimin, ngarkimin dhe shkarkimin e lëndëve plasëse, të cilat janë të ndërtuara dhe të pajisura në mënyrë të tillë që garantojnë mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, mbrojtjen e pronës dhe të mjedisit.

23. “Operator ekonomik” është prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi, shpërndarësi dhe çdo person tjetër fizik/tregtar ose juridik, i cili ka si objekt të veprimtarisë së tij magazinimin, përdorimin, transferimin, importimin, eksportimin, tregtimin ose asgjësimin e lëndëve plasëse.

24. “Organ i miratuar” ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të dhënë në ligjin përkatës për mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.



25. “Organi i vlerësimit të përputhshmërisë” është organi që kryen procesin e vlerësimit të përputhshmërisë, duke përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

26. “Organizëm evropian i notifikuar” është organizmi i vlerësimit të përputhshmërisë, i miratuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, i notifikuar prej këtij të fundit në Komisionin Evropian (KE) dhe i regjistruar në faqen zyrtare të KE-së si një trup kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të përputhshmërisë së produktit për vendosjen e markimit CE.

27. “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organi sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

28. “Përdorimi i lëndëve plasëse” është përgatitja e drejtpërdrejtë për aktivizim dhe aktivizimi i lëndëve plasëse.

29. “Përfaqësuesi i autorizuar” është çdo person fizik/tregtar ose juridik me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili ka marrë nga prodhuesi një autorizim me shkrim për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyra të caktuara.

30. “Prodhim i lëndëve plasëse” është prodhimi, përpunimi ose modifikimi i lëndëve plasëse, si dhe montimi e çmontimi i tyre.

31. “Prodhuesi” është një person fizik/tregtar ose juridik, i cili prodhon një lëndë plasëse ose bën të mundur projektimin ose prodhimin e saj dhe e tregton atë me emrin e tij apo markën tregtare ose e përdor për qëllime të veta.

32. “Rregullat teknike të lëndëve plasëse” janë rregullat që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse.

33. “Siguri”, në kuptim të këtij ligji, është parandalimi i aksidenteve dhe atëherë kur parandalimi dështon, minimizimi i pasojave të tyre.

34. “Siguri publike” është parandalimi i përdorimit të lëndëve plasëse për qëllime që bien në kundërshtim me rendin publik.

35. “Specifikime teknike” është një dokument, i cili përshkruan kriteret teknike që duhet të përmbushë një lëndë plasëse.

36. “Standard shqiptar i harmonizuar” është standardi shqiptar, që transponon një standard të harmonizuar evropian, siç jepet në legjislacionin në fuqi për standardizimin, në mbështetje të këtij ligji dhe të rregullave teknike, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në

bashkërendim me ministrinë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

37. “Subjekti i inspektimit” është çdo person fizik/tregtar ose juridik, privat ose publik, që ka sipas ligjit detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.

38. “Shpërndarës” është çdo person fizik/tregtar ose juridik në zinxhirin e furnizimit, i ndryshëm nga prodhuesi ose importuesi, i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij hedh në treg një lëndë plasëse.

39. “Tërheqje nga tregu” është çdo masë e marrë nga operatorët ekonomikë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, që synon parandalimin e daljes në treg të lëndës plasëse në zinxhirin e furnizimit.

40. “Trajtim i lëndëve plasëse” është kryerja e veprimeve në lidhje me prodhimin, testimin, magazinimin, tregtimin, transportimin, përdorimin e lëndëve plasëse.

41. “Transferim” është çdo lëvizje fizike e lëndëve plasëse brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe transportin tokësor dhe detar të lëndëve plasëse, që hyjnë dhe kalojnë përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, me destinacion një vend jashtë Shqipërisë dhe pa ndërruar pronësinë e mallrave, përveç lëvizjeve brenda kantierit ose vendit të punës.

42. “Transit” është regjimi doganor sipas përcaktimeve të Kodit Doganor.

43. “Tregtar” është çdo person fizik ose juridik, që ka si objekt veprimtarie tregtimin apo shkëmbimin e lëndëve plasëse.

44. “Vendosja në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e lëndës plasëse në tregun vendas.

45. “Vërtetim besueshmërie” është akti administrativ i organit përgjegjës të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ku dokumentohet procesi i verifikimit të të dhënave të individit në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të të gjitha institucioneve shtetërore.

46. “Vlerësimi i përputhshmërisë” është procesi nëpërmjet të cilit përcaktohet plotësimi ose jo i kriterëve thelbësorë të sigurisë, që kanë të bëjnë me lëndën plasëse.



KREU II
DETYRIMET E OPERATORËVE
EKONOMIKË

Neni 4

Detyrimet e prodhuesve

1. Prodhuesit, kur hedhin në treg lëndët plasëse ose kur i përdorin për qëllime të tyre, sigurohen që ato të jenë projektuar dhe të prodhuara në përputhje me kriteret thelbësore të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

2. Prodhuesit hartojnë dokumentacionin teknik sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën III dhe sipas procedurës së përshtatshme të vlerësimit të përputhshmërisë, të përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji. Procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë kryhen nga vetë prodhuesit sipas kërkesave të këtij ligji.

3. Në rastin kur procedura përcakton se lënda plasëse është në përputhje me kriteret e përputhshmërisë, prodhuesi harton një deklaratë të përputhshmërisë së BE-së dhe vendos markimin CE.

4. Prodhuesit ruajnë dokumentacionin teknik dhe deklaratën e përputhshmërisë së BE-së për një periudhë 10-vjeçare pasi lënda plasëse është hedhur në treg.

5. Prodhuesit sigurohen që zbatimi i procedurave për prodhimin në seri të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

6. Modifikimet në projektim ose ato të lidhura me karakteristikat e lëndës plasëse, si dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara ose ndryshimet e specifikimeve të tjera teknike për bazën e të cilave është deklaruar përputhshmëria e lëndës plasëse, duhen marrë parasysh dhe duhet të reflektohen në dokumentacionin shoqërues të produktit.

7. Prodhuesit sigurohen që lëndët plasëse, të cilat janë hedhur në treg, kanë një kod identifikimi unik në përputhje me sistemin e identifikimit dhe gjurmueshmërinë e lëndëve plasëse, të përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.

8. Për lëndët plasëse të përjashtuara nga sistemi i gjurmimit, prodhuesit duhet:

a) të sigurohen që lëndët plasëse, të cilat kanë hedhur në treg, kanë një model/lloj, numrin e lotit ose të serisë apo elemente të tjera që mundësojnë identifikimin e tyre ose në rastet kur masa e vogël,

forma ose projektimi i lëndëve plasëse nuk e mundëson një gjë të tillë, atëherë informacioni i kërkuar vendoset te paketimi ose në një dokument që shoqëron lëndën plasëse;

b) të paraqesin te lënda plasëse emrin e tyre, emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare dhe adresën postare ku mund të kontaktohen ose në rast se një gjë e tillë është e pamundur, ky informacion duhet të vendoset te paketimi i tij ose te një dokument shoqërues i lëndës plasëse. Adresa tregon një pikë të vetme ku mund të kontaktohet prodhuesi. Të dhënat e kontaktit të jenë në gjuhën shqipe lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e fundit dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

9. Prodhuesit sigurohen që lënda plasëse që kanë hedhur në treg, të shoqërohet me udhëzimet dhe informacionin e sigurisë në gjuhën shqipe që mund të kuptohet lehtë nga përdoruesi i fundit. Udhëzimet dhe informacionet e tilla të sigurisë, si edhe etiketimi të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të thjeshta.

10. Prodhuesit, që vlerësojnë ose kanë arsye të besojnë se lënda plasëse që kanë hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, marrin menjëherë masat e nevojshme për korrigjimin e mospërputhshmërisë së lëndës plasëse, për ndalimin e tregtimit ose për kthimin e produktit, nëse është e përshtatshme.

11. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, prodhuesit informojnë menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë hollësi, sidomos për mospërmbushjen e kriterëve dhe për masat korrigjuese të ndërmarra.

12. Prodhuesit, në bazë të kërkesës së arsyetuar nga ana e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, japin në gjuhën shqipe të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, në formë shkresore ose elektronike, që nevojitet për të provuar përputhshmërinë e lëndës plasëse me dispozitat e këtij ligji.

13. Prodhuesit duhet të bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga lëndët plasëse, të cilat i kanë hedhur në treg.

14. Prodhuesit në fazën e projektidesë për prodhimin e lëndëve plasëse duhet t'i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), si dhe të sigurojnë lejet përkatëse



mjedisore për prodhimin e lëndëve plasëse përpara vënies në punë të instalimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe atij për lejet e mjedisit. Modifikimet në projektim ose në instalimet e prodhimit, që janë të lidhura me karakteristikat/standardet e harmonizuara të lëndës plasëse apo ndryshimet në specifikimet teknike duhet të jenë pjesë e VNM-në dhe lejes përkatëse të mjedisit.

Neni 5

Përfaqësuesit e autorizuar

1. Prodhuesi mund të caktojë një përfaqësues me anë të një autorizimi me shkrim.

Detyrimet e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 4 të këtij ligji nuk mund t'i delegohen përfaqësuesit të autorizuar.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e caktuara në autorizimin e lëshuar nga prodhuesi.

3. Autorizimi i jep të drejtën përfaqësuesit të autorizuar që minimalisht:

a) të ruajë deklaratën EU të përputhshmërisë dhe dokumentacionin teknik për ta vënë në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse të tregut të vendit në rast kërkesë, për 10 vjet pasi lëndët plasëse të kenë dalë në treg;

b) në përgjigje të një kërkesë të arsyetuar të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, të vendosë në dispozicion të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar përputhshmërinë e një lënde plasëse me dispozitat e këtij ligji;

c) me kërkesë të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, të bashkëpunojë për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut të paraqitur nga lëndët plasëse, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në autorizimin e përfaqësimit.

Neni 6

Detyrimet e importuesve

1. Importuesit vendosin në treg vetëm lëndët plasëse që përmbushin kriteret e përputhshmërisë.

2. Përpara hedhjes në treg të lëndës plasëse, importuesit sigurohen që:

a) prodhuesi të ketë kryer procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij ligji;

b) prodhuesi të ketë hartuar dokumentacionin teknik;

c) lënda plasëse të ketë të vendosur markimin CE;

ç) lënda plasëse të shoqërohet me dokumentet e nevojshme për hedhjen në treg;

d) prodhuesi të ketë plotësuar kriteret e përcaktuara në pikat 7 dhe 8 të nenit 4 të këtij ligji.

3. Kur importuesi vlerëson se një lëndë plasëse nuk është në përputhje me kriteret thelbësore të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji, nuk e vendos në treg lëndën plasëse deri sa lënda plasëse të jetë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë.

4. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturat e mbikëqyrjes së tregut në lidhje me këtë fakt.

5. Importuesit të lënda plasëse në gjuhën shqipe duhet të vendosin:

a) emrin e tyre;

b) emrin e regjistruar tregtar ose markën e regjistruar tregtare;

c) adresën ku mund të kontaktohen ose, nëse kjo është e pamundur, e vendosin atë mbi paketimin apo në një dokument shoqërues të lëndës plasëse.

6. Importuesit sigurohen që lënda plasëse shoqërohet nga udhëzimet dhe informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe.

7. Importuesit sigurohen që, ndërkohë që lënda plasëse është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit ose transportimit përmbushin kriteret thelbësore të sigurisë të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

8. Importuesit, që vlerësojnë se lënda plasëse e hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, menjëherë marrin masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë lëndën plasëse në përputhje me kërkesat, për ta tërhequr ose për ta rikthyer, nëse një gjë e tillë është e përshtatshme. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, importuesit informojnë për këtë çështje menjëherë strukturat e mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë hollësi, sidomos për çështjen e mospërputhjes dhe çdo masë korrigjuese të ndërmarrë.

9. Importuesit ruajnë për 10 vjet pas hedhjes në treg të lëndës plasëse një kopje të deklaratës së përputhshmërisë EU në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe sigurojnë që



dokumentacioni teknik mund t'u vihet në dispozicion këtyre autoriteteve sipas kërkesës.

10.Importuesit:

a) në bazë të kërkesës së arsyetuar nga ana e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut japin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në formë shkresore ose elektronike që nevojitet për të provuar përputhshmërinë e lëndës plasëse me dispozitat e këtij ligji, në gjuhën shqipe;

b) bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga lëndët plasëse, të cilat i kanë hedhur në treg.

Neni 7

Detyrimet e shpërndarësve

1. Shpërndarësit kur hedhin në treg një lëndë plasëse duhet të përmbushin dispozitat e këtij ligji.

2. Përpara hedhjes në treg të lëndës plasëse, shpërndarësit duhet të verifikojnë nëse:

a) lënda plasëse ka markimin CE;

b) lënda plasëse shoqërohet nga dokumentet e nevojshme, si: udhëzimet dhe informacionet e sigurisë në gjuhën shqipe;

c) prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në pikat 7 e 8 të nenit 4 dhe në pikën 5 të nenit 6 të këtij ligji.

3. Kur shpërndarësi vlerëson se lënda plasëse nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji, ai nuk e vendos në treg lëndën plasëse derisa ajo lëndë të jetë në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin, si dhe strukturat e mbikëqyrjes së tregut.

4. Shpërndarësit sigurojnë që për aq kohë sa lënda plasëse është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit apo transportit nuk cenojnë përputhshmërinë dhe përmbushjen e kriterëve të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

5. Kur shpërndarësit vlerësojnë se lënda plasëse e hedhur në treg nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ata sigurohen për marrjen e masave korrigjuese për eliminimin e mospërputhshmërisë për ta tërhequr ose për ta rikthyer atë, sipas rastit. Në rast se lënda plasëse paraqet rrezik, shpërndarësit informojnë menjëherë strukturat e mbikëqyrjes së tregut duke dhënë

hollësi për çështjen dhe për çdo masë korrektuese të ndërmarrë.

6. Shpërndarësit:

a) bazuar në kërkesën e arsyetuar të strukturave të mbikëqyrjes së tregut, paraqesin të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në formë shkresore apo elektronike për të provuar përputhshmërinë e lëndës plasëse;

b) bashkëpunojnë me strukturat e mbikëqyrjes së tregut, në vijim të kërkesës së tyre, për çdo veprim të ndërmarrë për eliminimin e rrezikut që paraqitet nga lëndët plasëse, të cilat i kanë hedhur në treg.

Neni 8

Zbatimi i detyrimeve të prodhuesve nga importuesit dhe shpërndarësit

Një importues ose shpërndarës konsiderohet prodhues për qëllim të këtij ligji dhe u nënshtrohet detyrimeve që ka prodhuesi nëse vendos në treg një lëndë plasëse me emrin e tij, markën e tij tregtare ose nëse modifikon lëndën plasëse të dalë në treg në atë mënyrë që mund të ndikojë te përputhshmëria me dispozitat e këtij ligji.

Neni 9

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Në lidhje me lëndët plasëse që nuk janë pjesë e sistemit të identifikimit dhe gjurmimit, operatorët ekonomikë, në vijim të kërkesës, identifikojnë tek autoritetet e mbikëqyrjes së tregut si më poshtë:

a) çdo operator ekonomik që i ka furnizuar ata me lëndë plasëse;

b) çdo operator ekonomik që ata kanë furnizuar me lëndë plasëse.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni për një periudhë kohore 10-vjeçare pas furnizimit me lëndën plasëse dhe për një periudhë 10-vjeçare pasi ata të kenë furnizuar dikë me lëndë plasëse.



KREU III DISPOZITATE SIGURISË

Neni 10

Transferimi i lëndëve plasëse

1. Lëndët plasëse transferohen vetëm në përputhje me përcaktimet sipas pikave të mëposhtme.

2. Miratimi për transferimin e lëndëve plasëse sigurohet prej aplikuesit nga struktura përkatëse në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, e cila verifikon që marrësi të jetë ligjërish i autorizuar për të marrë lëndë plasëse dhe që zotëron licencat ose autorizimet e nevojshme.

3. Operatori ekonomik përgjegjës për transferimin njofton strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë për transferimin e lëndës plasëse ose strukturën përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes për kalimin transit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë dhe pajiset me autorizimin përkatës.

4. Për transferimin e brendshëm të lëndëve plasëse mund të nxirret autorizim për transferim të herëpashershëm të lëndëve plasëse brenda periudhës së vlefshmërisë deri në 1 vit, të përcaktuar në marrëveshjen midis operatorëve ekonomikë, me kusht që çdo transferim t'u njoftohet strukturave vendore në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë, sipas pikës së nisjes së transportit, brenda jo më pak se 24 orë përpara fillimit të transportit.

5. Në rast se ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë miraton një transferim, ajo i lëshon marrësit një dokument që përfshin të gjithë informacionin e përmendur në pikën 8 të këtij neni.

6. Në rast se struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrojtjes miraton kalimin transit të lëndës plasëse, ajo i lëshon marrësit një dokument që përfshin të gjithë informacionin e përmendur në pikën 8 të këtij neni.

7. Ky dokument shoqëron lëndët plasëse deri në mbërritjen e tyre në destinacionin e përcaktuar. Dokumenti paraqitet sa herë që kërkohet nga autoritetet kompetente.

8. Në rast se transferimet e lëndëve plasëse duhet t'i nënshtrohen një mbikëqyrjeje të veçantë për të përmbushur kërkesat e posaçme të sigurisë në territorin ose në një pjesë të territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë marrësi i jep

strukturës përgjegjëse përpara transferimit informacionin e mëposhtëm:

a) emrat dhe adresat e operatorëve ekonomikë dërgues dhe marrës;

b) numrin dhe sasinë e lëndës plasëse që transferohet;

c) një përshkrim të plotë të lëndëve plasëse që transferohen dhe të mënyrave të identifikimit, duke përfshirë edhe numrin e identifikimit të Kombeve të Bashkuara;

ç) vendin ku do të vendosen në treg lëndët plasëse, informacionin për përmbushjen e kushteve për vendosjen në treg;

d) mjetet që do të kryejnë transportin dhe itinerarin;

dh) datat e parashikuara të nisjes dhe mbërritjes;

e) në rast se është e nevojshme, pikat e sakta të hyrjes dhe të daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Informacioni i përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar në mënyrë që t'u mundësojë strukturave përgjegjëse të kontaktojnë operatorët ekonomikë dhe të sigurojnë konfirmimin se operatorët ekonomikë në fjalë kanë të drejtë të marrin dërgesën.

9. Operatori ekonomik i transferon lëndët plasëse vetëm nëse marrësi/dërguesi ka marrë autorizimet e nevojshme për transferim në përputhje me dispozitat e pikave 2, 3, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij neni.

Neni 11

Shkelje të sigurisë

1. Në rast të një kërcënimi serioz ose të një rreziku ndaj sigurisë publike, si rezultat i mbajtjes ose përdorimit jo të ligjshëm të lëndëve plasëse, ministria që mbulon rendin dhe sigurinë merr të gjitha masat e domosdoshme për të parandaluar transferimin, zotërimin ose përdorimin e paligjshëm të lëndëve plasëse.

2. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë mundet në çdo kohë t'u kërkojë autoriteteve licencuese ndalimin e prodhimit dhe çdo aktivitet tregtar, si dhe mund të kërkojë magazinimin e lëndëve plasëse në ambientet e posaçme të autoriteteve të sigurisë publike ose ushtarake, në rast të një kërcënimi serioz ose të një rreziku ndaj sigurisë publike.



3. Masat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Ato nuk duhet të jenë masa diskriminuese dhe as shtrënguese ndaj aktiviteteve tregtare.

Neni 12

Masat e sigurisë

1. Gjatë kryerjes së veprimtarive të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, operatorët ekonomikë kujdesen që të mbrojnë jetën e shëndetin e njerëzve dhe pronën e tyre, si dhe të marrin të gjitha masat e sigurisë, të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloret e miratuara mbi bazën e këtij ligji.

2. Operatorët ekonomikë rregullojnë mënyrën e zbatimit të masave të përmendura në pikën 1 të këtij neni me rregullore të brendshme.

3. Rregullorja e brendshme, që përmendet në pikën 2 të këtij neni, duhet të përmbajë gjithashtu një plan veprimi në rast aksidenti ose emergjence tjetër (shpërthim, zjarr, vjedhje etj.).

4. Operatorët ekonomikë u njoftojnë masat e përcaktuara në rregulloren e brendshme sipas pikës 2 të këtij neni, të gjithë personave që kryejnë për llogari të tyre veprimtari të lidhura me lëndët plasëse dhe u ofrojnë atyre trajnimin e duhur për të vepruar në rast aksidenti.

5. Objektet për prodhimin ose magazinimin e lëndëve plasëse duhet të jenë në mbrojtje të përhershme fizike ose teknike, në përputhje me rregulloren e veçantë që rregullon fushën e mbrojtjes fizike dhe teknike.

6. Operatorët ekonomikë, që përdorin apo trajtojnë në çfarëdo mënyre lëndë plasëse, duhet të organizojnë dhe të mbikëqyrin zbatimin e masave mbrojtëse të parashikuara.

7. Operatorët ekonomikë, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, që përdorin lëndë plasëse, kujdesen për paketimin e tyre në përputhje me udhëzimet e prodhuesit ose të personit përgjegjës, të personit juridik ose sipërmarrësit apo të personit të autorizuar për të përfaqësuar prodhuesin.

8. Paketimi i lëndëve plasëse nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç paketimit të lëndëve plasëse për të cilat është miratuar.

9. Operatorët ekonomikë të angazhuar në prodhimin, magazinimin, tregtimin, shpërndarjen ose përdorimin e lëndëve plasëse njoftojnë menjëherë ministrin e Mbrojtjes, ministrin

përgjegjës për industrinë minerare dhe ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë në rast humbjeje ose vjedhjeje të lëndëve plasëse.

10. Gjatë transportit të lëndëve plasëse përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, operatorët ekonomikë që kanë autorizimin, kanë detyrimin që në rast aksidenti të kujdesen sipas mënyrës së përcaktuar për lëndët plasëse dhe paketimin përkatës të tyre dhe në rast humbjeje ose vjedhjeje të lëndëve plasëse të njoftojnë ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë menjëherë sapo të marrin dijeni për humbjen apo vjedhjen e tyre.

11. Operatorët ekonomikë të angazhuar në prodhimin, tregtimin ose përdorimin e lëndëve plasëse, përpara se të ndërpresin kryerjen e veprimtarisë së tyre, duhet t'i asgjësojnë lëndët plasëse apo t'ia shesin ose t'ia transferojnë ato personit juridik ose fizik/tregtarit që ka licencë për prodhimin, tregtimin ose përdorimin e lëndëve plasëse, si dhe të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji.

12. Ministri i Mbrojtjes, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe ministri përgjegjës për industrinë minerare miratojnë një udhëzim që përcakton detyrimet dhe procedurat e operatorëve ekonomikë për zbatimin e masave të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 13

Trajnimet/kualifikimet

1. Personat, të cilët për nevojat e operatorit ekonomik angazhohen në prodhimin, importimin, eksportimin, tregtimin, transportimin, transferimin, magazinimin, përdorimin, asgjësimin, duke përdorur ose duke trajtuar drejtpërdrejt lëndët plasëse, duhet të jenë të aftë nga ana shëndetësore, të kualifikuar teknikisht dhe të trajnuar për kryerjen në mënyrë të sigurt të këtyre veprimtarive.

2. Aftësia shëndetësore, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të mbështetet edhe nga një vërtetim i gjendjes shëndetësore, lëshuar nga organi kompetent pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetin publik.

3. Trajnimi i kualifikimit teknik për punën me lëndët plasëse, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, do të ofrohet sipas programit dhe mënyrës së parashikuar nga ministria përgjegjëse për industrinë minerare.



4. Trajnimi i kualifikimit teknik i drejtuesve të mjeteve për transportimin e lëndëve plasëse, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, dhe pajisja me certifikatën përkatëse për transportin e mallrave të rrezikshme do të ofrohen sipas programit dhe mënyrës së parashikuar nga ministri përgjegjës për industrinë minerare dhe ministri përgjegjës për transportin, i cili do të zbatohet nga institucionet e autorizuar.

5. Pavarësisht përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni, individët e angazhuar në veprimtari ndihmëse në lidhje me prodhimin, tregtimin, magazinimin, transportimin ose përdorimin e lëndëve plasëse (transferimi, ngarkimi, shkarkimi etj.) nuk kanë nevojë të kenë kualifikim teknik dhe vërtetim të aftësisë dhe ata mund të përfshihen në veprimtari të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, vetëm nën mbikëqyrjen e personit përgjegjës të kualifikuar teknikisht dhe me kusht që të deklarojnë me shkrim se janë informuar rreth rreziqeve dhe rregullave të sigurisë në vendin e punës.

6. Personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur me vërtetimin e besueshmërisë të lëshuar nga struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon rendin dhe sigurinë.

Neni 14

Identifikimi dhe gjurmimi i lëndëve plasëse

1. Operatorët ekonomikë i përmbahen një sistemi uniform për identifikimin unik dhe gjurmimin e lëndëve plasëse, që merr parasysh madhësinë, formën ose projektin e tyre, duke vendosur një identifikim unik mbi lëndën plasëse, bazuar në karakteristikat dhe faktorët e saj, siç janë efektet e saj të ulëta detonuese, përdorimet e saj dhe rrezikun e ulët ndaj sigurisë që paraqet për shkak të efekteve të vogla potenciale të keqpërdorimit.

2. Ky sistem siguron grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave, duke përfshirë mjete elektronike, identifikimin unik dhe gjurmimin e lëndës plasëse, si edhe vendosjen e një identifikimi unik mbi lëndën plasëse dhe/ose në paketimin e saj që mundëson qasje në ato të dhëna. Këto të dhëna lidhen me identifikimin unik të lëndës plasëse, duke përfshirë vendndodhjen e saj, ndërkohë që është në zotërim të operatorëve ekonomikë dhe identitetin e atyre operatorëve ekonomikë.

3. Të dhënat e përmendura në pikën 2 të këtij neni testohen në intervale të rregullta dhe mbrohen nga dëmtimet ose shkatërrimet aksidentale ose dashakeqëse. Këto të dhëna ruhen për 10 vjet pas kryerjes së transaksionit ose, kur lëndët plasëse janë përdorur ose asgjësuar, 10 vjet pas përdorimit ose asgjësimit të tyre, edhe nëse operatori ekonomik ka ndërprerë tregtimin.

4. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve siguron që prodhuesit dhe importuesit e lëndëve plasëse për përdorim civil të pajisen me një sistem për mbledhjen e të dhënave, i cili përfshin identifikimin unik dhe poseduesin e tyre gjatë të gjitha fazave të procesit, nga prodhimi ose importimi deri në përdorimin e fundit, gjatë gjithë jetëgjatësisë së lëndëve plasëse për përdorim civil, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

5. Struktura përgjegjëse në ministrinë që mbulon çështjet e energjisë dhe mineraret merr të gjitha masat që operatorët ekonomikë, pjesë të zinxhirit të furnizimit për vendosjen në treg të lëndëve plasëse për përdorim civil, të pajisen me një sistem për mbledhjen e të dhënave, i cili përfshin identifikimin unik dhe poseduesin e tyre gjatë të gjitha fazave të procesit, nga prodhimi apo importimi deri në përdorimin e fundit, gjatë gjithë jetëgjatësisë së lëndëve plasëse për përdorim civil, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Rregullat dhe procedurat e krijimit të sistemit të gjurmimit dhe identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

KREU IV

VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË DHE ORGANET E VLERËSIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

Neni 15

Prezumimi i përputhshmërisë së lëndëve plasëse

Lëndët plasëse që janë në përputhje me standardet shqiptare, standardet e harmonizuara ose me një pjesë të këtyre standardeve, referencat e të cilave janë të botuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë”, prezumohen se janë në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë së këtyre standardeve ose të një pjese të tyre, të paraqitura në shtojcën II të këtij ligji.



Neni 16

Procedura e vlerësimit të përputhshmërisë

Për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse, prodhuesi ndjek një nga procedurat e mëposhtme, të parashikuara në shtojcën III të këtij ligji:

a) kontrolli i tipit EU (Moduli B) dhe, sipas zgjedhjes së prodhuesit, një nga procedurat e mëposhtme:

i. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te kontrolli i brendshëm i produktit, si edhe kontrollët shtesë të mbikëqyrjes në intervale rastësore (Moduli C2);

ii. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te siguria e cilësisë së procesit të prodhimit (Moduli D);

iii. përputhshmëria sipas tipit, e bazuar te siguria e cilësisë së produktit (Moduli E);

iv. përputhshmëria sipas tipit, bazuar te verifikimi i njësisë (Moduli F);

b) përputhshmëria e bazuar në verifikimin e njësisë së produktit (Moduli G).

Neni 17

Deklarata e përputhshmërisë

1. Deklarata e përputhshmërisë dëshmon përmbushjen e kërkesave thelbësore të sigurisë, të parashikuara në shtojcën II të këtij ligji.

2. Deklarata e përputhshmërisë së BE-së hartohet sipas modelit të parashikuar në shtojcën IV të këtij ligji, përmban elementet e përcaktuara te modulet përkatëse të parashikuara në shtojcën III dhe përditësohet vazhdimisht sipas rastit. Deklarata e përputhshmërisë së BE-së hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe.

3. Duke hartuar deklaratën e përputhshmërisë, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 18

Rregullimet për markimin CE

Markimi CE është subjekt i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Këto rregullime do të aplikohen për vendosjen e

markimit CE mbi produktet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.

Neni 19

Rregullat dhe kushtet për vendosjen e markimit CE

1. Markimi CE vendoset në mënyrë të dukshme te lëndët plasëse, i lexueshëm dhe i pamundur për t’u fshirë.

2. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk është e garantuar për shkak të natyrës së lëndës plasëse, markimi vendoset në ambalazh dhe në dokumentet shoqëruese.

3. Markimi CE fiksohet përpara se lënda plasëse të hidhet në treg.

4. Markimi CE shoqërohet nga një numër identifikimi i strukturës së akredituar, e cila është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit.

5. Numri i identifikimit të strukturës së akredituar vendoset nga vetë organi ose sipas udhëzimeve të tij nga ana e prodhuesit ose përfaqësuesi i autorizuar i këtij të fundit.

6. Markimi CE dhe numri i strukturës së akredituar, kur është e mundur, shoqërohet edhe nga një shenjë tjetër që tregon rrezik apo përdorim të veçantë.

Neni 20

Organet e vlerësimit të përputhshmërisë

Vlerësimi i përputhshmërisë së lëndëve plasëse bëhet nga vetë prodhuesi nëpërmjet një organizmi evropian të notifikuar, kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të përputhshmërisë së produktit për vendosjen e markimit CE.

Kur një organizëm evropian i notifikuar tregon përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në standardet e harmonizuara, vërteton që lënda plasëse përmbush të gjitha standardet e sigurisë për t’u hedhur në treg.



KREU V
ADMINISTRIMI I LËNDËVE PLASËSE
DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Neni 21

Strukturat përgjegjëse për administrimin

1. Lëndët plasëse për përdorim civil prodhohen, importohen dhe eksportohen në Republikën e Shqipërisë vetëm me licencë të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

2. Pas miratimit të licencës, operatorët ekonomikë mund të importojnë ose të eksportojnë lëndë plasëse duke u pajisur me autorizimin përkatës, të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

3. Lëndët plasëse për përdorim civil transferohen, magazinohen dhe asgjësohen vetëm me autorizim të lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin publik.

4. Lëndët plasëse për përdorim civil përdoren vetëm me autorizim nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe çështjet minerare.

5. Lëndët plasëse për përdorim civil importohen dhe prodhohen në Republikën e Shqipërisë pasi të jenë verifikuar procedurat e përputhshmërisë së tyre nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Mbrotjtjes.

6. Lëndët plasëse për përdorim civil transitohen nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë me autorizimin përkatës të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

7. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për lëndët plasëse për përdorim civil do të jenë institucionet shtetërore të përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, sipas fushës së kompetencës dhe përcaktimeve të pikës 1 të nenit 24 të këtij ligji.

Neni 22

Kushtet e përgjithshme të administrimit

1. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat, kushtet, kriteret, afatet, vlefshmërinë dhe formatet për dhënien, shfuqizimin dhe pezullimin e licencave dhe autorizimeve për prodhimin, importimin, tregtimin, eksportimin, magazinimin, transferimin, transitimin, përdorimin dhe asgjësimin e lëndëve plasëse me propozimin e ministrisë përgjegjëse, sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe, struktura përgjegjëse për dhënien e licencës/autorizimit urdhëron shfuqizimin e saj/tij:

a) kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli ose shkel detyrimet e përcaktuara në të;

b) kur rrethanat janë të tilla që s'do të kishte kuptim ose mundësi për ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

c) në rast të moszbatimit të urdhërimeve brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;

ç) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi;

d) kur titullari dënohet me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është licencuar/autorizuar apo që cenon jetën dhe shëndetin e njeriut;

dh) kur titullari gjatë ushtrimit të veprimtarisë për të cilën është licencuar/autorizuar shkel rregullat teknike, duke rrezikuar jetën e njerëzve, kafshëve dhe/ose mjedisit.

3. Ministrinë e ngarkuara sipas nenit 21 të këtij ligji, në bazë të aplikimit të kërkesës, i japin licencën ose autorizimin përkatës në mbështetje të kriterëve të kualifikimit profesional dhe të gjendjes shëndetësore e gjyqësore të administratorit/drejtuesit teknik të personit fizik/juridik, që ka vendbanimin/selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Licencat dhe autorizimet e dhëna nuk u transferohen personave të tjerë.

5. Licencat, autorizimet dhe lejet e dhëna publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Neni 23

Regjistrimi i lëndëve plasëse

1. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar t'i regjistrojnë lëndët plasëse që prodhojnë dhe i vendosin në treg në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Mbrotjtjes mbahet regjistri shtetëror për lëndët plasëse. Dokumentet për aplikimin për regjistrim dhe mënyra e plotësimit të tyre përcaktohen me



vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

3. Prodhuesi dhe importuesi janë të detyruar të njoftojnë brenda 10 ditësh pune Ministrinë e Mbrojtjes për çdo ndryshim në të dhënat e aplikimit për regjistrim.

4. Të dhënat, publikimi i të cilave dëmton prodhuesin dhe importuesin, gjatë procesit të regjistrimit, me kërkesën e tyre, trajtohen sipas rregullimeve të kuadrit ligjor për “sekretin tregtar”.

KREU VI

MBIKËQYRJA E TREGUT, KONTROLLI I LËNDËVE PLASËSE NË TREG, SI DHE PROCEDURA E MBIKËQYRJES

Neni 24

Autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut

1. Mbikëqyrja e tregut për zbatimin e këtij ligji bëhet nga:

- a) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve gjatë prodhimit të lëndëve plasëse;
- b) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe autoritetet doganore gjatë importit të lëndëve plasëse;

c) struktura përgjegjëse në ministrinë për çështjet minerare gjatë magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse;

ç) organe të tjera mbikëqyrëse dhe inspektuese, secila në përputhje me kompetencat e veta.

2. Këto struktura në mënyrë individuale ose në bashkëpunim kryejnë inspektimet për të verifikuar përputhshmërinë e lëndëve plasëse dhe përmbushjen e kriterëve e të kërkesave të këtij ligji, sipas ligjit për inspektimin.

3. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që lënda plasëse mund të vendoset në treg vetëm nëse do të ruhet në mënyrë të përshtatshme dhe do të përdoret për qëllimin e prodhuar dhe kur nuk rrezikon shëndetin e sigurinë e personave.

Neni 25

Procedura për trajtimin e lëndëve plasëse që paraqesin rrezik kombëtar

1. Kur autoritetet e mbikëqyrjes së tregut kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se lënda plasëse

paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave, mallrave ose mjedisit, autoritetet duhet të bëjnë një vlerësim të lëndës plasëse, duke analizuar të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë ligj.

2. Operatorët përkatës ekonomikë duhet të bashkëpunojnë me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për këtë qëllim nëse është e nevojshme.

3. Në rast se autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, gjatë vlerësimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, konstaton se lënda plasëse nuk përmbush kërkesat e përcaktuara sipas këtij ligji, ai i kërkon menjëherë operatorit përgjegjës të marrë të gjitha masat korrigjuese të domosdoshme për ta sjellë lëndën plasëse në përputhje me këto kërkesa ose të tërheqë lëndën plasëse nga tregu brenda 20 ditësh, në përputhje me natyrën e rrezikut, të përcaktuar nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

4. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut informon autoritetet licencuese në lidhje me masat e marra.

5. Në rast se autoritetet e mbikëqyrjes së tregut konstatojnë se mospërputhja nuk kufizohet vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, ato njoftojnë edhe shtetet e tjera/autoritetet homologe për rezultatet e vlerësimit dhe për veprimet që i kanë kërkuar operatorit ekonomik të ndërmarrë.

6. Operatori ekonomik siguron marrjen e të gjitha masave korrigjuese në lidhje me lëndët plasëse, të cilat i ka vendosur në treg.

7. Në rast se operatori përkatës ekonomik nuk merr masat e duhura korrigjuese brenda periudhës së përmendur në pikën 3 të këtij neni, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr masat e nevojshme provizore për të ndaluar ose kufizuar lëndën plasëse që vendoset në treg, tërheq lëndën plasëse nga tregu ose e rikthen atë.

8. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut informon institucionet përgjegjëse licencuese në kuptim të këtij ligji për masat e marra.

Informacioni i referuar në pikën 8 të këtij neni përfshin:

- a) të dhënat e nevojshme për identifikimin e lëndës plasëse, e cila nuk plotëson kriteret;
- b) origjinën e lëndës plasëse;
- c) natyrën e mosplotësimit të pretenduar dhe rrezikun e përfshirë;
- ç) natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të marra;
- d) argumentet e parashtruara nga operatori ekonomik përkatës.



9. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut shprehet nëse mospërputhja është për shkak të:

a) mospërmbushjes së kërkesave të lëndës plasëse mbi kërkesat lidhur me shëndetin dhe sigurinë e personave apo aspektet e tjera të interesit të mbrojtjes së mallrave apo mjedisit;

b) mospërmbushjes së standardeve të harmonizuara, të cilat i japin prezumimin e përputhshmërisë.

10. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, i cili fillon procedurën sipas këtij neni, informon menjëherë institucionet licencuese, sipas këtij ligji, si dhe operatorin ekonomik për çdo masë të marrë dhe për çdo informacion shtesë në lidhje me lëndën plasëse, e cila nuk përmbush kriteret e përputhshmërisë.

11. Në rast se operatori ekonomik nuk është dakord me masën e marrë, paraqet kundërshtimet me shkrim pranë autoritetit mbikëqyrës, që ka marrë masën, brenda 15 ditësh nga njoftimi i masës.

12. Në rast se brenda tre muajve nga marrja e informacionit të mësipërm nuk ngrihet asnjë kundërshtim nga operatorët ekonomikë në lidhje me masën e përkohshme të marrë nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, kjo masë konsiderohet e ligjshme.

13. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut sigurohen që masa kufizuese e tërheqjes së lëndës plasëse nga tregu të zbatohet pa vonesë.

14. Në rast se në përfundim të procedurës ngrihen kundërshtime lidhur me masat e marra nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut ose në rastin kur masat e marra bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut bashkëpunon me operatorët ekonomikë për vlerësimin e masave të marra.

15. Në rast se vlerësimet e konstatuara qëndrojnë, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr masat për të siguruar tërheqjen e lëndës plasëse nga tregu.

16. Në rast se vlerësimet e konstatuara nuk qëndrojnë, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut tërheq masën e marrë.

Neni 26

Lëndët plasëse të përputhshme, por që paraqesin rrezik

1. Në rastin e kryerjes së vlerësimit sipas parashikimeve në pikën 1 të nenit 25 të këtij ligji,

autoriteti i mbikëqyrjes së tregut konstaton se lënda plasëse është në përputhje me parashikimet e këtij ligji, por paraqet rrezik për shëndetin, sigurinë e njerëzve, mallrave ose mjedisit, atëherë i kërkon operatorit ekonomik përgjegjës:

a) të marrë të gjitha masat për të siguruar që lënda plasëse në fjalë në momentin e hedhjes në treg nuk paraqet rrezik ose;

b) të tërheqë lëndën plasëse nga tregu ose;

c) të rikthejë ose të ndalojë tregtimin e lëndës plasëse në një afat kohor të arsyeshëm, në raport me natyrën e rrezikut të përcaktuar nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

2. Operatorët ekonomikë duhet të garantojnë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të gjitha lëndët plasëse që janë hedhur në treg.

3. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut jep informacionet, të cilat duhet të përfshijnë të gjitha të dhënat e disponueshme, veçanërisht detaje të domosdoshme për identifikimin e lëndës plasëse, origjinën, zinxhirin e furnizimit të lëndës plasëse, natyrën e rrezikut të përfshirë, natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të marra.

4. Operatorët ekonomikë marrin pjesë në konsultimet për konstatimet, me qëllim vlerësimin nga ata të masave të marra nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

Neni 27

Rregullimi i mospërputhshmërisë

1. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut i kërkon operatorit ekonomik të rregullojë mospërputhshmërinë kur konstaton se:

a) markimi CE është vendosur në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;

b) markimi CE nuk është vendosur;

c) numri i identifikimit të autoritetit akreditues në rastet kur ai organ është i përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit, është dhënë në kundërshtim me këtë ligj ose nuk është dhënë fare;

ç) nuk është hartuar deklarata e përputhshmërisë së BE-së;

d) deklarata e përputhshmërisë së BE-së nuk është hartuar në mënyrë të saktë;

dh) dokumentacioni teknik ose nuk është i disponueshëm ose është i paplotë;

e) dokumentacioni i parashikuar në lidhje me gjurmimin ose kriteret e sigurisë mungon, është i rremë apo i paplotë;



ë) nuk janë plotësuar parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 4 ose nenin 6 të këtij ligji.

2. Në rast se mospërputhshmëria e parashikuar në pikën 1 të këtij neni vazhdon, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e nevojshme për të kufizuar apo ndaluar hedhjen në treg të lëndës plasëse ose për t'u siguruar që kjo lëndë të tërhiqet nga tregu.

Neni 28

Ndalimi i tregtimit të produkteve dhe bllokimi

1. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut mund të vendosë të ndalojë përkohësisht hedhjen e produktit në treg në rastet kur:

a) ka dyshime se produkti nuk përmbush kërkesat thelbësore ose kërkesat e tjera të sigurisë së lëndës plasëse;

b) produkti nuk ka markën CE ose është markuar në mënyrë të paligjshme dhe/ose nuk është shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm ndaj këtij produkti;

c) operatorët ekonomikë nuk kanë përmbushur masat e urdhëruara brenda afatit kohor të vendosur nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut dhe produkti mund të paraqesë rrezik për përdoruesin e fundit;

ç) prodhimi, magazinimi, përdorimi apo tregtimi mund të paraqesë rrezikshmëri;

d) autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në vende të tjera të BE-së kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm dhe/ose jo në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara për produktin.

2. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut shfuqizon vendimin për ndalimin e përkohshëm të tregtimit kur operatori ekonomik vërteton se ai plotëson kushtet e parashikuara nga ky ligj.

3. Vendimi i ndalimit të përkohshëm mund të shoqërohet, nëse është e nevojshme, me detyrimin e operatorit ekonomik për lajmërimin e përdoruesit të fundit për rrezikun.

4. Struktura përgjegjëse urdhëron ndalimin e përhershëm të tregtimit në qoftë se kontrollet ose testimet provojnë se lënda plasëse paraqet rrezik dhe nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë ose, pavarësisht përputhshmërisë, lënda plasëse mund të rrezikojë jetën, shëndetin, mjedisin ose interesat e tjerë publikë.

5. Vendimi për ndalimin e tregtimit mund të merret nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut në qoftë se:

a) të njëjtat masa janë marrë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ku është tregtuar produkti;

b) prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi ka njoftuar se produkti është i rrezikshëm ose nuk është në përputhje me legjislacionin përkatës.

6. Vendimi shoqërohet me një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) lajmërimin e tregtarëve/përdoruesve të fundit, duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit publik për rrezikun që paraqet lënda plasëse;

b) urdhërimin për ndalimin e menjëhershëm të tregtimit në qoftë se produkti është tashmë në treg ose kthimin mbrapsht të tij;

c) urdhërimin e bërjes jofunksionale të lëndës plasëse ose asgjësimin e saj.

7. Lajmërimi i klientëve dhe i përdoruesve të fundit dhe kthimi i lëndës plasëse duhet të kryhen nga operatorët ekonomikë nën mbikëqyrjen e autoritetit të mbikëqyrjes së tregut.

8. Në rast se masat e marra nga operatorët ekonomikë konsiderohen si të pamjaftueshme, veprimet e sipërpërmendura kryhen nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut dhe shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

9. Asgjësimi i produktit ose bërja jofunksionale kryhet nga operatori ekonomik ose nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi për ndikimin në mjedis dhe shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

10. Rregullat dhe procedurat e asgjësimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë.

Neni 29

Inspektimi

1. Gjatë inspektimit nëpunësit e strukturave të mbikëqyrjes së tregut, të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji, sipas fushave të kompetencës janë të autorizuar të kryejnë pa njoftuar paraprakisht operatorin ekonomik, subjekt i inspektimit, veprimet e mëposhtme:

a) inspektimin e strukturave, hapësirave dhe shesheve të ndërtimit ku prodhohen, ruhen,



përdoren, asgjësohen ose shiten lëndë plasëse, si dhe të hapësirave të tjera që dyshohen se ruajnë lëndë plasëse;

b) kontrollin e dokumentacionit për lëndët plasëse dhe kualifikimet teknike të personave;

c) verifikimin dhe përcaktimin e identitetit të personave që gjenden në vendet ku përdoren, prodhohen dhe ruhen lëndë plasëse;

ç) kryerjen e aktiviteteve të tjera në përputhje me qëllimin e mbikëqyrjes inspektuese.

2. Nëpunësit e përmendur në pikën 1 të këtij neni kryejnë inspektimin në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

3. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, që ka kryer kontrollin, merr vendim në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

Neni 30

Ankimi

Kundër vendimit lejohet ankimi në gjykatën kompetente brenda një afati prej 20 ditësh, duke nisur nga dita e njohjes me vendimin e arsyetuar.

Neni 31

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga operatorët ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1.1 Gjjobitet me 200 000 (dyqind mijë) – 500 000 (pesëqind mijë) lekë operatori ekonomik, i cili:

a) përfshihet në testimin e lëndëve plasëse ose aktiviteteve të specializuara në procesin e vlerësimit të përputhshmërisë pa licencë/autorizim nga struktura përgjegjëse;

b) prodhon ose tregton lëndë plasëse, të cilat nuk janë testuar dhe markuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1.1 të këtij neni dhe që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës mund të vendoset edhe masa mbrojtëse e pezullimit për një vit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje.

1.2 Gjjobitet me 100 000 (njëqind mijë) - 200 000 (dyqind mijë) lekë operatori ekonomik, i cili:

a) nuk miraton një rregullore të përgjithshme që të përmbajë planin e veprimit për masat e sigurisë ose nuk vepron në përputhje me këtë rregullore;

b) nuk ua njofton masat e parashikuara në rregullore të gjithë personave që kryejnë aktivitetet me lëndë plasëse për llogari të tij, ose nuk u ofron atyre trajnimin për të vepruar në rast aksidenti;

c) nuk garanton mbrojtje të përhershme fizike ose teknike të ambienteve për prodhimin ose magazinimin e lëndëve plasëse;

ç) lejon përdorimin e lëndëve plasëse nga persona pa kualifikim teknik;

d) lejon një person, i cili nuk është i kualifikuar teknikisht, nuk zotëron vërtetim të aftësisë, nuk punon nën mbikëqyrjen e personit përgjegjës teknikisht të kualifikuar dhe nuk ka deklaruar me shkrim se i njeh rreziqet dhe rregullat e sigurisë në vendin e punës, të përfshihet në aktivitete ndihmëse për prodhimin, tregtimin, transportimin, magazinimin ose përdorimin e lëndëve plasëse;

dh) gjatë ekzaminimit të lëndëve plasëse, laboratorit i akredituar zbulon se ato nuk përmbushin kërkesat teknike, por nuk ia raporton këtë fakt autoritetit përkatës që lëshon licencën e prodhimit;

e) magazinon lëndë plasëse në struktura dhe ambiente që nuk janë krijuar për magazinimin e lëndëve plasëse ose i magazinon ato në sasi që tejkalojnë kapacitetin maksimal të magazinës;

ë) magazinon në magazinën e përkohshme lëndë plasëse që tejkalojnë kapacitetin maksimal ose lëndët plasëse të ruajtura në magazinën e përkohshme i përdor për aktivitete që nuk lidhen me objektin për të cilin është ndërtuar magazina;

f) zotëron licencë për prodhimin/importimin/eksportimin e lëndëve plasëse dhe u shet lëndë plasëse personave juridikë dhe sipërmarrësve të cilët nuk kanë licencë/autorizim përkatës për përdorim/shpërndarje/magazinim;

g) transferon lëndë plasëse pa autorizim;

gj) është përgjegjës për mbajtjen e të dhënave për gjurmimin e lëndëve plasëse dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore;

h) angazhohet në transportin e lëndëve plasëse duke mos respektuar rregulloret për transportin e lëndëve plasëse;



i) nuk merr të gjitha masat e sigurisë gjatë operacioneve të minimimit dhe nuk i kryen ato operacione në përputhje me planin e minimimit;

j) pengon inspektorin që të kryejë mbikëqyrjen inspektuese ose nuk i siguron atij akses në dokumentacionin e kërkuar dhe/ose nuk i jep informacionin dhe të dhënat e nevojshme.

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1.2 të këtij neni, që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës mund të vendoset edhe masa plotësuese e pezullimit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje për 6 muaj.

1.3 Gjohitet me 10 000 (dhjetë mijë) – 100 000 (njëqind mijë) lekë operatori ekonomik, i cili:

a) pas përdorimit të lëndës plasëse nuk kujdeset për ambalazhin e lëndëve plasëse në përputhje me udhëzimet e prodhuesit;

b) ambalazhin e synuar për paketimin e lëndëve plasëse e përdor për qëllime të tjera;

c) nuk e njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë për humbjen ose vjedhjen e lëndëve plasëse;

ç) nuk njofton strukturat përgjegjëse që kanë lëshuar licencat/autorizimet për ndërprerjen e aktiviteteve të lejuara nga ky ligj apo ndryshime të tjera në status dhe kushtet dhe kriteret me të cilat është përfutur licenca/autorizimi, brenda tetë ditëve nga data e ndodhjes së tyre;

d) nuk u dorëzon strukturave përkatëse të dhënat e shtetasit që synon të angazhojë në kryerjen e aktiviteteve në lidhje me lëndët plasëse;

dh) transferon dhe përdor lëndë plasëse në ambalazh që nuk është testuar dhe markuar në përputhje me rregulloret që rregullojnë transportin e mallrave të rrezikshme dhe rregulloret për markimin e lëndëve plasëse;

e) nuk mban të dhëna për dokumentacionin teknik, deklaratat e përputhshmërisë, sistemin e gjurmimit sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj;

ë) nuk raporton pranë strukturave përgjegjëse, të cilat kanë miratuar licencat/autorizimet sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj ose akteve nënligjore në zbatim të tij;

f) nuk ia kthen lëndët plasëse prodhuesit ose nuk i shkatërron ato me shpenzimet e tij brenda 30 ditëve nga data e njoftimit për pezullimin e tregtimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse;

g) zotëron lëndë plasëse për të cilat ka dijeni se nuk janë në përputhje me kërkesat teknike dhe me strukturën përkatëse;

gj) strukturat për prodhimin dhe magazinimin e lëndëve plasëse nuk janë ndërtuar dhe nuk kanë pajisjet e duhura për të siguruar mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronës së tyre dhe mjedisit;

h) magazinon lëndë plasëse në magazina të përkohshme për ndërtimin dhe shfrytëzimin e të cilave nuk është marrë autorizimi përkatës;

i) nuk i dorëzon strukturës përgjegjëse të dhënat e mbajtura në përputhje me këtë ligj, brenda tetë ditësh nga data e marrjes së vendimit që shfuqizon licencën për prodhimin e lëndëve plasëse;

j) magazinon lëndët plasëse të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji në sasi që tejkalojnë kapacitetin e disponueshëm të magazinës;

k) nuk njofton strukturën përgjegjëse në rast ndryshimesh në lidhje me transportin e njoftuar të lëndëve plasëse menjëherë pas marrjes dijeni për këtë fakt;

l) nuk njofton strukturën përgjegjëse për çdo transferim të lëndëve plasëse, sipas vendit të pikës së nisjes së transportit ose sipas vendit të pikës së kalimit të hyrjes dhe/ose daljes, jo më vonë se 24 orë përpara nisjes së transportit;

ll) përdor lëndë plasëse dhe nuk i kthen lëndët plasëse të papërdorura në magazinë me paketimin e tyre fillestar ose nuk i asgjëson ato në përputhje me specifikimet e prodhuesit, në mënyrë që ato të mos vënë në rrezik jetën, shëndetin e njerëzve dhe sigurinë e pronave dhe të mjedisit.

Për kundërvajtjet e përmendura në pikën 1.3 të këtij neni, që përsëriten gjatë një periudhe dyvjeçare, krahas gjobës mund të vendoset edhe masa plotësuese e pezullimit të aktivitetit që ka çuar në kundërvajtje për 6 muaj.

2. Shkeljet me karakter administrativ konstatohen nga struktura përgjegjëse, e përcaktuar në pikën 1 të nenit 24 të këtij ligji, sipas fushës së kompetencës.

3. Ankimi ndaj vendimit për dhënien e gjobës bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative brenda 30 ditëve pranë ministrit përgjegjës. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit për dhënien e gjobës.

4. Të ardhurat që burojnë nga vjelja e gjobave kalojnë në buxhetin e shtetit.



KREU VII

Neni 32

Dispozita kalimtare

1. Për procedurat e licencimit, kontrollit, raportimeve të nisura para hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Licencat, lejet, autorizimet, të cilat janë lëshuar në bazë të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të mbeten në fuqi deri në 1 vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Brenda këtij afati operatorët duhet të marrin masat për licencim sipas këtij ligji dhe duhet të përmbushin dispozitat që parashikon ky ligj për sigurinë e lëndëve plasëse.

Neni 33

Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton aktet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 14, në pikën 1 të nenit 22 dhe në pikën 10 të nenit 28 të këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për energjinë dhe industrinë minerare miraton brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 13 të këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për transportet miraton brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktin e përcaktuar në pikën 4 të nenit 13 të këtij ligji.

4. Ministri i Mbrojtjes, ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë dhe ministri përgjegjës për industrinë minerare miratojnë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktet e përcaktuara në pikën 12 të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 34

Shfuqizime

1. Ligji nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me të, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 3.6.2021.

SHTOJCA I

ARTIKUJT QË KONSIDEROHEN SI PIROTEKNIKË OSE MUNICIONE NË BAZË TË REKOMANDIMEVE PÛRKATËSE TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Nr. i OKB-së	Emri dhe përshkrimi	Klasa/kategoria	Fjalor (për t'u përdorur si udhëzues vetëm për informacion)
Grupi G			
0009	Municione zjarrvënëse me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione. Term i përgjithshëm që lidhet kryesisht me artikujt e përdorimit ushtarak, të përbërë nga të gjitha llojet e bombave, granatave, raketave, minave, predhave dhe pajisjeve të tjera të ngjashme. Municione zjarrvënëse. Municione që përmbajnë substanca zjarrvënëse. Me përjashtim të rasteve kur përbërja është në vetvete një lëndë plasëse, kur gjithashtu përmban një ose më tepër nga sa vijon: një ngarkesë shtytëse me kapsollë dhe lëndën ndezëse; një kapsollë me shpërthyes ose mbushje nxjerrëse.
0010	Municione zjarrvënëse me ose pa shpërthyes,	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0009.



	mbushje nxjerrëse ose shtytëse.		
0015	Municione tymuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione tymuese. Municionet që përmbajnë substanca që prodhojnë tym. Me përjashtim të rasteve kur substanca është në vetvete një lëndë plasëse, kur municioni gjithashtu përmban një ose më tepër nga sa vijon: një ngarkesë shtytëse me kapsollë dhe lëndën ndezëse; një kapsollë me shpërthim ose mbushje nxjerrëse.
0016	Municione tymuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0015.
0018	Municione lotsjellëse me shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione lotsjellëse me shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse. Municione që përmbajnë substanca lotsjellëse. Gjithashtu përmban një ose më tepër nga sa vijon: një substancë piroteknike, një ngarkesë shtytëse me kapsollë dhe lëndën ndezëse; një kapsollë me shpërthim ose mbushje nxjerrëse.
0019	Municione lotsjellëse me shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0018.
0039	Bomba verbuese.	1.2 G	Bomba. Artikuj plasës që hidhen nga mjete fluturuese. Ato mund të përmbajnë një lëng të ndezshëm me ngarkesë shpërthyes, një përbërje verbuese ose një ngarkesë shpërthyes. Termi përfshin: bomba verbuese.
0049	Fishekë ndriçues.	1.1 G	Fishekë ndriçues. Artikuj që përbëhen nga një veshje e jashtme, një kapsollë dhe baruti ndriçues, të gjitha të bashkuara në një pjesë të vetme dhe të gatshme për qitje.
0050	Fishekë ndriçues.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0049.
0054	Fishekë sinjalizues.	1.3 G	Fishekë sinjalizues. Artikuj të projektuar për të qëlluar sinjalizues të shndritshëm me ngjyra ose sinjale të tjera nga pistoletat sinjalizuese etj.
0066	Fitil ndezës.	1.4 G	Fitil ndezës. Artikuj të përbërë nga fije tekstili të mbuluara me barut të zi ose me një tjetër përbërje piroteknike me djegie të shpejtë dhe nga një mbulesë mbrojtëse e butë ose të përbërë nga një bërthamë baruti të zi e mbështjellë nga një pëlhurë e butë: Ai digjet pandalshëm përgjatë gjatësisë së tij me një flakë të jashtme dhe përdoret për të transmetuar ndezjen nga një pajisje të një ngarkesë.
0092	Sinjalizues sipërfaqësor.	1.3 G	Artikuj sinjalizues që përmbajnë substanca piroteknike, të cilat janë të projektuara për t'u përdorur për të ndriçuar, identifikuar, sinjalizuar ose paralajmëruar.
0093	Sinjalizues ajror.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0101	Kapsolla jodetonuese.	1.3 G	Fuse/Fuze (kapsolla/siguresa). Edhe pse këto dy fjalë kanë një origjinë të përbashkët (frëngjisht fusée, fusil) dhe ndonjëherë konsiderohen thjesht si germëzime të ndryshme, duhet të ruhet konvencioni që "fusë", i referohet një pajisjeje ndezëse të ngjashme me fitilin, ndërsa "fuze" i referohet një pajisjeje që përdoret në municione që përfshijnë përbërës mekanikë, elektrikë, kimikë ose



			hidrostatikë për të ndezur me shpërthim ose djegie. Kapsolla të çastit jodetonuese (me ndezje të shpejtë). Artikull i përbërë nga fije pambuku të ngopura me barut të imët të zi (me ndezje të shpejtë). Digjet me flakë të jashtme dhe përdoret në zinxhirët e ndezjes për fishekzjarrë etj.
0103	Kapsolla ndezëse të veshura me metal.	1.4 G	Kapsolla ndezëse të veshura me metal. Artikull i përbërë nga një tub prej metali me një bërthamë me lëndë plasëse shpërthyes.
0171	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.2 G	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse. Municione të ndërtuara për të prodhuar një burim drite intensive për ndriçimin e një zone. Termi përfshin fishekët ndriçues, granatat dhe predhat; dhe bombat ndriçuese dhe me identifikim objektiv.
0191	Pajisje sinjalistike të dorës.	1.4 G	Artikuj të ndërtuar për prodhimin e sinjaleve.
0192	Sinjale shpërthyes për trasenë hekurudhore.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0194	Sinjale rreziku për anije.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0195	Sinjale rreziku për anije.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0196	Sinjale tymi.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0197	Sinjale tymi.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0212	Gjurmues për municione.	1.3 G	Gjurmues për municione. Artikuj të izoluar që përmbajnë substanca piroteknike, të projektuara për të zbuluar trajektoren e një predhe.
0254	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0171.
0297	Municione ndriçuese me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0254.
0299	Bomba verbuese.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0039.
0300	Municione zjarrvënëse me ose pa shpërthyes, mbushje nxjerrëse ose shtytëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0009.
0301	Municione lotsjellëse me shpërthyes,	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0018.



	mbushje nxjerrëse.		
0303	Municione tymuese me ose pa shpërthyes me mbushje nxjerrëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0015.
0306	Gjurmues për municione.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0212.
0312	Fishekë sinjalizues.	1.4 G	Fishekë sinjalizues. Artikuj të projektuar për të qëlluar sinjalizues të shndritshëm me ngjyra ose sinjale të tjera nga pistoletat sinjalizuese.
0313	Sinjale tymi.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0195.
0318	Granata dore ose pushkë për praktikë.	1.3 G	Granata dore ose pushkë. Artikuj të projektuar për t'u hedhur me dorë ose me pushkë. Termi përfshin: granata dore ose pushkë për praktikë.
0319	Ndezësit tubularë.	1.3 G	Ndezësit tubularë. Artikuj që përbëhen nga një ndezës dhe një mbushje ndihmëse lënde shpërthyes djegëse si pluhur i zi, që përdoret për të ndezur mbushjen hedhëse në një fole fisheku, p.sh.: top.
0320	Ndezësit tubularë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0319.
0333	Fishekszjarrë.	1.1 G	Fishekszjarrë. Artikuj piroteknikë të projektuar për argëtim.
0334	Fishekszjarrë.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0333.
0335	Fishekszjarrë.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0333.
0336	Fishekszjarrë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0333.
0362	Municione për praktikë.	1.4 G	Municione për praktikë Municione pa mbushje kryesore shpërthyes, që përmban një mbushje shpërthyes ose nxjerrëse. Normalisht përmban një siguresë dhe një mbushje shtytëse.
0363	Municione prove.	1.4 G	Municione prove. Municione që përmbajnë substanca piroteknike të përdorura për të testuar performancën ose fuqinë e municioneve të reja, përbërësve të armëve apo kompleteve.
0372	Granata dore ose pushkë për praktikë.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0318.
0373	Pajisje sinjalistike të dorës.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0191.
0403	Sinjalizues ajrorë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0418	Sinjalizues sipërfaqësorë.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0419	Sinjalizues sipërfaqësorë.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0420	Sinjalizues ajror.	1.1 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0421	Sinjalizues ajror.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0424	Predha inerte me gjurmues.	1.3 G	Predha. Artikuj, si gëzhjoja ose plumba të cilët hidhen nga një top apo armë artilerie, pushkë apo armë të tjera të vogla. Ato mund të jenë inerte, me ose pa gjurmues, ose mund të përmbajnë një mbushje nxjerrëse ose shpërthyes. Termi përfshin: Predhat inerte me gjurmues; predhat me mbushje shpërthyes ose nxjerrëse; predha me mbushje shpërthyes.
0425	Predha inerte	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0424.



	me gjurmues.		
0428	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.1 G	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike. Artikuj që përmbajnë substanca piroteknike dhe që përdoren për qëllime teknike si gjenerues nxehësie, gjenerues gazi, efekte teatrore etj. Termi përjashton artikujt vijues të cilët listohen veçmas: të gjithë municionet, fishekët sinjalizues, prerës shpërthyes kabllorsh, fishekzjarrët, sinjalizuesit ajror, sinjalizuesit sipërfaqësorë, pajisje shkëputëse shpërthyes, përçin shpërthyes, pajisje sinjalizuese dore, sinjalizues rreziku, sinjalizues hekurudhorë shpërthyes, sinjale tymuese.
0429	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.2 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0428.
0430	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0428.
0431	Artikuj piroteknikë për qëllime teknike.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0428.
0434	Predha me mbushje shpërthyes ose nxjerrëse.	1.2 G	Predha. Artikuj, si gëzhjoja ose plumba të cilët hidhen nga një top apo armë artilerie, pushkë apo armë të tjera të vogël. Ato mund të jenë inerte, me ose pa gjurmues, ose mund të përmbajnë një mbushje nxjerrëse ose shpërthyes. Ky term përfshin: predhat inerte me gjurmues; predhat me mbushje shpërthyes ose nxjerrëse; predha me mbushje shpërthyes.
0435	Predha me mbushje shpërthyes ose nxjerrëse.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0434.
0452	Granata dore ose pushkë për praktikë.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0372.
0487	Sinjale tymuese	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0488	Municione për praktikë.	1.3 G	Municione për praktikë Municione pa mbushje kryesore shpërthyes, që përmban një mbushje shpërthyes ose nxjerrëse. Normalisht përmban një siguresë dhe një mbushje shtytëse. Termi nuk përfshin artikujt e mëposhtëm të cilët listohen më vete: Granata për praktikë.
0492	Sinjale shpërthyes për trasenë hekurudhore.	1.3 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0493	Sinjale shpërthyes për trasenë hekurudhore.	1.4 G	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0503	Fryrës për jastëkë ajri ose module për jastëkë ajri ose paratendosës të rripave të sigurimit.	1.4 G	
Grupi S			
0110	Granata dore ose pushke për praktikë.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0318.



0193	Sinjale shpërthyes për trasenë hekurudhore.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0194.
0337	Fishekzjarrë.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0334.
0345	Predha inerte me gjurmues.	1.4 S	Predha. Artikuj, si gëzhoja ose plumba, të cilët hidhen nga një top apo armë artilerie, pushkë apo armë të tjera të vogël. Ato mund të jenë inerte, me ose pa gjurmues, ose mund të përmbajnë një mbushje nxjerrëse ose shpërthyes.
0376	Ndezësit tubularë.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0319.
0404	Sinjalizues ajror.	1.4 S	Shih të dhënat për nr. e OKB-së 0092.
0405	Fishekë sinjalizues.	1.4 S	Fishekë sinjalizues. Artikuj të projektuar për të qëlluar sinjalizues të shndritshëm me ngjyra ose sinjale të tjera nga pistoletat sinjalizuese etj.
0432	Artikuj piroteknikë ose për qëllime teknike.	1.4 S	

SHTOJCA II KRITERET KRYESORE TË SIGURISË

I. Kriteret e përgjithshme

1. Çdo lëndë plasëse duhet të projektohet, prodhohet dhe furnizohet në atë mënyrë që të paraqesë rrezik minimal ndaj sigurisë së jetës së njeriut dhe shëndetit dhe të parandalojë dëmet ndaj pronës dhe mjedisit në kushtet normale dhe të parashikueshme, sidomos në lidhje me rregullat dhe praktikatat standarde të sigurisë deri në përdorimin e saj.

2. Çdo lëndë plasëse duhet të plotësojë karakteristikat e performancës që prodhuesi i ka specifikuar organit të notifikuar, me qëllimin për të garantuar siguri dhe besueshmëri maksimale.

3. Çdo lëndë plasëse duhet të projektohet dhe prodhohet në mënyrë të tillë që të mund të asgjësohet në mënyrë të sigurt nëpërmjet një procesi të qëndrueshëm me ndikim minimal në mjedis.

II. Kriteret e veçanta

1. Minimalisht, në rast se është mundur, duhet të merren në konsideratë apo testohen informacionet dhe veçoritë e mëposhtme:

a) dizajni, ndërtimi dhe veçoritë karakteristike, duke përfshirë përbërjen e hollësishme kimike, shkallën e homogjenitetit dhe në rast se është e mundur, edhe përmasat dhe shpërndarja e pjesëve të vogla;

b) qëndrueshmëria fizike dhe kimike e lëndës plasëse në të gjitha kushtet normale dhe të parashikueshme mjedisore ndaj të cilave mund të ekspozohet;

c) ndjeshmëria ndaj impaktit dhe fërkitimit;

ç) pajtueshmëria e të gjithë komponentëve për sa i përket qëndrueshmërisë fizike dhe kimike të tyre;

d) pastërtia kimike e lëndëve plasëse;

dh) rezistenca e lëndëve plasëse ndaj ndikimit të ujit në rastet kur ajo synohet të përdoret në kushte me lagështi apo të njoma dhe në rast kur siguria apo besueshmëria e saj mund të ndikohet negativisht nga uji;

e) rezistenca ndaj temperaturave të ulëta dhe të larta në rastet kur lënda plasëse është parashikuar për t'u mbajtur ose përdorur në temperatura të tilla dhe kur siguria ose besueshmëria e tij mund të ndikohet negativisht nga ftohja ose nxehja e një përbërësi ose e lëndës plasëse në tërësi;

ë) përshtatshmëria e lëndëve plasëse që përdoren në mjedise të rrezikshme (p.sh.: atmosferë të nxehtë, masa të nxehta), nëse synohet të përdoret në kushte të tilla;

f) veçoritë e sigurisë të synuar për parandalimin e fillimit apo ndezjes së parakohshme dhe të paqëllimtë;

g) mbushjen dhe funksionimin e lëndëve shpërthyes në lidhje me trajtimin, ruajtjen, përdorimin dhe eliminimin e sigurt;



gj) udhëzimet e përshtatshme dhe, në rast nevojë, markimet në lidhje me trajtimin, ruajtjen, përdorimin dhe eliminimin e sigurt;

h) mundësinë e lëndës plasëse, paketimin apo komponentët e tjerë për të përballuar përkeqësimin gjatë ruajtjes deri në “përdorimin” në datën e specifikuar nga prodhuesi;

i) specifikimet për të gjitha pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm për funksionim të besueshëm dhe të sigurt të lëndëve plasëse.

2. Çdo lëndë plasëse të testohet në kushte reale. Nëse kjo nuk është e mundur në një laborator, testet të kryhen në kushte ku do të përdoret lëndë plasëse.

3. Kriteret për grupet e lëndëve plasëse.

3.1 Lëndët plasëse detonuese duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) metoda e propozuar e fillimit duhet të sigurojë detonim të sigurt, të besueshëm dhe të plotë apo deflagracionin e duhur të lëndës shpërthyes që detonon. Sidomos në rastet e pluhurit të zi, përcaktues është kapaciteti në lidhje me deflagrimin;

b) lëndët plasëse detonuese në formë predhe duhet të kalojnë detonimin në mënyrë të sigurt dhe të besueshëm nga një anë e vargut të predhave të tjetra;

c) tymrat e prodhuar nga shpërthimi i lëndëve shpërthyes për përdorim nëntokësor mund të përmbajnë karbon monoksid, gaze nitrike, gazra të tjera, avuj apo mbetje të ngurta që fluturojnë vetëm në sasi që nuk dëmtojnë shëndetin në kushte normale të funksionimit.

3.2 Telat e detonimit, siguresat, siguresat e tjera dhe tubat e goditjes duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) mbulesa e telave detonuese, siguresat, siguresat e tjera dhe tubat e goditjes duhet të kenë fuqinë e duhur mekanike dhe të mbrojnë siç duhet mbushjen me lëndë shpërthyes kur ekspozohet në presion normal mekanik;

b) të paraqiten parametrat për kohën e djegies të siguresave dhe të plotësohen në mënyrë të besueshme;

c) telat detonues duhet të jenë në gjendje që të ndezin në mënyrë të besueshme, të kenë aftësi të mjaftueshme ndezëse dhe të përmbushin kriteret në lidhje me ruajtjen edhe në kushte të veçanta klimaterike.

3.3 Detonatorët (duke përfshirë detonatorët e vonesës) dhe reletë të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) detonatorët duhet të fillojnë në mënyrë të besueshme detonimin e lëndëve plasëse që synohen të përdoren me to në kushtet e parapara për përdorim;

b) konektorët e vonesës për telat e detonimi duhet të ndizen në mënyrë të besueshme;

c) kapaciteti i ndezjes nuk duhet të ndikohet negativisht nga lagështira;

ç) kohëzgjatja e vonesës së detonatorëve vonues duhet të jetë mjaftueshëm uniforme për të siguruar që mundësia për mbivendosje e kohës së vonesës të hapave kohorë është e parëndësishme;

d) karakteristikat elektrike të detonatorëve elektrikë duhet të paraqitet te paketi (p.sh. jorrymë, rezistente);

dh) telat e detonatorëve elektrikë duhet të kenë izolim të mjaftueshëm dhe forcë mekanike duke përfshirë soliditetin e lidhjes të detonatori, duke marrë parasysh përdorimin e synuar.

3.4 Shtytësit dhe shtytësit e raketave të përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) nuk duhet të shpërthejnë kur përdoren për qëllimin e tyre;

b) shtytësit, në rast nevojë (p.sh. ato me bazë nitroceluloze) duhet të stabilizohen kundër dekompozimit;

c) shtytësit e ngurtë të raketave, në formë të ngjeshur apo me derdhje, nuk duhet të përmbajnë asnjë çarje të paqëllimshme ose fluska gazi të cilat ndikojnë në mënyrë të rrezikshme në funksionimin e tyre.

SHTOJCA III PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË

MODULI B Kontrolli i tipit-EU

1. Kontrolli tip EU është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku një organ i miratuar kontrollon projektimin teknik të një lëndë plasëse dhe verifikon dhe vërteton nëse projektimi teknik i asaj lëndë plasëse plotëson kriteret e këtij ligji për rastet kur ajo përdoret.

2. Kontrolli tip EU kryhet si një vlerësim për përshtatshmërinë e projektimit teknik të lëndës



plasëse përmes kontrollit të dokumentacionit teknik dhe evidencës mbështetëse të parashikuar në pikën 3, si edhe kontrollin e mostrës, përfaqësuesit të produktit të parashikuar, kontrollin e të gjithë produktit (kombinimin e llojit të produktit me llojin e projektimit).

3. Aplikimi për kontrollin tip EU duhet të paraqitet nga prodhuesi te një organ i miratuar, i zgjedhur prej tij.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit, nëse aplikimi është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, emri i tij dhe adresa;

b) një deklaratë me shkrim ku thuhet se i njëjti aplikim nuk është paraqitur te ndonjë organ tjetër i miratuar;

c) dokumentacioni teknik.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojnë vlerësimin e përputhshmërisë së lëndës me kërkesat e aplikueshme të këtij ligji dhe duhet të përfshijë analizën dhe vlerësimin e duhur të riskut.

Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e aplikueshme dhe përfshin, për sa kohë që është relevante për vlerësimin, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e lëndës plasëse.

Dokumentacioni teknik përmban, kur është e mundur, të paktën elementet e mëposhtme:

i. një përshkrim të përgjithshëm të lëndës plasëse;

ii. projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrame të komponentëve, nënkomplete, qarqe etj.;

iii. përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar skicimet dhe diagramet, si dhe funksionimin e lëndës plasëse;

iv. listën e standardeve të harmonizuara që zbatohen plotësisht ose pjesërisht, dhe në rast të mosaplikimit të standardeve, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë të këtij ligji, duke përfshirë specifikimet relevante teknike që janë aplikuar. Në raste të zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë aplikuar;

v. rezultatet e llogaritjeve të bëra në lidhje me projektin, kontrollet e kryera etj.;

vi. raportet e testit;

ç) mostrat përfaqësuese të produktit të paraparë. Organ i miratuar mund të kërkojë mostra të tjera, nëse nevojiten për të kryer programin e testimit;

d) evidenca mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektimit teknik. Kjo evidencë mbështetëse përmend çdo dokument që është përdorur, sidomos në rastin kur standardet relevante të harmonizuara nuk janë aplikuar në mënyrë të plotë. Evidenca mbështetëse përfshin, në rastet e nevojshme, rezultatet e testeve, të kryera në përputhje me specifikimet e tjera relevante nga ana e laboratorit të prodhuesit apo nga ana e një laboratorit tjetër testues në emër ose nën përgjegjësinë e tij.

4. Organi i miratuar për lëndën plasëse:

4.1 Kontrollon dokumentacionin dhe evidencën mbështetëse për të verifikuar përputhshmërinë e projektimit teknik të lëndës plasëse.

4.2 Për mostrën/mostrat verifikon nëse tipi/at janë prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të identifikojë elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat e aplikueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara, si dhe elementet që janë projektuar në përputhje me dispozitat specifikimet e tjera përkatëse teknike.

4.3 Kryen ose urdhëron kryerjen e kontrolleve dhe testeve për të kontrolluar nëse janë zbatuar siç duhet standardet e harmonizuara përkatëse, në rastet kur prodhuesi ka zgjedhur t'i zbatojë ato.

4.4 Kryen kontrolle dhe testime të përshtatshme ose i kryen ato për të kontrolluar nëse zgjidhjet e bëra nga prodhuesi, në rastet kur nuk janë aplikuar standardet relevante të harmonizuara, duke përfshirë edhe ato raste e specifikimeve të tjera relevante teknike të aplikuara, i plotësojnë ose jo kërkesat e sigurisë të këtij ligji.

4.5 Bie dakord me prodhuesin për vendin ku do të kryhen kontrollet dhe testet.

5. Organi i miratuar përpilon një raport vlerësues i cili regjistron veprimtarinë e bërë në përputhje me pikën 4 dhe rezultatet e tyre. Pa paragjykuar detyrimet e tij ndaj autoritetit njoftues, organi i miratuar lëshon përmbajtjen e atij raporti, të plotë ose të pjesshëm, vetëm me anë të marrëveshjes me prodhuesin.

6. Në rastet kur tipi plotëson dispozitat përkatëse të këtij ligji, që zbatohet për lëndët plasëse në fjalë, organi i miratuar duhet t'i japë aplikantit një certifikatë kontrolli tip EU.

7. Certifikata duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, rezultatet e kontrollit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë dhe të dhënat e



domosdoshme për identifikimin e tipit të miratuar. Certifikata e kontrollit të tipit EU mund të ketë një apo më shumë shtojca të bashkëngjitura.

Certifikata e kontrollit të tipit EU dhe shtojcat e saj përmbajnë të gjithë informacionin relevant për të mundësuar kontrollin e përputhshmërisë së lëndëve të prodhuara plasëse dhe atyre të ekzaminuara dhe të mundësojë kontrollin gjatë shërbimit.

Në rastet kur tipi nuk përmbush mjaftueshëm kërkesat e aplikueshme të këtij ligji, organ i miratuar refuzon lëshimin e certifikatës kontrolluese të tipit EU dhe informon aplikuesin për këtë gjë, duke dhënë hollësi dhe arsye për këtë refuzim.

8. Organi i miratuar duhet të jetë i informuar për çdo ndryshim të asaj që konsiderohet gjerësisht si moderne dhe që mund të tregojë se tipi i miratuar nuk mund të jetë më në përputhje me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji dhe organ i miratuar përcakton nëse ndryshimet e tilla kërkojnë hetime të mëtejshme. Nëse është kështu, organi i miratuar duhet të informojë prodhuesin në mënyrën e duhur.

Prodhuesi informon organin e miratuar që mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën kontrolluese tip EU, për të gjitha modifikimet e artikullit të miratuar, që mund të cenojnë përputhshmërinë e lëndës plasëse me kërkesat kryesore të sigurisë të këtij ligji ose me kushtet për vlefshmërinë e kësaj certifikate. Modifikimet e tilla kërkojnë miratim të mëtejshëm në formën e një certifikate kontrolluese shtesë të tipit EU, përveç origjinale.

9. Çdo organ i miratuar duhet të informojë autoritetin e tij akreditues në lidhje me certifikatat e kontrollit tip EU dhe/ose çdo shtojcë që ka lëshuar apo dhe që në mënyrë periodike sipas kërkesës, në mënyrë që të vërë në dispozicion të autoriteteve të saj akredituese listën e certifikatave të tilla dhe/ose çdo shtojcë të refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i miratuar duhet të informojë organet e tjera të miratuara në lidhje me certifikatat e kontrollit tip EU dhe/ose çdo shtojcë që ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar dhe, sipas kërkesës, në lidhje me certifikatat dhe/ose plotësimet e tyre të cilat i ka lëshuar.

Organi i miratuar mban një kopje të certifikatës së kontrollit tip EU, shtojcat dhe shtesat e tij, si dhe dosjen teknike, duke përfshirë dokumentacionin e

paraqitur nga prodhuesi, deri në skadimin e vlefshmërisë së asaj certifikate.

10. Prodhuesi duhet të mbajë një kopje të certifikatës kontrolluese tip EU, shtojcat e saj dhe shtesa, së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve të vendit për një periudhë prej të paktën 10 vjet pas vendosjes në treg të lëndës plasëse në fjalë.

11. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë aplikimin të referuar në pikën 3 dhe përmbush detyrimet e parapara në pikat 7 dhe 8, me kusht që ato janë të specifikuara në mandat.

MODULI C2

Përputhshmëria me tipin e bazuar në kontrollin e prodhimit të brendshëm, si edhe kontrollet e mbikëqyrura të produktit në intervale të rastësishme kohore

1. Përputhshmëria me llojin, bazuar te kontrolli i brendshëm i prodhimit, si edhe kontrollet mbikëqyrëse të produktit në mënyrë rastësore, është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë me anë të së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e parapara në pikat 2, 3 dhe 4 dhe garanton e deklaron vetëm me përgjegjësinë e tij që lëndët plasëse në fjalë janë në përputhje me llojin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të llojit EU dhe përmbush kriteret e këtij ligji që zbatohet për to.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë që lëndët shpërthyes të prodhuara të përputhen me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe me kërkesat e këtij ligji që aplikohen për ato.

3. Kontrollet ndaj produktit

Organi i miratuar i zgjedhur nga prodhuesi kryen ekzaminime të lëndës në intervale jo të rregullta të përcaktuara nga organi për të kontrolluar cilësinë e kontrolleve të brendshme të lëndëve plasëse, duke marrë parasysh ndër të tjera, kompleksitetin teknologjik të lëndëve plasëse dhe sasinë e prodhimit. Për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndës plasëse me certifikatën ekzaminuese tip EU dhe me kërkesat e këtij ligji, një mostër e përshtatshme e lëndës përfundimtare, e marrë në vendin e prodhimit nga organi i miratuar përpara se të dalë në treg, duhet të



ekzaminohet dhe duhet të kryhen testet e përshtatshme të përcaktuara të specifikimet e tjera relevante. Në rast se një mostër nuk përputhet me nivelin e pranueshëm të cilësisë, organi merr masat e duhura.

Procedura që aplikohet për pranimin e mostrës ka për qëllim të përcaktojë nëse procesi i prodhimit të lëndës plasëse bëhet brenda kufijve të pranueshëm, duke pasur parasysh sigurimin e përputhshmërisë me lëndën plasëse.

Gjatë procesit të prodhimit, prodhuesi, nën përgjegjësinë e organit të miratuar, duhet të vendosë numrin e identifikimit të organit të miratuar.

4. Markimi CE dhe deklarata e përshtatshmërisë së BE-së

4.1 Prodhuesi bën markimin CE për secilën lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e paraparë në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e aplikueshme të këtij ligji.

Prodhuesi përpilon një deklaratë CE me shkrim për përputhshmërinë e secilës lëndë plasëse dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet që nga vendosja në treg e lëndës plasëse. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilën ajo është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve relevante, në vijim të kërkesës.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

MODULI D

Përputhshmëria me tipin e bazuar në garantimin e cilësisë së procesit të prodhimit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 5 dhe siguron e deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se lëndët plasëse në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji që aplikohen për ato.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar cilësie për inspektimin dhe testimin e lëndëve përkatëse plasëse, siç specifikohet në pikën 3 dhe ai i nënshtrohet monitorimit të përmendur në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi i paraqet organit të miratuar, të zgjedhur prej tij, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për lëndët e tij plasëse.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim që aplikimi i njëjtë nuk është dorëzuar në asnjë organ tjetër të miratuar;

c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e paraparë të lëndës plasëse;

ç) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

d) dokumentacionin teknik për tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip CE.

3.2 Sistemi i cilësisë siguron që lëndët plasëse janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji.

Sistemi i cilësisë siguron që lëndët plasëse janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e legjislacionit që aplikohen për ato.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentimi në lidhje me sistemin e cilësisë mundëson një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave për cilësinë.

Ato duhet të përmbajnë sidomos një përshkrim të saktë të:

a) objektivave të cilësisë, si dhe të strukturës organizative, përgjegjëseve dhe kompetencave të drejtuesve në lidhje me cilësinë e produktit;

b) teknikat dhe proceset korresponduese të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe garancisë dhe veprimet sistematike që do të përdoren;

c) ekzaminimet dhe testet që do të kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe sa shpesh do të kryhen ato;



ç) dokumenteve të cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit dhe raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.; dhe

d) mjeteve të e monitorimit të realizimit të cilësisë së kërkuar të produktit dhe funksionimit efikas të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i miratuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.2.

Ai duhet të prezumojë përputhshmërinë me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet e standardit relevant të harmonizuar.

Përveç përvojës me sistemet e menaxhimit të cilësisë, grupi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë në vlerësim për fushën relevante të prodhimit dhe teknologjisë së saj dhe të ketë njohuri të kërkesave të zbatueshme të këtij ligji. Auditimi përfshin edhe një vizitë vlerësuese në mjediset e prodhuesit. Ekipi i auditimit shqyrton dokumentacionin teknik të paraparë në pikën 3.1(e), për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të përmbushur kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e artikullit piroteknik me këto kërkesa.

Prodhuesi njoftohet për vendimin. Njoftimi përmban përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta mbajë atë në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë vazhdimisht të informuar organin e miratuar që ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të propozuar të sistemit të cilësisë.

Organi i miratuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i ndryshuar do të vazhdojë t'i përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 apo nëse nevojitet rivlerësim.

Vendimi i arsyetuar i vlerësimit duhet t'i bëhet i ditur prodhuesit. Njoftimi përmban rezultatet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të miratuar.

4.1 Qëllimi i monitorimit është garantimi që prodhuesi i përmbush siç duhet detyrimet që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi lejon organin e miratuar që të hyjë në mjediset e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit për qëllime inspektimi dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentet në lidhje me sistemin e cilësisë;

b) raportet e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.

4.3 Organi i miratuar kryen auditime periodike për të garantuar që prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë atij raportin e auditimit.

4.4 Përveç kësaj, organi i miratuar mund të bëjë vizita të panjoftuara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i miratuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste ose të caktojë të tjerë për kryerjen e tyre, me qëllimin për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon siç duhet. Organi i miratuar duhet t'i japë prodhuesit raportin për vizitën e kryer dhe, nëse janë kryer teste, raportin e testeve.

5. Markimi CE dhe Deklarata e përputhshmërisë CE

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar të cilit i referohet pika 3.1., vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit të çdo lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon artikullin piroteknik për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Prodhuesi vë në dispozicion të autoriteteve të vendit për një periudhë 10-vjeçare, pas vendosjes në treg të lëndës plasëse, si më poshtë:

a) dokumentacionin e referuar në pikën 3.1;

b) informacionin që ka të bëjë me ndryshimin të referuar në pikën 3.5, të miratuar;



c) vendimet dhe raportet e organit të miratuar të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organ i miratuar informon autoritetet notifikuese për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të tërhequra dhe në mënyrë periodike apo në vijim të kërkesës, vë në dispozicion të autoriteteve notifikuese listën e sistemit të cilësisë, të miratuar, refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i miratuar informon organet e tjera të notifikuara për miratimin e sistemit të cilësisë të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr apo kufizuar dhe në vijim të kërkesës vë në dispozicion miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

MODULI E

Përputhshmëria me tipin bazuar në garantimin e cilësisë së produktit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2 dhe 5, siguron dhe deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se lëndët plasëse në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji.

2. Prodhimi

Prodhuesi përdor një sistem të miratuar cilësie për inspektimin dhe testimin e lëndëve përkatëse plasëse, siç specifikohet në pikën 3 dhe ai i nënshtrohet monitorimit të përmendur në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

3.1 Prodhuesi i paraqet organit të miratuar, të zgjedhur prej tij, një aplikim për vlerësimin e sistemit të cilësisë për lëndët plasëse në fjalë.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;

b) një deklaratë me shkrim që aplikimi i njëjtë nuk është dorëzuar në asnjë organ tjetër të miratuar;

c) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e paraparë të lëndës plasëse;

ç) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

d) dokumentacionin teknik për tipin e miratuar dhe një kopje të certifikatës ekzaminuese tip CE.

3.2 Sistemi i cilësisë siguron që lëndët plasëse janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që përmbush kërkesat e këtij ligji.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve me shkrim. Dokumentimi në lidhje me sistemin e cilësisë mundëson një interpretim konsistent të programeve, planeve, manualeve dhe të dhënave për cilësinë.

Ato duhet të përmbajnë sidomos një përshkrim të saktë të:

a) objektivave të cilësisë, si dhe të strukturës organizative, përgjegjëseve dhe kompetencave të drejtuesve në lidhje me cilësinë e produktit;

b) ekzaminimet dhe testet që do të kryhen pas prodhimit;

c) dokumentimit të cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrimit dhe raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.; dhe

ç) mjeteve të monitorimit të funksionimit efikas të sistemit të cilësisë.

3.3 Organi i miratuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3.2.

Ai duhet të prezumojë përputhshmërinë me këto kërkesa në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë që përputhen me specifikimet e standardit relevant të harmonizuar.

Përveç përvojës me sistemet e menaxhimit të cilësisë, grupi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me përvojë në vlerësim për fushën relevante të prodhimit dhe teknologjisë së saj dhe të ketë njohuri të kërkesave të zbatueshme të këtij ligji. Auditimi përfshin edhe një vizitë vlerësuese në mjediset e prodhuesit. Ekipi i auditimit shqyrton dokumentacionin teknik të paraparë në pikën 3.1(e) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat përkatëse të këtij ligji dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria e lëndës plasëse me këto kërkesa.



Prodhuesi njoftohet për vendimin. Njoftimi përmban përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.4 Prodhuesi duhet të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë dhe ta mbajë atë në një nivel të përshtatshëm dhe efikas.

3.5 Prodhuesi duhet ta mbajë vazhdimisht të informuar organin e miratuar që ka miratuar sistemin e cilësisë, për çdo ndryshim të propozuar të sistemit të cilësisë.

Organi i miratuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i ndryshuar do të vazhdojë t'i përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3.2 apo nëse nevojitet rivlerësim.

Vendimi i arsyetuar i vlerësimit duhet t'i bëhet i ditur prodhuesit. Njoftimi përmban rezultatet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të miratuar

4.1 Qëllimi i monitorimit është garantimi që prodhuesi i përmbush siç duhet detyrimet që lindin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

4.2 Prodhuesi e lejon, për qëllime vlerësimi, organin e miratuar që të hyjë në mjediset e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit për qëllime inspektimi dhe t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

b) raportet e cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testit, të dhënat e kalibrit, raportet e kualifikimit të personelit të përfshirë etj.

4.3 Organi i miratuar kryen auditime periodike për të garantuar që prodhuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe duhet t'i japë atij raportin e auditimit.

4.4 Përveç kësaj, organi i miratuar mund të bëjë vizita të panjoftuara te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i miratuar, nëse është e nevojshme, mund të kryejë teste ose të caktojë të tjerë për kryerjen e tyre, me qëllimin për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon siç duhet. Organi i miratuar duhet t'i japë prodhuesit raportin për vizitën e kryer dhe, nëse janë kryer teste, raportin e testeve.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë CE

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar të cilit i referohet pika 3.1, vendos numrin e identifikimit të këtij të

fundit të çdo lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip EU dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Prodhuesi vë në dispozicion të autoriteteve të vendit për një periudhë 10-vjeçare, pas vendosjes në treg të lëndës plasëse, si më poshtë:

a) dokumentin e referuar në pikën 3.1;

b) informacionin që ka të bëjë me ndryshimin e referuar në pikën 3.5, të miratuar;

c) vendimet dhe raportet e organit të miratuar, të referuar në pikat 3.5, 4.3 dhe 4.4.

7. Çdo organ i miratuar informon autoritetet notifikuese për miratimet e sistemit të cilësisë të lëshuara apo të tërhequra dhe në mënyrë periodike apo në vijim të kërkesës, vë në dispozicion të autoriteteve notifikuese listën e sistemit të cilësisë, të miratuar, refuzuar, pezulluar apo të kufizuar.

Çdo organ i miratuar informon organet e tjera të miratuara për miratime të sistemit të cilësisë të cilat ai ka refuzuar, pezulluar, tërhequr apo kufizuar dhe në vijim të kërkesës vë në dispozicion miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3.1, 3.5, 5 dhe 6, mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

MODULI F

Përputhshmëria me tipin e bazuar në verifikimin e produktit

1. Përputhshmëria me tipin e bazuar në cilësinë e procesit të prodhimit është pjesë e procedurës së vlerësimit të përputhshmërisë ku prodhuesi përmbush detyrimin e përcaktuar në pikat 2, 5.1 dhe 6, siguron dhe deklaron me përgjegjësi vetëm të tij se lëndët plasëse në fjalë, që i janë nënshtruar



dispozitave të pikës 3, janë në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE.

2. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhshmërinë e lëndës së prodhuar plasëse me kërkesat e aplikueshme të përshkruara në certifikatën ekzaminuese tip CE.

3. Verifikimi

Një organ i miratuar, i zgjedhur nga prodhuesi, kryen ekzaminimet dhe testet përkatëse, për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndës plasëse me tipin e miratuar e të përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

Ekzaminimet dhe testet për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndëve plasëse me kriteret e duhura, kryhen sipas zgjedhjes së prodhuesit ose duke ekzaminuar dhe testuar çdo produkt, siç përcaktohet në pikën 4 ose duke ekzaminuar dhe testuar lëndët plasëse në baza statistikore, siç përcaktohet në pikën 5.

4. Verifikimi i përputhshmërisë me anë të ekzaminimit dhe testimit të çdo produkti

4.1 Të gjitha lëndët plasëse duhet të ekzaminohen apo testohen siç duhet në mënyrë individuale, siç parashikohet te standardet relevante të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikimet e tjera relevante teknike, të kryhen në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me tipin e miratuar të certifikatës ekzaminuese tip EU. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi i miratuar vendos për testin përkatës që duhet të kryhet.

4.2 Organi i miratuar lëshon një certifikatë të përputhshmërisë në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe të vendosë numrin e identifikimit të secila lëndë plasëse e miratuar apo ta vendosë atë nën përgjegjësinë e saj.

Prodhuesi ruan certifikatat e përputhshmërisë dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve të vendit për inspektim për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

5. Verifikimi statistikor i përputhshmërisë

5.1 Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë homogjenitet për secilin grup produktesh të prodhuara dhe t'i paraqesë lëndët e tij plasëse për verifikim në grupe produktesh.

5.2 Mostrat e rastësishme duhet të merren nga secili grup produkti. Të gjitha lëndët plasëse të një mostre të ekzaminohen dhe testohen në mënyrë e duhur, siç përcaktohet te standardet relevante të harmonizuara dhe testet ekuivalente, siç përcaktohen në specifikimet e tjera teknike, të kryhen në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me tipin e miratuar të përshkruar te certifikata ekzaminuese e tipit CE dhe për të përcaktuar nëse grupi i produkteve është pranuar apo refuzuar. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi i miratuar në fjalë të vendosë për testet e përshtatshme që do të kryhen.

5.3 Nëse një grup produktesh pranohet, të gjitha lëndët plasëse të grupit të produkteve konsiderohen të pranura, përveç atyre lëndëve plasëse që në bazë të mostrës, nuk përmbushin kriteret e testimit.

Organi i miratuar lëshon një certifikatë të përputhshmërisë në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe vendos numrin e tij të identifikimit të secila lëndë plasëse e miratuar ose e vendos atë nën përgjegjësinë e saj.

Prodhuesi ruan certifikatat e përputhshmërisë dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve të vendit për inspektim për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

5.4 Nëse një grup produktesh refuzohet, organi i miratuar apo autoriteti kompetent merr masat e duhura për parandalimin e vendosjes në treg të këtij grupi produktesh. Në rast të refuzimit të shpeshtë të grupeve të produkteve, organi i miratuar mund të pezullojë verifikimin statistik dhe të marrë masat e duhura.

6. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë CE

6.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar të cilit i referohet pika 3, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit të çdo lëndë plasëse që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

6.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilin ai është përpiluar.



Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

Nëse organi i miratuar i referuar në pikën 3 është dakord dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë të lëndët plasëse numrin e identifikimit të organit të miratuar.

Nëse organi i miratuar është dakord dhe nën përgjegjësinë e tij, prodhuesi mund të vendosë të lëndët plasëse numrin e identifikimit të organit të miratuar gjatë procesit të prodhimit.

7. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandatin. Një përfaqësues i autorizuar mund të mos përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5.1.

MODULI G

Përputhshmëria e bazuar te verifikimi i njësisë

1. Përputhshmëria e bazuar te verifikimi i njësisë është procedura e vlerësimit të përputhshmërisë me anë të së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 5 dhe garanton e deklaron me përgjegjësinë e tij të vetme se lënda plasëse në fjalë, objekt i dispozitave të pikës 4, është në përputhje me kërkesat e këtij ligji që aplikohen për atë.

2. Dokumentacioni teknik

2.1 Prodhuesi përpilon dokumentacionin teknik dhe e vë atë në dispozicion të organit të miratuar të referuar në pikën 4. Dokumentacioni mundëson vlerësimin e përputhshmërisë së lëndës plasëse me kërkesat përkatëse dhe duhet të përfshijë një analizë adekuate dhe vlerësimin e riskut. Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe, sa i përket vlerësimit, ai përfshin projektimin, prodhimin dhe funksionimin e lëndës plasëse. Dokumentacioni teknik, kudo që është i zbatueshëm, duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të përgjithshëm të lëndës plasëse;

b) projektin konceptual, skicime të prodhimit dhe diagrame të komponentëve, nënkomplete, qarqe etj.;

c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar ato projekte dhe skicime, si dhe funksionimin e lëndës plasëse;

ç) listën e standardeve të harmonizuara që janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht, dhe në rast të moszbatimit të standardeve të harmonizuara, të japë përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për përmbushjen e kërkesave kryesore të sigurisë e këtij ligji, duke përfshirë edhe një listë tjetër përkatëse të specifikimeve teknike të aplikuara. Në rast të zbatimit të pjesshëm të standardeve të harmonizuara, dokumentacioni teknik specifikon pjesët të cilat janë zbatuar;

d) rezultatet e llogaritjeve të projektit dhe ekzaminimet e kryera etj.;

dh) raportet e testit.

2.2 Prodhuesi ruan dokumentacionin teknik dhe e vë në dispozicion të autoriteteve përkatëse të vendit për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

3. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhshmërinë e lëndës plasëse të prodhuar me kërkesat e aplikueshme të këtij ligji.

4. Verifikimi

Një organ i miratuar, i zgjedhur nga prodhuesi, kryen ekzaminimet dhe testet përkatëse, të përcaktuara te standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose testet ekuivalente të përcaktuara në specifikime të tjera teknike, për të kontrolluar përputhshmërinë e lëndës plasëse me kërkesat e zbatueshme të këtij ligji ose t'i kryejë përmes të tjerëve. Në mungesë të një standardi të tillë të harmonizuar, organi në fjalë i miratuar vendos për kryerjen e testeve të duhura.

Organi i miratuar lëshon një certifikatë përputhshmërie në lidhje me ekzaminimet dhe testet e kryera dhe vendos numrin e identifikimit të lëndës plasëse e miratuar ose e vendos atë numër me anë të të tjerëve, nën përgjegjësinë e tij.

Prodhuesi ruan certifikatat e përputhshmërisë dhe i vë ato në dispozicion të autoriteteve të vendit për inspektim për 10 vjet, pasi lënda plasëse të jetë vendosur në treg.

5. Markimi CE dhe deklarata e përputhshmërisë CE

5.1 Prodhuesi bën markimin CE dhe nën përgjegjësinë e organit të miratuar, të cilit i referohet pika 4, vendos numrin e identifikimit të këtij të fundit të lëndës plasëse, që është në



përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën ekzaminuese tip CE dhe që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij ligji.

5.2 Prodhuesi përpilon një deklaratë me shkrim të përputhshmërisë CE për çdo model të produkteve dhe e vë atë në dispozicion të autoriteteve të vendit për 10 vjet, që nga koha kur lënda plasëse është vendosur në treg. Deklarata e përputhshmërisë CE identifikon lëndën plasëse për të cilin ai është përpiluar.

Një kopje e deklaratës së përputhshmërisë CE vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse në vijim të kërkesës.

6. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 2.2 dhe 5 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që një gjë e tillë të përcaktohet në mandat.

SHTOJCA IV

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

1. Nr. ... (produkt, tip, numër ngarkese apo numër serie):

2. Emri dhe adresa e prodhuesit dhe kur nevojitet edhe ato të përfaqësuesit të autorizuar.

3. Kjo deklaratë e përputhshmërisë lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit.

4. Objekti i deklaratës (identifikimi i produktit që mundëson gjurmimin e lëndës plasëse).

5. Objekti i deklaratës i përshkruar më lart është në përputhje me legjislacionin relevant të harmonizuar të Bashkimit Evropian.

6. Referencat në lidhje me standardet e përdorura relevante të harmonizuara apo referencat e specifikimeve të tjera teknike në lidhje me përshtatshmërinë e deklaruar:

7. Organi i miratuar... (emri, numri) ka kryer... (përshkrimin e ndërhyrjes) dhe lëshon certifikatën:

8. Informacion shtesë:

E nënshkruar për dhe në emër të:

(vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni)

(nënshkrimi):

LIGJ

Nr. 78/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE PËR PROJEKTIN “AFTËSI PËR PUNË”, FAZA 2, 2019–2023

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për projektin “Aftësi për punë”, faza 2, 2019–2023 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.6.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13119, datë 28.6.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.



MARRËVESHJE

MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCave DHE EKONOMISË DHE
KONFEDERATËS ZVICERANE,
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM PËR PROJEKTIN “AFTËSI
PËR PUNË”, FAZA 2,
2019–2023

Në vijim të përpjekjeve për të fuqizuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis dy vendeve;

Marrëveshjes Kuadër për Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndhimën Humanitare midis Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë Shqiptare, të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë si ligji nr. 9801, datë 13 shtator 2007,

dhe respektimit të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut, të parashtruara veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dyja Palëve dhe përbën një element thelbësor së bashku me objektivat e kësaj Marrëveshjeje;

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane, kanë rënë dakord për termat dhe kushtet, si më poshtë vijojnë:

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

Kudo që janë përdorur në këtë Marrëveshje, termat në vijim do të kenë kuptimet e mëposhtme, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe:

a) “Palët Kontraktuese” nënkuptojnë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane;

b) “Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë” nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

c) “Konfederata Zvicerane” përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Departamentit Federal Zviceran i Punëve të Jashtme (SDC);

d) “Projekti” nënkupton projektin “Aftësi për punë”, faza 2;

e) “Konfederata Zvicerane” nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

f) “Grant” nënkupton kontributin e dhënë nga Konfederata Zvicerane, sipas kësaj Marrëveshjeje;

g) “Partneri zbatues” nënkupton *Swisscontact*;

h) “AFP” nënkupton Arsimin dhe Formimin Profesional.

Neni 2

Përgjegjësia e Zbatimit

Përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes janë autoritetet e mëposhtme: Për Konfederatën Zvicerane:

SDC-ja, përfaqësuar nga Ambasada e Zvicrës në Shqipëri.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

SDC-ja ia beson zbatimin e Projektit Partnerit Zbatues. Partneri Zbatues u përzgjedh në bazë të një procedure të hapur tenderi në fazën 1 të Projektit, të cilit i akordohet në mënyrë të drejtpërdrejtë faza 2, në përputhje me Udhëzimin Federal Zviceran për rregullat dhe rregulloret e prokurimit publik.

Neni 3

Qëllimet dhe objektivat

Objekтиви i përgjithshëm i Projektit është: Gratë dhe burrat në moshë të re nga të gjitha grupet sociale në Shqipëri të gjejnë mundësi të mira dhe fitimprurëse punësimi falë përmirësimit të aftësive.

Rezultatet specifike të këtij Projekti janë si vijon:

a) gratë dhe burrat në moshë të re kanë akses në ofertë arsimit dhe formimit që është e dobishme dhe e orientuar nga puna në sektorë me potencial zhvillimi;

b) sektori privat merr përsipër përgjegjësinë për përcaktimin, ofrimin dhe financimin e AFP-së në nivel ofruesi.

Për arritjen e këtyre objektivave, Projekti bashkëpunon me institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Agjencia



Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë, Agjencia Kombëtare e AFP-së, sektori privat dhe shoqatat e biznesit.

Ndërhyrjet, aktivitetet dhe rezultatet kryesore të parashikuara përcaktohen në dokumentin e Projektit. Përmbledhja e Dokumentit të Projektit është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje (shtojca 1).

Neni 4

Detyrimet e Palëve Kontraktuese

Detyrimet specifike të Konfederatës Zvicerane përfshijnë:

a) Deri më 30 gusht 2023, Konfederata Zvicerane synon të parashikojë fonde në formën e një granti të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej CHF 9,600,000 (nëntë milion e gjashtëqind mijë franga zvicerane), i cili do të përdoret vetëm për zbatimin e Projektit, sipas qëllimeve dhe objektivave të përcaktuar më sipër në nenin 3 dhe Dokumentin e Projektit (shtojca 1).

b) Ky grant nuk mund të alokohet për asnjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e Grantit që do të mbetet në fund të Projektit, i kthehet Konfederatës Zvicerane;

c) Konfederata Zvicerane ka kontraktuar përmes SDC-së Partnerin Zbatues si organizatë zbatuese;

d) Granti do të disbursohet dhe auditohet, sipas dispozitave të kontratës midis SDC-së dhe Partnerit Zbatues.

Detyrimet specifike të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfshijnë:

a) Ministria e Financave dhe Ekonomisë vepron si bashkëpërgjegjëse për strategjinë e Projektit;

b) Sigurimi i bashkërendimit të Projektit me politikat kombëtare dhe kuadrin përkatës ligjor për të mundësuar dhe për të promovuar koherencën e objektivave të Projektit me kushtet e kuadrit kombëtar;

c) Mbështetja e lehtësimit dhe e ndarjes së përvojave dhe e informacioneve, bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e Projektit në nivel kombëtar;

d) Mbështetja dhe lehtësimi i ndërveprimit dhe i bashkëpunimit me ministritë dhe institucionet e tjera.

e) Sigurimi i përgjigjshmërisë dhe i bashkëpunimit të strukturave të decentralizuara në nivel rajonal dhe/ose lokal;

f) Vënia në dispozicion e buxhetit të nevojshëm për të kompensuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të Projektit në një shumë maksimale prej 1'000'000 CHF (një milion franga zvicerane). Rimbursimet e TVSH-së bëhen me baza vjetore.

Neni 5

Menaxhimi i Projektit

a) Projekti është një nismë e përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe SDC-së përmes Ambasadës së Zvicrës;

b) Partneri Zbatues merr përsipër në emër të Konfederatës Zvicerane të gjitha detyrat operacionale, administrative dhe mbikëqyrëse të Projektit, duke përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin;

c) SDC-ja mund të autorizojë ekspertë vendës dhe të huaj në plan afatgjatë dhe afatshkurtër për të mbështetur zbatimin e Projektit;

d) SDC-ja mund të autorizojë individë të tjerë dhe organizata kombëtare ose ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve të veçanta të Projektit si p.sh. për vlerësimin afatmesëm dhe vlerësimin përfundimtar të projektit;

e) Ministria e Financave dhe Ekonomisë ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të Projektit, ofron akses në informacione përkatëse, duke përfshirë të dhëna statistikore, të cilat konsiderohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit.

Neni 6

Mbikëqyrja dhe Koordinimi

Në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrja, cilësia, përshtatshmëria dhe koordinimi i Projektit, si dhe adresimi i çështjeve të lidhura me politikat, ngrihet Komiteti Drejtues (KD), i cili parashikohet të mbledhet të paktën dy herë në vit (zakonisht në prill dhe shtator). Mund të organizohen mbledhje të paprogramuara, me kërkesë të njërit prej anëtarëve të KD-së. Mbledhjet kryesohen bashkërisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ambada e Zvicrës në Shqipëri.

KD-ja e arrin kuorumin vetëm kur janë të pranishëm përfaqësuesit e të dyja Palëve. Vendimet merren me konsensusin e të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote. Në qoftë se



konsensusi nuk arrihet, fillohet një proces negocimi. SDC-ja gëzon te drejtën e marrjes së vendimit përfundimtar.

KD-ja përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfshirë agjencitë vartëse, bashkëkryetar (4 përfaqësues, 1 votë);

- Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, bashkëkryetar (2 përfaqësues, 1 votë);

- Përfaqësues të sektorit privat (4 përfaqësues, 1 votë);

- Ofruesit e AFP-së, mbështetur nga Projekti (2 përfaqësues me rotacion, 1 votë)

Në varësi të agjendës, institucionet e tjera (ministri të tjera, OJF dhe projekte të ngjashme) mund të bëhen pjesë e KD-së si vëzhgues me ftesë të bashkëkryetarit dhe pa të drejtë vote.

Sekretariati i Bordit Këshillimor ofrohet nga Projekti. Menaxheri i Projektit i Partnerit Zbatues merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

KD-ja ndërmerr detyrat e mëposhtme:

- a) Ofrimin e këshillimit strategjik, teknik dhe operacional; udhëzimeve dhe rekomandimeve të Projektit dhe Partnerit të tij Zbatues lidhur me fushat e ndërhyrjes së Projektit dhe instrumentet e qasjeve metodologjike;

- b) Rishikimin dhe aprovimin e Planit Vjetor të Operacioneve të Projektit (PVO);

- c) Këshillimin e Ekipit të Projektit mbi objektivat tematikë dhe gjeografikë për përdorimin e instrumenteve të Projektit, të informuara nga raportet monitoruese të Ekipit të Projektit.

- d) Rishikimin e dokumenteve strategjike, raporteve dhe planeve vjetore, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme.

Palët Kontraktuese e informojnë në kohë njëra-tjetrën, në një shkallë të arsyeshme dhe praktike, si dhe konsultohen me njëra-tjetrën, lidhur me çdo ngjarje, që pengon apo mund të vështirësojë zbatimin e suksesshëm të Projektit.

Neni 7

Prokurimi i Mallrave dhe i Shërbimeve

- a) Mallrat dhe shërbimet, që financohen nga produktet e kontributit zviceran prokurohen nga Partneri Zbatues, në përputhje me ligjin zviceran të prokurimeve. Organizata zbatuese është përgjegjëse për prokurimin e mallrave,

shërbimeve dhe punimeve ndërtimore të nevojshme për zbatimin e Projektit, duke respektuar parimet e konkurrencës së ndershme (të lirë dhe të drejtë) për të gjithë ofertuesit e mundshëm, në mënyrë që të sigurojë efikasitet në përdorimin e fondeve publike.

- b) Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, mallrat e ofruara me fondet e SDC-së për përdorim, në kuadër të Projektit, i vihen Projektit në dispozicion në mënyrë të pakufizuar dhe nuk devijohen nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të SDC-së;

- c) Nëse për ndonjë arsye Projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara përmes kontributit zviceran vendoset me shkrim nga Palët.

- d) Në fund të Projektit, SDC-ja duhet të vendosë për pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar gjatë zbatimit të Projektit;

- e) Mallrat e prokuruar nga Projekti për organizatat partnere i dorëzohen dhe merren përsipër nga autoriteti kompetent përkatës me miratimin e SDC-së.

Neni 8

Zgjidhja e Marrëveshjes

- a) Secila Palë ka të drejtë ta zgjidhë Marrëveshjen aktuale përmes një njoftimi me shkrim gjashtë muaj përpara përfundimit.

- b) Nëse njëra nga Palët gjykon se qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të arrihen më, ose që Pala tjetër nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër ka të drejtën ta anulojë ose ta zgjidhë këtë Marrëveshje, duke bërë një njoftim me shkrim tre muaj përpara. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje me efekte të menjëhershme, në rast të ndonjë shkeljeje përmbajtësore të Marrëveshjes. Shkelje përmbajtësore nënkupton shkelje të rëndë të një prej objektiveve thelbësore të kësaj marrëveshjeje.

- c) Në rast se ngjarjet e forcës madhore (fatkeqësi natyrore etj.) pengojnë ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, secila Palë mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje që nga momenti kur bëhet i pamundur zbatimi i saj.

- d) Në rast zgjidhjeje të parakohshme të kësaj Marrëveshjeje ose në fund të Projektit, çdo fond



i pashpenzuar, i ofruar brenda kuadrit të Projektit, i kthehet SDC-së.

Neni 9

Ndryshimet dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo ndryshim ose amendim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dy Palëve.

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose aplikimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje zgjidhen përmes negociatave diplomatike midis Palëve.

Neni 10

Dispozita të përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk duhet të kërkojnë as në mënyrë të drejtpërdrejtë, as në mënyrë të tërthortë përfitime të çfarëdo lloj natyre. Ato nuk duhet të pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje korruptuese ose e paligjshme përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje dhe justifikon zgjidhjen e saj, si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese shtesë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 11

Shtojcat

Dokumenti i Projektit (shtojca 1) është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Kohëzgjatja dhe efektshmëria

Kjo Marrëveshje është e vlefshme nga data 1 maj 2019 deri më 30 qershor 2023. Ajo hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të të dyja Palëve dhe përmbylles së procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe përfundon sapo të dyja Palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale.

Kjo Marrëveshje është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Të dyja versionet janë origjinale dhe mbartin të njëjtën vlerë. Në rast mospërputhjes në interpretim, mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Palët e mëposhtme konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në Tiranë, më 25.9.2020.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Anila Denaj

Ministre

Ministria e Financës dhe Ekonomisë

PËR QEVERINË E KONFEDERATËS ZVICERANE

Adrian Maître

Ambasador

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

AFTËSI PËR PUNË (FAZA 2)

Përmbledhje e ndërhyrjes

Projekti “Aftësi për punë” synon akses më të mirë në punësim me fitim dhe të ardhura për gratë dhe burrat e rinj, duke u ofruar atyre mundësi të vlefshme trajnimit, bazuar në mënyra të reja përfshirëse të të nxëniet dhe në bashkëpunimin me sektorin privat. Nga Projekti do të përfitojnë rreth 17.360 studentë dhe individë të trajnuar.

Synimi i Projektit është: Që të rejat dhe të rinjtë nga të gjitha grupimet shoqërore në Shqipëri të gjejnë punësim tërheqës dhe me fitim falë aftësive të përmirësuara.

Rezultatet që do të arrihen nga Projekti janë:

Rezultati 1: Të rejat dhe të rinjtë kanë qasje në një ofertë arsimit dhe formimit që ka **rezultat dhe është e orientuar nga tregu** në sektorë me mundësi rritje.

Rezultati 2: Sektori privat **ndërmerr përgjegjësi** për përcaktimin, ofrimin dhe financimin e AFP-së në nivel ofruesi.

Për të arritur këto rezultate, Projekti do të përqendrohet në pesë linja ndërhyrjeje, përkatësisht:

1. Marrëdhëniet me punëdhënësit dhe partnerët

Në fazën e parë Projekti S4J promovoi me sukses një qasje të re për marrëdhëniet e punëdhënësve dhe marrëdhëniet e partnerëve, duke zbatuar një qasje 1 me 1 dhe duke krijuar një rrjet përreth çdo ofruesi të AFP-së. Qasja 1 me 1 është e përshtatur për realitetet ekonomike të



Shqipërisë dhe pranon mësimnxënien nga shumë përpjekje të dobëta në projekte të tjera për të zhvilluar marrëdhënie me sektorin e organizuar privat. Ofruesit e AFP-së marrin rolin e tyre si pika kontakti në rrjet dhe në kuadrin e fazës II, ata do ta përforcojnë këtë rrjet duke e strukturuar dhe zyrtarizuar atë, si dhe duke shtuar partnerë që nuk janë shoqëri, përfshirë sektorin e organizuar privat (ku ka interes real për AFP-në), aktorët qeveritarë vendorë dhe kombëtarë, prindërit në rrjet duke zbatuar të njëjtën qasje 1 me 1. Në ato rajone ku ofruesit janë aktivë së bashku me ofrues të tjerë AFP-je për krijimin, shtrirjen dhe/ose konsolidimin e rrjeteve përkatëse. Megjithatë, qasja 1 me 1 do të zhvillohet më tej në shkallë rajonale duke krijuar platforma AFP-je që do të bashkojnë të gjitha palët përkatëse të interesit për të zhvilluar më tej AFP-në në rajon.

2. Diversifikimi i ofertës/ofrues shumë-funksionalë

S4J do të lehtësojë zhvillimin e ofertave AFP cilësore, të orientuara nga tregu, të ndjeshme ndaj gjinisë, formale dhe joformale, afatgjata dhe afatshkurtra në sektorë që kanë kërkesa të larta në rajonet ku ato shërbejnë. Këto oferta do të hartohen në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit vendorë dhe rajonalë dhe zyrat e SHKP-së. Ofertat mund të përfshijnë hoteleri dhe turizëm, ndërtim, tekstile dhe TIK ose të shkojnë përtej këtyre sektorëve fillestarë kyç të S4J-së. Ofertat hartohen bazuar në shkallët përkatëse të kualifikimit. Ato zbatojnë modalitete zhvillimi, që përfshijnë qasje me module aty ku është e përshtatshme, për të përmbushur nevojat dhe mundësitë e grupeve të synuara. Si pasojë, shkollat e AP-së që mbështeten do të kthehen në ofrues shumëfunksional, çka thelbësisht ndryshon mënyrën e tyre të funksionimit. Përveç drejtimeve, profileve apo kurseve, Projekti do të mbështesë ofruesit e AFP-së të shtojnë elementet e tjera me rëndësi në ofertat e tyre, përkatësisht përfshirjen e aftësive të sipërmarrjes dhe aftësitë e përgjithshme, si dhe veprimtaritë jashtëshkollore me rëndësi për tregun e punës.

3. Mënyra të reja të të nxënësve gjithë-përfshirës dhe cilësie

Gjatë fazës së dytë do të zhvillohen më tej një sërë modelesh për zbatimin e mësimnxënies së përzier, duke u përqendruar në ato që kërkojnë

qasje të lehtë në infrastrukturën e TI-së. Kjo përkthehet në një qasje të përzier mësimnxënie që i bën ofertat e AFP-së më tërheqëse, ndërkohë që qasja në to bëhet më e lehtë edhe për grupe me nevoja të veçanta. Kombinuar me trajnimet kryesuese në industri për riaftësimin e mësuesve të AFP-së, qasja e re i bën trajnimet e AFP-së edhe më të përshtatshme në tregun e punës, duke qenë se kjo qasje e re e të nxënësve mbështet zhvillimin e aftësive joprofesionale, si zgjidhja e problemeve, puna në grup dhe të menduarit krijues dhe novator, që janë aftësi kyçe për arritjen e suksesit në tregun e punës, dhe që mbështesin Shqipërinë tek konkurrenca në shkallë ndërkombëtare. Faktorët e përzgjedhjes dhe të përjashtimit, si: vendndodhja, koha, gjinia, mosha ose faktorë të tjerë kufizues që nuk lejojnë përdorimin më të mirë të sistemit të formimit në Shqipëri, tashmë kanë më pak rëndësi, duke e bërë sistemin më gjithëpërfshirës.

4. Të nxënësve të bazuar në punë, në bashkëpunim me punëdhënësit

Në kuadër të linjës së ndërhyrjes nr. 4, Projekti S4J do të vijojë me fuqizimin dhe zgjerimin e nismave të suksesshme të të nxënësve të bazuar në punë, duke mbështetur partnerët shqiptarë në bashkëpunim të ngushtë me QSH-në dhe Projektin SD4E të zbatuar nga UNDP-ja për të konsoliduar, zgjeruar dhe shtrirë qasjen e zgjedhur të të nxënësve të bazuar në punë, përfshirë skemat e zhvillimit gradual të aftësive, praktikat profesionale dhe zgjedhjet për stazh pune. Skemat e stazhit do të vijojnë të përmbushin standardet ndërkombëtare të cilësisë, përkatësisht kuadrin e ILO dhe BE-së për stazhin cilësor. Shoqërive do t'u sigurohet mbështetja e nevojshme, me trajnime dhe mjete, për të ofruar praktika dhe stazhe cilësore, përfshirë edhe formimin e mentorëve në shoqëri. Projekti mbështet partnerët shqiptarë për krijimin e mekanizmave dhe instrumenteve të sigurimit të cilësisë, me qëllim sigurimin e stazheve me cilësi të mirë, duke garantuar standardet e cilësisë kur qasja të jetë shtrirë përtej kontekstit të kontrolluar nga Projekti.

5. Administrimi i ofruesve/zhvillimi organizativ (OD)

Rezultatet e arritura përmes linjës së ndërhyrjes 5 u mundësojnë ofruesve të AFP-së të punojnë më mirë brenda organizatës së tyre, të jenë të organizuar dhe të përgatitur për funksionet e reja të përcaktuara nga ligji i ri për AFP-në dhe të hartuara



me mbështetjen e Projektit për partnerët ofrues në fazën e parë. Elemente të rëndësishme përfshijnë orientimin strategjik të ofruesve të AFP-së, përfshirë organizimin e tyre strategjik (strategjia e ofruesit, përbërja e bordit, funksionet dhe proceset e reja dhe të ndryshuara), funksionet e menaxhimit të bazuara në TI, të shtatë funksionet e dhëna të ashtuquajturave njësi zhvillimi dhe sigurimin e përmirësimit të cilësisë në përgjithësi për ofruesin dhe, në veçanti, duke u siguruar që cilësia të jetë shqetësim i përbashkët dhe një punë e përditshme, duke përfshirë këtu të gjithë anëtarët dhe ofruesit. Në mbështetje të funksioneve të Njërive të Zhvillimit, Projekti do të lehtësojë, gjithashtu, edhe mundësimin e lehtësirave dhe të instrumenteve novatore për hyrjen në tregun e punës në ofruesit e AFP-së, veçanërisht sa u përket masave për zhvillimin e karrierës dhe mbështetjen e nxënësit për gratë dhe burrat me nevoja të veçanta. Ato do të përfitojnë nga ndërhyrjet e hershme, me qëllim sigurimin e integritetit të tyre të suksesshëm në tregun e punës; e skemave të udhëheqjes me objekt të përcaktuar, dhe instrumente udhëzuese të thjeshta për të trajnuarit, në mënyrë që ata të zhvillojnë kompetencat e tyre dhe të gjejnë me sukses rrugëtimin e tyre drejt punësimit.

Projekti do të mbështesë kryesisht 11 ofrues në rrethet Shkodër, Lezhë, Tiranë, Berat, Vlorë dhe Elbasan. Këta ofrues përfshijnë partnerët aktualë të Projektit (“Hamdi Bushati”, “Kolin Gjoka”, “Gjergj Canco”, “Kristo Isak”, Shkollën Industriale “Pavarësia”, Shkollën Tregtare dhe QFP-ja në Vlorë) dhe partnerët e rinj (Shkollën Teknike dhe Ekonomike në Tiranë, “Sali Ceka” dhe “Ali Myftiu” në Elbasan). Në QFP në Elbasan do të zbatohet një qasje më e lehtë për të testuar një qasje bazuar në shoqëri (maksimumi 3 kurse me 400 të trajnuar gjithsej).

Bazuar në supozimin se sistemi AFP do të ristrukturohet dhe se do të ngrihen Qendra Shumëfunksionale (QSHF), edhe 9 ofrues shtesë (përfshirë 3 QFP) mund të përfitojnë drejtpërsëdrejti (përkatesisht në nivelin e kapaciteteve të qendëruara të administrimit të shkollës dhe bazuar në disa paketa të përzgjedhura transferimi) ose tërthorazi (duke mësuar e kopjuar nga ofruesit partnerë në strukturën e QSHF-ve) nga rezultatet e Projektit. Kjo e çon numrin e ofruesve të përfshirë në 20, që është thujasë gjysma e të gjithë ofruesve në vend. Ofrues të tjerë mund

të përfitojnë nga reagimi në sistem, duke qenë se disa prej novacioneve mund të shtrihen në të gjithë sistemin me mbështetje specifike nga S4J nëse QSH vendos ta bëjë diçka të tillë (p.sh. sistemi i informacionit të menaxhimit të ofruesit, njësitë e zhvillimit dhe funksionet e tyre specifike, elemente të infrastrukturës NWOIL e të tjera). Në këtë rast, mbështetja e S4J do të ishte e kufizuar në ngritje kapacitetesh dhe disa masa udhëheqjeje që mbulohen në buxhetin e parashikuar.

Përfundimet kryesore në secilën fushë ndërhyrjeje:

Linja e ndërhyrjes 1 - Përfundimi kyç 1: Ofruesit e AFP-së partnerë ngrenë dhe/ose zgjerojnë dhe konsolidojnë më tej lidhjen e rrjetit 1 me 1 me sektorin privat dhe partnerët e tjerë.

Produkti 1.1: Ofruesit e AFP-së kanë mundësi të administrojnë dhe zgjerojnë rrjetet e bizneseve dhe partnerëve.

Produkti 1.2: Ofruesit e AFP-së kanë krijuar procese dhe instrument që shoqëritë dhe partnerët të japin kontribut për proceset kyçe të sigurimit të AFP-së.

Produkti 1.3: Ofruesit kanë një strategji sponsorizimi dhe kanë vënë në funksion modalitetet përkatëse.

Produkti 1.4: Pilotohet orientimi profesional për nxënësit e arsimit të përgjithshëm të detyrueshëm.

Linja e ndërhyrjes 2 - Përfundimi kyç 2: Ofruesit e AFP-së partnerë veprojnë si ofrues shumëfunksional dhe ofrojnë arsim dhe formim profesional të diversifikuar, pa dallim gjinor dhe të orientuar nga tregu i punës (si afatgjatë ashtu edhe afatshkurtër).

Produkti 2.1: Ofruesit partnerë janë të aftë të rishikojnë, përshtatin dhe zhvillojnë ofertën e tyre së bashku me rrjetin e tyre të partnerëve.

Produkti 2.2: Ofruesit e AFP-së kanë përshtatur paketat e trajnimit për të fuqizuar aftësitë sipërmarrëse dhe joprofesionale të studentëve/pjesëmarrësve në trajnim.

Produkti 2.3: Ofruesit kanë përshtatur veprimtari jashtëshkollore me në qendër studentin, që mbështesin zhvillimin e karrierës së studentëve.

Linja e ndërhyrjes 3 - Përfundimi kyç 3: Ofruesit partnerë zbatojnë mënyra të reja të nxëni dhe formimi që mëkojnë përfshirjen dhe përmbushin standardet e botës së punës.



Produkti 3.1: Partnerëve kompetentë shqiptarë u mundësohet të ofrojnë dhe të përmirësojnë më tej zhvillimin profesional në vazhdim (CPD) të mësuesve e instruktorëve të AFP-së dhe mentorëve në shoqëri, lidhur me pikëpamjet teknike dhe pedagogjike të NWoIL dhe t'i trajnojnë ata.

Produkti 3.2: Mësuesit e AFP-së dhe mentorët në shoqëri kanë procese dhe burime për zhvillimin e mëtejshëm të NWoIL në nivelin e praktikës së mësimit dhe të nxënës (përmbytje, plane mësimit, instrumente).

Produkti 3.3: Infrastruktura NWoIL është e disponueshme dhe funksionale tek ofruesit e AFP-së dhe ata kanë burime investimesh, mirëmbajtjeje dhe mbështetjeje për infrastrukturën NWoIL.

Produkti 3.4: Hartohet dhe vihet në funksion një model CPD për kompetencat teknike dhe profesionale dhe trajnohen mësuesit e ofruesve partnerë.

Linja e ndërrhyrjes 4 - Përfundimi kyç 4: Ofruesit e AFP-së partnerë dhe biznesi hartojnë dhe ofrojnë së bashku programe WBL (stazhe dhe praktika) bazuar në kuadrin e ILO dhe BE-së për stazhin cilësor.

Produkti 4.1: Bihet dakord, vihet në funksion dhe dokumentohet një model stazhi i përshtatur për industri të ndryshme.

Produkti 4.2: Ngrihet një sistem për sigurimin e cilësisë në sistemin publik të AFP-së për WBL e bazuar në shoqëri. Autoritetet kombëtare, ofruesit dhe shoqëritë kanë kapacitete për zbatimin e tij.

Produkti 4.3: Partnerët shqiptarë kompetentë kanë aftësinë të ofrojnë dhe zhvillojnë më tej zhvillimin profesional në vazhdim të udhëheqësve në shoqëri për stazhe/WBL. Trajnohen udhëheqësit në shoqëri.

Linja e ndërrhyrjes 5 - Përfundimi kyç 5: Strukturat, burimet dhe proceset e menaxhimit të ofruesve të AFP-së partnerë janë të përshtatshme dhe në punë për funksionet e reja.

Produkti 5.1: Ofruesit e AFP-së kanë mekanizma qeverisjeje (dhe instrumente) të konsoliduara që japin kontribut për cilësinë e përmirësuar të “shërbimeve”.

Produkti 5.2: Njësitë e zhvillimit janë funksionale në të gjithë ofruesit e AFP-së. Ato kanë kapacitete dhe ofrojnë shërbime me cilësi të mirë.

Produkti 5.3: Pilotohen modelet e futjes në tregun e punës.

Produkti 5.4: Partnerëve kompetentë shqiptarë u ofrohet mundësia për të zhvilluar më tej zhvillimin profesional në vazhdim për “udhëheqjen për AFP” dhe për të trajnuar personelin e ofruesve të AFP-së për të zbatuar “udhëheqjen për AFP-në”.

DEKRET

Nr. 13119, datë 28.6.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 78/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për projektin ‘Aftësi për punë’ faza 2, 2019–2023”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 59/2021

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 13
103, DATË 11.6.2021, “PËR KTHIMIN E
LIGJIT NR. 65/2021, ‘PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN
NR. 10 304, DATË 15.7.2010, ‘PËR
SEKTORIN MINERAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 13 103, datë 11.6.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 65/2021, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 304, datë



15.7.2010, 'Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 24.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor, në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe përballjen me sfidat e tij përmes një qasje të trefishtë ndërgjegjësuese, parandaluese dhe ndëshkuese;

Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura, për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;

Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2020 të Komisionit Evropian në lidhje me progresin e shënuar nga Inspektori, si dhe mbështetjen e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;

Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin me forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjitha kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre,

Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2020 në drejtim të:

- Progresit të shënuar në funksionimin tërësor institucional dhe në veçanti në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit të datës 28.5.2020 “Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2019”.

- Zbulimit të rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave private, duke administruar një numër total prej 3769 deklaratash të interesave private, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave, që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave private të 762 subjekteve deklaruese, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit 33 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 72 raste referimesh penale.

- Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë nëpërmjet angazhimit të pjesës më të madhe të kapaciteteve të tij institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional me organet e rivlerësimit kalimtar, duke përmbushur detyrat funksionale brenda afateve të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në fuqi të lidhura me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe përfunduar dhe dorëzuar dokumentacionin e plotë së bashku me raportet e hollësishme dhe të arsyetuara për pjesën e mbetur të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

- Konsolidimit të marrëdhënieve me organet e reja të sistemit të drejtësisë, si: KLGJ, KLP, ILD dhe SPAK, kryesisht në verifikimin brenda afateve ligjore të deklaratave të pasurive dhe interesave private për kandidatët për pozicione të ndryshme të këtyre organeve.

- Administrimit dhe analizimit të 386 raportimeve të dërguara nga njësitë përgjegjëse, nga të cilat 149 i përkasin sektorit publik dhe 237 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive, sipas kompetencave që i janë caktuar Inspektoratit në



dispozitat e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Megjithatë, nga të dhënat rezulton se 222 njësi përgjegjëse, ku 19 i përkasin sektorit privat, nuk kanë paraqitur raportet vjetore në zbatim të parashikimeve të neneve 13 dhe 22 të ligjit të sipërpërmendur.

- Regjistrimit dhe trajtimit në zbatim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, të 9 rasteve sinjalizimi dhe 1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, duke aplikuar në përfundim të hetimit administrativ 1 masë administrative “gjobë” ndaj një titullari institucioni për shkelje të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe zgjidhjen e një rasti me konflikt interesi.

- Vijimit të procesit të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit të interesave private me angazhimin maksimal nga ana e institucionit për vendosjen në funksionalitet të plotë brenda vitit 2021.

- Bashkëpunimit me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në kuadër të projektit “Fuqizimi i pushtetit vendor për zbatimin e ligjit për sinjalizimin”, duke marrë pjesë dhe duke dhënë ekspertizën e nevojshme në 10 sesione trajnuese dhe trajnimin e 163 anëtarë të njërive përgjegjëse dhe nëpunës pranë bashkive.

- Angazhimit të mëtijshëm për përmirësimin e kanaleve të raportimit të sinjalizimeve dhe mekanizmat e mbrojtjes për sinjalizuesit nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Iniciativën Rajonale Antikorrupsion (RAI) të financuar nga BE-ja.

- Intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet kryesore brenda vendit, që kanë fushë të përgjegjësisë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe parandalimin e pastrimit të parave.

- Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore 6182 kërkesa të publikut për publikimin e deklaratave të interesave private.

Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2021 të vazhdojë punën në këto drejtime:

- Të forcojë më tej bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet e rivlerësimit dhe

ONM-në deri në përfundim të procesit të rivlerësimit nga këto organe, si dhe të vijojë mbështetjen e proceseve për verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë në një kohë sa më të shpejtë.

- Të angazhohet në përputhje me rekomandimet e progresraportit të KE-së dhe GRECO-s për përfundimin dhe vënien në funksionalitet të plotë brenda vitit 2021 të sistemit elektronik të deklarimit të interesave private, që do të kontribuojë drejtpërdrejt në forcimin e besueshmërisë së institucionit.

- Të intensifikojë trajnimet e stafit në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative dhe investiguese, për të qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit të institucionit.

- Të vijojë angazhimin në drejtim të rritjes së kapaciteteve të njërive përgjegjëse të ngritura në sektorin publik dhe privat në kuadër të zbatimit të ligjit për sinjalizimin, me qëllim ndërgjegjësimin për raportimin e praktikave të dyshuara të korrupsionit, përmes trajnimit të rregullt dhe informimit të anëtarëve të këtyre njësive. Në këtë drejtim t'i jepet prioritet bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit, në adresimin e nevojave të tyre për trajnim e ndërgjegjësim në përputhje me rekomandimet e lëna nga GRECO.

- Të forcohet bashkëpunimi mes ILDKPKI-së dhe SPAK-ut për të përmirësuar në mënyrë të efektshme ndjekjen e çështjeve të adresuara në prokurori nga ILDKPKI-ja në kuadër të refuzimit për deklarimin, mosdeklarimin, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose të çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim, veçanërisht për persona të cilëve u janë ngarkuar funksione të larta ekzekutive.

- Bashkëpunimin e mëtijshëm dhe dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzime specifike, këshilla dhe trajnime për zbatimin e duhur të kuadrit ligjor për parandalimin e konfliktit të interesave, veçanërisht për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse në evidentimin e deklaratimeve rast pas rasti, të cilat nga raportet e organizmave ndërkombëtarë nuk zbatohen.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miruar në datën 24.6.2021.



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2020

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për veprimtarinë e vitit 2020 dhe duke mbajtur në konsideratë:

- angazhimin e KQZ-së në lidhje me organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve;

monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet;

- nxjerrjen e akteve nënligjore, pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, të kryera në tetor të vitit 2020,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020, në drejtim të:

Hartimit të programit të punës për vitet 2020 dhe 2021, me qëllim planifikimin e aktiviteteve që i paraprijnë organizimit të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 prill 2021.

Nxjerrjes së konkluzioneve dhe përditësimit të të dhënave për shtetasit që kanë qenë pjesë e administratës zgjedhore ndër vite.

Miratimit të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator” nëpërmjet vendimit nr. 1, datë 26.10.2020.

Miratimit të rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 6.11.2020.

Kryerjes së procedurave për ndryshimin e strukturës dhe organigramës së KQZ-së.

Përmbushjes së detyrimit ligjor për subjektet deklaruese të pasurisë për zyrtarët që janë larguar nga funksioni dhe zyrtarët që deklarojnë para fillimit të detyrës.

Procese të kryera për verifikimin e shpenzimeve të financimeve të partive politike dhe fushatave elektorale, si dhe hedhjen e tyre në faqen zyrtare të KQZ-së.

Rishikimit të buxhetit të vitit 2020 nëpërmjet aktit normativ nr. 15, datë 15.4.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”.

Miratimit të vendimeve në 6-mujorin e parë të vitit 2020, si dhe akteve nënligjore gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2020.

Shqyrtimit të rezultateve të verifikimit të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

Kryerjes së aktiviteteve në nivel lokal në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, mbështetje me ekspertizë të huaj, si dhe organizimin e seminareve për ngritjen e kapaciteteve të administratës së KQZ-së.

Procesit të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.6.2019, me vendimin nr. 4, datë 21.2.2020 të KQZ-së.

Përgatitjes infrastrukture zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.4.2021.

Kuvendi kërkon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të miratohet Kodi Etik i institucionit në funksion edhe të përcaktimit të rregullave të përfaqësimit në publik të institucionit dhe të daljeve publike të anëtarëve të KQZ-së, në përputhje me Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, të miratuar me vendim Kuvendi, brenda vitit 2021.

2. Të paraqesë pranë Kuvendit një raport të detajuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për zgjedhjet e datës 25.4.2021 lidhur me shqyrtimet dhe zgjidhjet që u janë dhënë në rrugë administrative ankesave ndaj akteve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve; shqyrtimet dhe zgjidhjet që u janë dhënë në rrugë administrative ankesave të subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ve; masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit aposteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim; mbi sanksionet administrative të vendosura kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet; roli i KAS-it dhe Komisionit Rregullator në raport me çështjet e mësipërme deri te vendimet e dhëna nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor për këto çështje.

3. T’i vihet në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë raporti analitik për gjetjet dhe efektshmërinë e përdorimit të teknologjisë në tërësi, të përdorur ditën e zgjedhjeve, datë 25.4.2021, si dhe në ditët në vijim lidhur me procesin e votimit, numërimit elektronik,



mbarëvajtjen e mbikëqyrjes së procesit të votimit dhe numërimit nëpërmjet sistemit të kamerave, identifikimit elektronik të qytetarëve, etj.

4. KQZ-ja të vijojë procedurat për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e procesit për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, si dhe nenit 20, shkronja “ç”, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, “Zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin.”.

5. KQZ-ja të paraqesë pranë Kuvendit raportin e auditimit të kryer për raportimin financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 për Kuvendin e Shqipërisë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 24.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rolin e institucionit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomikitet, eficiencë dhe efikasitet të fondeve

publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikën më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI,

Vlerëson veprimtarinë e KLSH-së për vitin 2020 në drejtim të:

- Angazhimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për zhvillimin normal të veprimtarisë së institucionit, edhe pse në kushte të vështira të krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19, i cili është pasqyruar në përfundimin e 73 auditimeve, të ushtruara në 91 subjekte në nivel vendor dhe qendror.

- Adresimit të një numri total prej 1430 rekomandimesh të dhëna për institucionet publike të audituara, nga të cilat: 29 janë propozime për përmirësime ligjore, 1107 masa organizative dhe 294 rekomandime për masa disiplinore dhe administrative.

- Vijimit të punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, me një dëm efektiv të përgjithshëm në shumën rreth 88 miliard lekë dhe ku shkeljet më të mëdha janë në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore dhe prokurimin publik.

- Intensifikimin e veprimtarisë së zbulimit dhe ndëshkimit të korrupsionit, duke paraqitur pranë organit të prokurorisë 8 kallëzime ose indicie penale për 12 drejtues të nivelit të lartë, të mesëm dhe specialist të administratës publike.

- Angazhimit maksimal në të qenit aktiv dhe produktiv në luftën kundër korrupsionit, duke përkrahur, mbështetur dhe duke u angazhuar në çdo iniciativë ndër-institucionale brenda dhe jashtë vendit, si dhe në ndjekjen e 95 proceseve gjyqësore, nga ku rezulton se gjykatat e shkallës së parë në 21 vendime të dhëna kanë konfirmuar rekomandimet e gjetura nga KLSH-ja në auditimet e zhvilluara.

- Miratimit të disa manualeve dhe rregulloreve të rëndësishme, ku përmenden Manuali i Auditimit Financiar, Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, Manuali i Auditimit të Performancës, në frymën e standardeve të INTOSAI-t “Korniza e standardeve profesionale INTOSAI”, Manualin e Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve, si dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit.

- Fuqizimit të rolit të KLSH-së në medien e shkruar nëpërmjet publikimit të 925 artikujve, si dhe rritjes së besueshmërisë së publikut nëpërmjet trajtimit të 301 letrave dhe ankesave, nga të cilat



pjesa kryesore u adresohet problematikave që lidhen me privatizimin dhe kthimin e pronës, administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik.

- Modernizimit të aktivitetit auditues dhe trajnimit të audituesve të KLSH-së, të cilët në fund të vitit 2020 rezultojnë se kanë siguruar një mesatare prej 28.5 ditësh trajnimit/auditues, një nivel i lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite që nga krijimi i tij.

- Intensifikimit të bashkëpunimit me organizma dhe institucione homologe, si: Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), Zyrën e Auditimit Qeveritar të SHBA-së (GAO), Zyrën e Bashkimit Evropian në Shqipëri, USAID-in etj.

Kuvendi kërkon që KLSH-ja për vitin 2021 të vazhdojë punën në këto drejtime:

- Të rrisë numrin e auditimeve financiare, të përmirësojë cilësinë e tyre me opinione profesionale dhe të kualifikuara kontrolli, në plotësim të kërkesave të progresraportit të Komisionit Evropian.

- Të krijojë një qasje të auditimeve të performancës drejt fushave me ndjeshmëri publike duke synuar që rezultatet e auditimit të 3E-ve të kenë ndikim direkt në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

- Të evidentojë fushat e pambuluara me auditim nga KLSH-ja në vite, si dhe të planifikojë veprimtarinë audituese të tyre për një qasje të pakufizuar dhe të pavarur në auditimin e institucioneve, organizatave që janë përdorues të fondeve publike.

- Të aplikojë praktikat më të mira të auditimit të teknologjisë së informacionit, në përputhje të plotë me standardet INTOSAI, të përditësojë informacionin e subjekteve të audituara dhe projekteve të rëndësishme të qeverisjes elektronike, duke mbajtur në konsideratë raportin kosto/përfitim të këtyre projekteve dhe sigurinë e këtyre sistemeve.

- Të përmirësojë cilësinë e raporteve të auditimit, si dhe të forcojë kapacitetet profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të auditimit.

- Të angazhohet për hartimin e një memorandumit mirëkuptimi me Kuvendin, me qëllim referimin e gjetjeve të auditimit në funksion të kontrollit parlamentar dhe rritjes së

llogaridhënies publike, në zbatim të rekomandimit të progresraportit të Komisionit Evropian, kapitulli 32 “Kontrolli financiar”.

- Të rrisë transparencën duke mundësuar zhvillimin e një komunikimi interaktiv me qytetarin nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ku të publikohen vendimet dhe raportet e plota të auditimeve, sipas afateve të përcaktuara në ligj dhe të rekomanduara nga KE-ja.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 24.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke vlerësuar që reagimi i OSHMA-ve ka qenë i menjëhershëm dhe efikas në zbatim të kërkesave ligjore për rastin e pandemisë së COVID-19, duke përcjellë disa herë në ditë mesazhet e përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Duke vlerësuar se finalizimi me sukses i procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë ka sjellë shërbim më cilësor dhe numër më të madh kanalesh pa pagesë për qytetarët;

Duke vlerësuar se finalizimi me sukses i procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë i ka hapur rrugën futjes së teknologjive të reja në fushën mobile, ofrimit të shërbimeve të reja inovative, me cilësi më të lartë për qytetarët,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në këto drejtime:

- Punën e bërë nga AMA gjatë pandemisë së COVID-19 për nxitjen dhe ndërgjegjësimin e OSHMA-ve, që të ishin bashkëpunuese me autoritetin shëndetësor publik në transmetimin e mesazheve informuese për qytetarët dhe



institucionet, të nevojshme për parandalimin e përhapjes së koronavirusit.

- Reagimin e OSHMA-ve, i cili qenë i menjëhershëm dhe efikas në zbatim të kërkesave ligjore për rastin e pandemisë së COVID-19, duke përcjellë disa herë në ditë mesazhet e përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në të njëjtë kohë thekson faktin që pandemia globale COVID-19 ka ndikuar në performancën e OSHMA-ve, duke dhënë efekte në strukturën dhe katalogun e përmbajtjeve të emetuara; në burimet njerëzore të angazhuara, në treguesit ekonomikë dhe financiarë, ku u reduktuan ndjeshëm të ardhurat nga reklamat dhe promocioni etj.

- Punën e bërë nga AMA në ndjekjen dhe verifikimin në terren të situatës lidhur me problematikat e shfaqura të shtrimit të infrastrukturën numerike, pajisjes së qytetarëve me dekodera, si dhe situatës së pandemisë nga COVID-19, problematika të cilat çuan në shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan deri më 30 shtator 2020. Në përfundim i gjithë procesi u mbyll me sukses më 30 shtator për të katër këto qarqe.

- Punën e bërë nga AMA për fushatën e informimit të qytetarëve, si dhe të ndjekjes dhe verifikimit në terren të situatës për mbylljen e sinjalit analog edhe në tri qarqet e mbetura të vendit, konkretisht: Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë.

- Bërjen pjesë të buketës programore të RTSH-së kanalën RTSH SHKOLLË si nevojë e detyrueshme e aplikimit të formateve të mësimdhënies në distancë dhe që i erdhi në ndihmë sistemit parauniversitar në rrethanat e krijuara nga efektet e pandemisë COVID -19 në sistemin arsimor të vendit tonë. Në të njëjtën kohë ky kanal për vetë natyrën e përmbajtjes së programeve të transmetuara, si dhe grup-moshës që i drejtohet, ka edhe atributet e një kanali të dytë për fëmijët.

- Nënshkrimin e disa marrëveshjeve të bashkëpunimit mes AMA-s dhe institucioneve të tjera, duke forcuar bashkëpunimin ndër-institucional, me qëllim garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e shërbimeve audiovizive, si dhe respektimin, promovimin e të drejtave të fëmijëve në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:

1. Pas finalizimit me sukses të procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë, AMA të ndjekë në vijim shqetësimet e operatorëve lokalë, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të duhura të problematikave të ngritura nga operatorë lokalë.

2. Të japë kontributin e saj në procesin e transpozimit në legjislacionin kombëtar të Direktivës së BE-së 2010/13/BE “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, e cila ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. Këto ndryshime, ndër të tjera, synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve, rregulla të reja për platformat *online*, ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare.

3. Të vijojë të luajë një rol proaktiv dhe nxitës në arritjen e përmirësimit dhe të forcimit të mbrojtjes së të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve në sektorin audio dhe audioviziv, si një çështje e rëndësishme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias, e cila nënvizohet edhe në raportin e progresit të KE-së.

4. Të ndjekë me ministritë përgjegjëse dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë zgjidhjen e problemit të mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave, dhe në të njëjtën kohë të kërkojë zbatimin e detyrimit ligjor për transmetimet me bazë gjuhën e shenjave nga operatorët audiovizivë me licencë kombëtare, si një detyrim që garanton të drejtën e informimit të komuniteteve me nevoja të veçanta shqisore.

5. Të japë kontributin e saj konkret në përafrimin me standardet ndërkombëtare të kërkesave ligjore për transparencën e pronësisë mbi mediat, financimin e mediave dhe kufizimet e tyre, problematika të cilat theksohen edhe në raportin e progresit të KE-së.

6. Të jetë pjesë aktive përmes propozimeve konkrete në diskutimet për ndryshimet ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si për sa i takon krijimit të një kuadri rregullator për mediat *online* si një realitet i ri në në industrinë medietikë, ashtu edhe të adresimit të opinionit të Komisionit



të Venecies për të bërë të mundur që këto ndryshime të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias.

7. Të punojë për zbatimin e rekomandimeve të papërmblushura të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në mënyrë të veçantë rekomandimin lidhur me operacionet IT (*help desk*) për shërbimet e brendshme dhe të jashtme në fushën e sigurisë.

8. Të vijojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes AMA-s dhe AKEP-it për parandalimin dhe/ose ndalimin e piraterisë audiovizive *online*, duke pasur parasysh edhe realitetin e ri kur mediat, bazuar në internet, kanë një zhvillim të pandaluar dhe efekt të jashtëzakonshëm në industrinë mediatike,

9. Të japë kontributin e saj duke luajtur një rol proaktiv në përmirësimin e legjislacionit për reklamën publike për të bërë të mundur rritjen e transparencës në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, kërkesë e cila theksohet edhe në raportin e progresit të KE-së.

10. AMA të luajë një rol nxitës dhe proaktiv në bashkëpunim me aktorët dhe faktorët përkatës duke bërë të mundur përmirësimet e nevojshme ligjore për një proces vetërregullimi, shqetësim i cili theksohet edhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturuar në datën 24.6.2021.

VENDIM

Nr. 384, datë 30.6.2021

PËR FORMËN E KOMUNIKIMIT NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK³

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në procedurat e prokurimit “Dialog konkurrues”, “Partneritet për inovacion”, “Konkurrese me negocim” dhe “Konkurs projektimi”, fazat vijuese, pas fazës së parakualifikimit, zhvillohen në formë shkresore.

2. Ngarkohen të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 385, datë 30.6.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ZHVENDOSJEN (EVAKUIMIN), SHMANGIEN DHE RISISTEMIMIN E DOKUMENTEVE NË KOHË TË VEÇANTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 93, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

³ Ky projektvendim është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2014/18/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 65–242;

- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0025, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 94, datë 28.3.2014, faqe 243–374.



VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për zhvendosjen (evakuimin), shmangien dhe risistemimin e dokumenteve në kohë të veçantë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, institucionet dhe struktura qendrore e mbrojtjes civile, institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile, strukturat operationale të mbrojtjes civile dhe të gjitha institucionet qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE
PËR ZHVENDOSJEN (EVAKUIMIN),
SHMANGIEN DHE RISISTEMIMIN E
DOKUMENTEVE NË KOHË TË VEÇANTË

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të zhvendosjes (evakuimit), të shmangies dhe të risistemimit të dokumenteve në kohë të veçantë, për të ruajtur trashëgiminë kulturore dokumentare të rrjetit arkivor kombëtar.

Neni 2
Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat e posaçme që duhet të ndjekë Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si kryesuesi i rrjetit arkivor, si dhe të gjitha arkivat dhe sekretari-arkivat në Republikën e Shqipërisë, në situatat e dëmtimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, si dhe në situatat e kohëve të veçanta.

Neni 3
Përkufizime

1. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Arkiv i përhershëm” është çdo arkiv që nuk është sekretari-arkiv në veprim, si dhe institucionet e posaçme që ruajnë dokumentacionin gjithnjë pranë tyre, sipas listës së përpiluar nga Këshilli i Lartë i Arkivave.

b) “Baza e të dhënave të fondkrijuesit” është një bazë të dhënash që krijohet dhe mirëmbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për efekt përdorimi të brendshëm nga ana e saj.

c) “Dokument i parestaurueshëm” është ai dokument që pas këqyrjes nga specialistët, sipas procedurave të kësaj rregulloreje, vlerësohet se nuk ka asnjë formë apo teknikë që mund ta bëjë as pjesërisht të lexueshëm ose kuptueshëm.

ç) “Kohë e veçantë” është tërësia e rasteve kur me një akt, sipas legjislacionit në fuqi, është shpallur gjendja e luftës, gjendja e jashtëzakonshme, gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësive të tjera, si dhe çdo rast tjetër kur dokumentacioni arkivor mund të dëmtohet, kompromentohet ose shkatërrohet, nga faktorë jonjerëzorë, si përmytja, lagështia e lartë, zjarri etj.

d) “Personat përgjegjës të arkivave” janë:

i. titullarët për arkivat e përhershëm;

ii. drejtuesi teknik për arkivat privatë;

iii. drejtuesi i strukturës më të lartë përgjegjëse të drejtpërdrejtë për arkivin në institucionet fondkrijuese, sipas rastit drejtori i arkivit/sekretari-arkivit ose përgjegjësi i sektorit të sekretari-arkivit, ose specialisti i sekretari-arkivit, ose punonjësi i ngarkuar me detyrat e sekretari-arkivit, ose në mungesë të tyre titullari i institucionit.

dh) “Personi i kontaktit i DPA-së” është inspektori përgjegjës i ngarkuar nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me ndjekjen e komunikimit me fondkrijuesin përkatës.

e) “Restaurimi i dokumenteve” është procesi teknik, kimik dhe profesional i ndërhyrjes në një dokument të dëmtuar, me qëllim rikthimin e tij në një formë sa më të ngjashme me origjinalin.

ë) “Rrezik akut” është rreziku i dëmtimit të menjëhershëm të dokumenteve në kohë të veçantë.

f) “Shmangie e dokumenteve” është shmangia e dokumenteve nga një mjedis i institucionit që është në kushtet e një rreziku akut ose të parashikueshëm, në një mjedis tjetër brenda të njëjtë institucion.

g) “Zhvendosje e menjëhershme” është zhvendosja e dokumenteve arkivore në kushtet e



një rreziku akut ndaj tyre, që kryhet sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.

gj) “Zhvendosje e organizuar” është zhvendosja e dokumenteve arkivore, sipas një plani të paracaktuar, sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 4 Plani i masave

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave harton planin e masave për evakuimin e dokumenteve në administrim, në rastet e kohëve të veçanta.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave miraton planin e masave të evakuimit të dokumenteve të rrjetit arkivor kombëtar, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

3. Me qëllim përgatitjen e infrastrukturës për zhvendosjen (shmangien), evakuimin dhe risistemimin e dokumenteve, arkivat e përhershëm dhe fondkrijuesit njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave sa herë ka ndryshime të personave përgjegjës për arkivin në institucionet e tyre.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ua përcjell të dhënat që përmban baza e të dhënave të fondkrijuesve, personave përgjegjës të fondkrijuesit, përmes personave të kontaktit, sa herë njoftohet për ndryshimin e personit përgjegjës. Personat përgjegjës lajmërojnë personin e kontaktit mbi çdo ndryshim në bazën e të dhënave të fondkrijuesit.

Neni 5 Evidentimi i rrezikut dhe lajmërimi

1. Arkivat e përhershëm dhe fondkrijuesit, përveç procedurave të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen civile, zbatojnë urdhrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për evakuimin dhe/ose shmangien e dokumentacionit arkivor, në kushtet kur nuk është situatë emergjence civile ose pas miratimit nga strukturat e mbrojtjes civile në kushtet e emergjencës civile, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

2. Në rastet kur evidentohet dëmtimi i materialit arkivor ose rrezik i dëmtimit të materialit arkivor, personat përgjegjës të arkivave lajmërojnë menjëherë personin e kontaktit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe, në rastet kur

vlerësojnë të nevojshme, edhe strukturat e mbrojtjes civile.

3. Personi i kontaktit evidenton situatën, jep udhëzimet e para në bazë të normave tekniko-profesionale dhe njofton menjëherë strukturat eprorë.

Neni 6 Shmangia dhe restaurimi i dokumentacionit arkivor

1. Nëse dëmi i shkaktuar është si pasojë e përmbajtjeve, lagështirës ose zjarrit dhe ekziston mundësia e shmangies së menjëhershme të dokumentacionit arkivor brenda së njëjtës ndërtesë, personi i kontaktit urdhëron fondkrijuesin për shmangien e dokumentacionit arkivor. Ky urdhër është i zbatueshëm vetëm nëse situata nuk ka kërkuar ndërhyrjen e forcave të mbrojtjes civile, ose pas lejimit të forcave të mbrojtjes civile.

2. Në varësi të situatës, drejtori i përgjithshëm i Arkivave ngre grup pune për shqyrtimin e mundësisë së restaurimit të dokumentacionit të dëmtuar. Grupi i punës përmban së paku një restaurator dhe personin e kontaktit.

3. Grupi i punës jep udhëzimet, në vend, për punën që duhet të kryhet për restaurimin e paspecializuar (ulje e sasisë së lagështisë, pastrimi i pjesës së karbonizuar etj.) dhe dokumenton veprimet e veta përmes një procesverbali.

4. Grupi i punës përgatit raportin përfundimtar jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga ngjarja, ku përcakton materialin e parestaurueshëm dhe materialin që ka nevojë për restaurim.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave mund të urdhërojë asgjësimin e materialit të parestaurueshëm me anë të një komisioni të përbërë nga grupi i punës, personi përgjegjës i arkivit dhe dy përfaqësues të tjerë të fondkrijuesit, nën drejtimin e titullarit të fondkrijuesit.

6. Nëse materiali i parestaurueshëm ka qenë dokumentacion me rëndësi historike kombëtare, përpara asgjësimit, duhet të njoftohen organet e rendit publik dhe prokuroria për këqyrjen e tij.

7. Dokumentacioni i restaurueshëm tërhiqet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave dhe restaurohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave me kostot e mbuluara nga fondkrijuesi, sipas tarifave të miratuara.



Neni 7

Zhvendosja e dokumentacionit arkivor

1. Në rastet e rrezikut akut të dëmtimit të dokumentacionit arkivor, në situata në të cilat nuk nevojitet ende ndërhyrja e forcave të mbrojtjes civile, drejtori i përgjithshëm i Arkivave urdhëron zhvendosjen e menjëhershme të dokumentacionit arkivor në mjedise të posaçme magazinimi të përcaktuara paraprakisht në planin e masave sipas nenit 4, të kësaj rregulloreje. Zhvendosja mund të kryhet vetëm pas lejitimit nga strukturat operationale të mbrojtjes civile, nëse ato kanë ndërhyrë. Zhvendosja kryhet me mjetet e strukturave të mbrojtjes civile, me mjetet e fondkrijuesit ose me mjete të tjera. Në çdo rast, dokumentacioni shoqërohet nga personi i kontaktit, personi përgjegjës i arkivave dhe një përfaqësues i fondkrijuesit, nën shoqërimin e Policisë së Shtetit. Pasi dokumentacioni arkivor është dërguar në mjedisin e paracaktuar, kryhet riinventarizimi i tij dhe nënshkruhet procesverbali përkatës.

2. Në rastet e rrezikut të dukshëm të dëmtimit të dokumentacionit arkivor, por që nuk kërkon ndërhyrje akute, drejtori i përgjithshëm i Arkivave urdhëron zhvendosjen e organizuar të dokumentacionit arkivor. Në këtë rast, fondkrijuesi dhe personi i kontaktit kontrollojnë dokumentacionin me inventarët që ekzistojnë, e evidentojnë atë në nivel të njësisë së ruajtjes dhe përpilojnë procesverbalin përkatës. Më pas, e shoqërojnë dokumentacionin në mjedisin e paracaktuar.

3. Dokumentacioni qëndron në mjediset e paracaktuara, deri në stabilizimin e situatës dhe rikrijimin e kushteve të nevojshme për kthimin e dokumentacionit arkivor te fondkrijuesi. Kthimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave.

Neni 8

Procedurat e veprimit në rastet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore

1. Në rastet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave i propozon masa konkrete Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile për shmangien dhe/ose zhvendosjen e dokumentacionit arkivor, përfshi të gjitha mundësitë e zhvendosjes, burimet njerëzore

dhe/ose mjetet e nevojshme për këtë operacion, që nuk ka mundësi t'i përballojë vetë.

2. Arkivat e përhershme hartojnë listën e vendruajtjeve, sipas rëndësisë së tyre, që duhet të evakuohen më shpejt.

3. Në rastet kur vlerëson se është i domosdoshëm evakuimi i dokumentacionit arkivor të arkivave të përhershëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave njofton menjëherë strukturat e mbrojtjes civile dhe Policinë e Shtetit, duke evidentuar burimet njerëzore dhe mjetet e nevojshme për evakuim dhe listën e vendruajtjeve, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Me shpalljen e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësisë natyrore dhe të aksidentit teknologjik, gjithë personeli që administron dokumentet arkivore ndjek situatën dhe dorëzon dokumentet, sipas planit të evakuimit.

5. Strukturat e ngarkuara për evakuimin marrin masa për sistemimin e dokumenteve në arka metalike. Në kapakun e çdo arke të vendoset:

a) struktura fondkrijuese;

b) viti i krijimit të këtij fondi;

c) niveli më i lartë i informacionit që ndodhet në arkë.

6. Transportimi i dokumenteve dhe i pajisjeve, nga vendi i grumbullimit për në vendet e caktuara për ruajtje, bëhet me mjetet e planifikuara dhe i shoqëruar me roje të armatosura.

Neni 9

Risistemimi

1. Në përfundim të situatës së dëmtimit, apo situatës së emergjencës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave llogarit në bazë të normave të punës, kohën dhe personelin e nevojshëm për risistemimin e dokumentacionit.

2. Arkivi i përhershëm ose fondkrijuesi marrin masa për risistemimin e dokumentacionit sipas llogaritjes së kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Nëse nevojitet më shumë se 10 për qind e personelit të fondkrijuesit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave vendos në dispozicion të fondkrijuesit numrin e punonjësve që ka mundësi të angazhojë në këtë proces. Nëse numri i nevojshëm është më i lartë se sa kapacitetet e fondkrijuesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, fondkrijuesi i kërkon ministrisë përgjegjëse për financat punonjës me kontratë të



përkohshme, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për punonjësit me kontratë në administratën shtetërore dhe në Kodin e Punës.

3. Procesi i risistemimit ndiqet periodikisht dhe konfirmohet nga personi i kontaktit me personin përgjegjës të arkivit.

VENDIM

Nr. 386, datë 30.6.2021

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË LIBRAZH, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE LIBRAZH, TË PASURISË 8/73, ZONA KADASTRALE 2446, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1086, DATË 28.10.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LIBRAZH, TË QARKUT TË ELBASANIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Librazhd, për njësinë administrative Librazhd, të pasurisë 8/73, me vendndodhje në zonën kadastrale 2446, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë, planrilevimit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, me qëllim për t’u përdorur në fushën e administratës vendore.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, të miratuar me vendimin nr. 1086, datë 28.10.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Librazhd, të Qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Bashkia Librazhd dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME (Per inventarizimin e pronave te vecanta)										
Institucioni i Pushtetit Qendror _____ Bashkia/Njësia : Librazhd Fusha e përdorimit të pronës : Administrata vendore				Identifikol: Bashkim Muraçi (specialist) Supervizol: Brixhilda Biçaku (Arkitekt) Aprovol: Kastriot Gurra (Kryetar i Bashkisë Librazhd)						
Nr	A			B			C			
	Zona kadastrale & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m2)	Nga sip. Totale: Sa Ndertesa (m2)	Funkcioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues - Statusi i Juridiks i përdorimit	Te dhëna tjera (Shënime të tjera)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2446 LB -F -3	8/73.	Truall + ndertese	Ish depo e pllakave te Komunales	60.7	60.7	Ambiente ndihmese	Bashkia Librazhd	Bashkia Librazhd	Objekti ndertese ish depo e pllakave te ish ndermarrjes Komunale Librazhd me S= 60.7 m2 ka mbetur e paregjistruar ne inventarin e pasurive te paluajtshme te Bashkise Librazhd



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET DATE 22/01/2021 QELLIM I: TRANSFERIM PRONE

VENDODHJA BASHKIA LIBRAZHID	DVASHKIZVASHK LIBRAZHID	ZONA KADASTRALE 2446	NUMRI I PASURISE 8/73	INDEX HARTE LB F-3
TE DHENAT E PASURISE (ISH MAGAZINA E PLLAKAVE TE NDERMARRJES KOMUNALE LIBRAZHID)				
LLQJ I PASURISE: TRUALL + NDERTESE	SIP.PASURISE=60.7 m2	SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=60.7 m2	NUMRI I KATEVE: 1	NUMRI I PEMEVE: _____

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 526114.69, Y 4560501.85 X 526213.25, Y 4560501.85

SH 1:500

X 526114.69, Y 4560424.01 X 526213.25, Y 4560424.01

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			8/625	SHTETI	
2	JUG			8/625	SHTETI	
3	LINDJE			8/625	SHTETI	
4	PERENDIM			8/625	SHTETI	

REALIZOI PER BASHKINE LIBRAZHID

ING.BASHKIM MURACI

NENSHKRIMI:

DATE: _____

KONFIRMOI

DREJTORESHE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

BRDXHILDA BICAKU

NENSHKRIMI:

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISE LIBRAZHID

KASTRIOTI GURRA

NENSHKRIMI:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: "Z"

Kode per teknologjine e matjeve: T-Teren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash

PERCAKTIMI I KUFIRIT: "HK"

Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronave; K-Kufitare te Gjithe; KP-Kufitare Pjeserisht; GP-Prona e Bashkise; HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VEKANCANTA

PRONARIBASHKISE PRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET


NENSHKRIMI:



Miratohet
Kryetari i Bashkisë



PLANIMETRI E ISH MAGAZINES SE PLLAKAVE TE KOMUNALES LIBRAZH
SH 1 : 100



Shtime teknike:

- Nr. kateve 1 (nje)
- Sip. e objektit $S_n = 60.7m^2$
- Objekt me mure tullie te plota
- Mbulim me etarnit

PREGATITEN : GRUPI I PUNES
Ing. Asirë POP JA
Ing. Afërdita KOÇI
Shaban Qelja

[Signatures]

**VENDIM****Nr. 388, datë 30.6.2021**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT, SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA:

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”:

Mohammad Ali al Habbo

Shënim. Gjenealogjet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM**Nr. 401, datë 30.6.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË
HOLLËSISHME PËR MIRATIMIN DHE
KOMPETENCAT E TRUPAVE
CERTIFIKUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET**

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret e hollësishme për miratimin dhe kompetencat e trupave certifikuese, që do të kryejnë procesin e verifikimit të përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara, si: EOM, TGJM dhe STG me specifikimet përkatëse.

2. Përveç përkufizimeve të parashikuara në ligjin nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Komision”, komisioni për miratimin dhe auditimin e trupave certifikuese (KMATC);

b) “Ligj” i referohet ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”;

c) “Trupë certifikuese”, ka kuptimin referuar nenit 23, të ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”.

II. KRITERE TË PËRGJITHSHME

1. Trupa certifikuese e akredituar që paraqet kërkesën për miratim, referuar pikës 2, të nenit 23, të ligjit, siguron dëshmi dhe informacion lidhur me:

a) certifikatën e akreditimit, që konfirmon përputhshmërinë me kërkesat e ISO/IEC 17065, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve



bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si EOM, TGJM dhe STG;

b) statusin ligjor, qëllimin e aktivitetit dhe organigramën;

c) procedurat e detajuara për verifikimin e sistemit të përputhshmërisë për produktet bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM;

ç) paanshmërinë dhe lirinë nga çdo konflikt interesi lidhur me ushtrimin e detyrave që i janë ngarkuar;

d) fushën e akreditimit dhe fushën për të cilën kërkon miratim;

dh) adresën dhe kontakte të sakta.

2. Trupa certifikuese duhet të provojë që inspektorët nuk kryejnë më shumë se 3 (tri) inspektime rresht tek i njëjti prodhues.

III. KRITERE PËR BURIMET NJERË-ZORE

1. Kualifikimet minimale të inspektorëve të trupave certifikuese janë, si më poshtë vijon:

a) arsim i mesëm i lartë, ose i lartë në bujqësi, ose arsim i lartë në teknologji ushqimore;

b) të paktën 2 (dy) vjet, në 5 (pesë) vitet e fundit, eksperiencë profesionale në fushën e kontrollit të prodhimit bujqësor ose ushqimor përkatës;

c) trajnime për kryerjen e inspektimeve të kontrollit në fushën e bujqësisë ose të procesit të prodhimit ushqimor përkatës;

ç) kurse dhe trajnime lidhur me produktet tradicionale bujqësore ose ushqimore.

2. Një trupë certifikuese mund të vendosë kërkesat e veta kualifikuese për stafin e saj, duke siguruar që ato të mos jenë më të ulëta se kriteret minimale të vendosura në pikën 1, të këtij kreu dhe që plotësojnë kërkesat e ISO/IEC 17065.

3. Kërkesat sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, duhet të jenë të dokumentuara.

IV. PËRMBAJTJA/TË DHËNAT E CERTIFIKATËS SË CILËSISË

1. Certifikata e cilësisë e lëshuar nga trupa certifikuese përmban informacion shtesë lidhur me:

a) numrin e identifikimit dhënë trupës certifikuese gjatë procesit të miratimit nga KMATC-ja;

b) numrin e certifikatës dhënë operatorit ushqimor.

V. KOMPETENCAT E TRUPAVE CERTIFIKUESE

1. Trupa certifikuese kryen verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara, si: STG, EOM dhe TGJM, me specifikimet përkatëse të produkteve para vendosjes së tyre në treg, referuar pikës 1, të neneve 22 e 23, të ligjit.

2. Trupa certifikuese lëshon certifikatën e cilësisë, që konfirmon përputhshmërinë e produkteve bujqësore apo ushqimore me specifikimet, referuar pikës 4, të nenit 26, të ligjit.

3. Trupa certifikuese, gjatë çdo inspektimi, merr informacion nga prodhuesi lidhur me vëllimin e vlerësuar të prodhimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikatës.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 403, datë 30.6.2021

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE SPECIFIKE PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBIENTEVE DHE LIDHJEN E KONTRATAVE TË VEÇANTA ME BASHKËPUNËTORË TË JASHTËM OSE FIGURA TË NJOHURA SHQIPTARE NË DIASPORË, TË CILAT NEVOJITEN TË KRYHEN ME QËLLIM ZBATIMIN DHE REALIZIMIN E PROGRAMIT VJETOR TË AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS DHE QË NUK RREGULLOHEN NGA LEGJISLACIONI NË FUQI PËR PROKURIMIN PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10/1, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me



propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe procedurave specifike për realizimin e aktiviteteve që realizon Agjencia Kombëtare e Diasporës, për:

- a) marrjen me qira të ambienteve;
- b) kontratat e veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë;
- c) veprimtari që zhvillohen jashtë Republikës së Shqipërisë.

2. Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Aktivitete/evente”, organizime, si: takime, konferenca, veprimtari kulturore, artistike, që organizohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, mbështetur në planin e veprimit të përcaktuar në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën;

b) “Bashkëpunëtorë të jashtëm”, ata persona fizikë që angazhohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, për shkak të cilësive të veçanta që disponojnë dhe për zbatimin e veprimtarive, sipas kontratave të lidhura me parë me ta;

c) “Figura të njohura të diasporës”, personalitete të spikatura të diasporës në fusha të ndryshme që japin kontribute të konsiderueshme për vendin e origjinës.

3. Objekti i konkurrimit dhe kriteret që zbatohen për procedurën e konkurrimit:

a) Agjencia Kombëtare e Diasporës përgatit dhe u dërgon ftesat për pjesëmarrje në aktivitetet personave fizikë apo juridikë. Objekti i konkurrimit përmban:

- i. përshkrimin e aktivitetit;
- ii. kriteret e pjesëmarrjes në aktivitet;
- iii. afatin kohor të paraqitjes së ofertave.

b) Kriteret për marrjen me qira të ambienteve janë, si më poshtë vijon:

i. Ambienti të ofrojë kushte optimale për realizimin e aktivitetit dhe të sigurojë hapësirën e nevojshme për pjesëmarrësit;

ii. Ambienti të jetë lehtësisht i aksesueshëm.

c) Kriteret që duhet të plotësojnë bashkëpunëtorët e jashtëm/figura të njohura të diasporës janë, si më poshtë vijon:

i. të kenë marrë pjesë në aktivitete të mëparshme;

ii. të kenë dhënë kontribut për vendin e origjinës;

iii. t'u jenë akorduar çmime kombëtare apo ndërkombëtare;

iv. të ketë ekspertizë në fushën për të cilën zhvillohet aktiviteti.

4. Procedura e përzgjedhjes

a) Komisioni i posaçëm, përgjegjës për zbatimin e procedurës së konkurrimit, ngrihet me urdhër të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe kryen këto detyra:

i. harton kriteret që duhet të përmbushë oferta;

ii. përgatit dhe dërgon ftesat për pjesëmarrje;

iii. në datën e caktuar shqyrton ofertat dhe përzgjedh ofertën ekonomike më cilësore, me çmimin më të ulët;

iv. ankesat për procedurën e konkurrimit bëhen pranë Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe shqyrtohen nga një komision i posaçëm, i ngarkuar me urdhër të titullarit të Agjencisë, i ndryshëm nga komisioni i përzgjedhjes së ofertave. Agjencia përgjigjet për shqyrtimin e ankesës brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e saj dhe njofton pa vonesa ankimuesin.

v. pas përfundimit të procedurës, Agjencia Kombëtare e Diasporës njofton subjektin fitues;

vi. procesverbalet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe arkivohen në strukturat përgjegjëse për arkivimin në Agjenci;

vii. raporti përfundimtar miratohet nga titullari institucionit.

b) Titullari i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpallja e fituesit, lidh:

i. kontratë qiraje, sipas modelit të shtojcës I, pjesë integrale e këtij vendimi;

ii. kontratë me bashkëpunëtorët e jashtëm, sipas modelit të shtojcës II, pjesë integrale e këtij vendimi.

5. Aktivitete të Agjencisë Kombëtare të Diasporës që zhvillohen jashtë vendit:

a) Për aktivitetet që zhvillohen jashtë vendit, në rastin e kontratave të qirasë, vlera përcaktohet sipas monedhës së përdorur në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti, konvertuar sipas kursit të këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë;



b) Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e aktiviteteve jashtë vendit, vepron duke u bazuar në rregullat e përcaktuara në këtë vendim, si dhe në kontrata të lidhura ndërmjet palëve, sipas shtojcës 1 dhe shtojcës 2, pjesë integrale të këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË I

KONTRATË QIRAJE MODEL PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBIENTEVE DHE/OSE PAJISJEVE DHE BLERJEN E MALLRAVE

Sot më datë ____ . ____ . ____ nënshkruhet kjo kontratë qiraje (kontrata) nga dhe ndërmjet palëve, si më poshtë: ____ (qiradhënësi) ____ /person fizik/juridik, i/e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me numër unik identifikimi ____, me seli në adresën ____, dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës përfaqësuar nga ____ (qiramarrësi). Këtu më poshtë së bashku referuar si “Palët” dhe veç si “Pala”.

MEQENËSE:

A. Qiramarrësi është person juridik publik në formën e Agjencisë autonome me seli në Tiranë ____ (adresa).

B. Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. ____, datë për “Përcaktimin e rregullave të përgjithshme, kritereve dhe procedurave specifike për marrjen me qira të ambienteve dhe lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik”, qiramarrësi ka depozituar pranë qiradhënësit në datën ____ . ____ . ____, kërkesë për marrjen në përdorim të Faqe|9980

hapësirës ____ m², të ndodhur në ____ (adresa ku ndodhet ambienti, objekt i kontratës së qirasë).

C. (Qiradhënësi) një shoqëri ____ /person fizik/juridik, i/e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi ____, me seli në adresën: ____.

Për sa më sipër dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, Palët bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është marrja me qira e ambientit, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, të hapësirës ndodhur në ____, me sipërfaqe prej ____ m², në administrim të qiradhënësit, sipas specifikimeve bashkëlidhur, si shtojca 1 e kësaj kontrate.

Neni 2 Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është marrja në përdorim e hapësirës ____ m², sipas specifikimeve bashkëlidhur aneksit 1 për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Diasporës, me objekt ____ (vendoset tema e aktivitetit sipas rastit), për periudhën ____.

Neni 3 Kohëzgjatja

1. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

2. Palët bien dakord që kontrata do të përfundojë me përfundimin e afatit dhe nuk do të rinovohet automatikisht pa miratimin e qiramarrësit. Nëse qiramarrësi kërkon rinovimin e kontratës negociohet midis Palëve dhe dakordësia e arritur formulohet si shtojcë e veçantë që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

1. Qiradhënësi dorëzon hapësirën e kërkuar nga qiramarrësi brenda afatit të parashikuar në këtë



kontratë. Në momentin e dorëzimit hartohet procesverbal i marrjes në dorëzim të hapësirës që jepet me qira e cila është pjesë përbërëse e kontratës.

2. Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit. Qiradhënësi ka detyrimin të kujdeset për të mbajtur hapësirën e lënë me qira në gjendjen për të cilët Palët në kontratë kanë rënë dakord.

3. Qiradhënësi është i detyruar të garantojë qiramarrësin për gëzimin e qetë të hapësirës objekt të kontratës gjatë gjithë periudhës së qirasë. Ai garanton qiramarrësin nga çdo pretendim apo të drejta nga Palë të tjera në përdorimin e qetë të objekt qiraje.

4. Qiradhënësi është përgjegjës për sigurimin e infrastrukturës që lidhet me plotësimin e specifikimeve për realizimin e aktiviteteve/ eventeve të parashikuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

5. Qiradhënësi duhet të kryejë, gjatë periudhës së qirasë, të gjitha riparimet, me përjashtim të punimeve për mirëmbajtjen e përditshme që janë në ngarkim të qiramarrësit. Në rast riparimesh urgjente qiramarrësi mund t'i kryejë ato drejtpërdrejt, kundrejt kthimit të shpenzimeve, me kusht që të njoftojë menjëherë qiramarrësin dhe të marrë miratimin e tij.

6. Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke e njoftuar me shkrim të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

1. Qiramarrësi ka të drejtë të përdorë e të gëzojë pronën e marrë në qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

2. Qiramarrësi ka të drejtë të marrë në dorëzim hapësirën e marrë me qira dhe ta përdorë për qëllimin që është parashikuar në kontratë.

3. Qiramarrësi ka detyrimin, që:

a) të përdorë hapësirën objekt të kësaj kontrate, vetëm për qëllimin e parashikuar në nenin 2;

b) të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me objektin e parashtruar pranë qiradhënësit për marrjen në përdorim të hapësirës;

c) të paguajë detyrimin monetar të qirasë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë.

d) qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me nën qira hapësirën e marrë me qira sipas kontratës.

4. Në qoftë se në kohën e dorëzimit, ambienti i dhënë me qira cenohet nga të meta që ulin në mënyrë të dukshme vlerën e përdorimit të kontraktuar, qiramarrësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës ose zbritjen e çmimit të qirasë, përveç kur ai ka pasur dijeni për të metën ose ajo është lehtësisht e dallueshme.

5. Qiramarrësi duhet t'ia kthejë qiradhënësit hapësirën dhe sendet në të njëjtën gjendje që i ka marrë, në përputhje me përshkrimin e bërë nga Palët në kontratë, përveç dëmtimit ose konsumimit të zakonshëm nga përdorimi i sendit, në përputhje me kontratën.

6. Pas përfundimit të aktivitetit qiramarrësi i dorëzon me procesverbal qiradhënësit hapësirën e marrë me qira. Dokumenti bashkëlidhet me dokumentacionin e prokurimit dhe arkivohet në Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

Neni 6

Pagesa e qirasë

1. Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit qiranë në vlerën prej _____ lekësh.

2. Pagesa e qirasë do të bëhet në llogarinë bankare të qiradhënësit nr._____, pranë bankës_____, brenda datës _____, sipas faturës së lëshuar nga qiradhënësi, me emërtimin "Pagesa e qirasë për kohëzgjatjen nga data ____ deri me datë _____, për përdorimin e hapësirës prej _____ m²".

3. Pagesa e qirasë fillon me marrjen në dorëzim të objektit.

Neni 7

Penalitetet

1. Në rast të mospërbushjes së detyrimeve të përcaktuara në kontratë, menjëherë me konstatimin e tyre, qiramarrësi njofton qiradhënësin dhe kërkon përmbushjen e tyre.

2. Në rast se qiradhënësi nuk i përmbush detyrimet sipas njoftimit, qiramarrësi (Agjencia Kombëtare e Diasporës) kryen vetë shpenzimet plotësuese të dokumentuara dhe qiradhënësi është i detyruar të paguajë këto shpenzime, si dhe të



zhdëmtojë qiramarrësin me një penalitet deri 10% të vlerës së kontratës.

Neni 8 Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet me përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kontratës.

2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) me marrëveshje midis Palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore, në atë masë sa nuk mund të ushtrohet veprimtaria e Agjencisë Kombëtare e Diasporës.

3. Kur Palët në kontratë, qiramarrësi apo qiradhënësi shkelin detyrimet e marra përsipër, sipas kontratës dhe specifikimet e parashikuara në aneks të kësaj kontrate.

4. Në rastet e lartpërmendura, kontrata do të zgjidhet me përfundimin e afatit prej 15 ditësh nga data e dërgimit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës.

5. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi duhet të kthejë hapësirën në të njëjtën gjendje që e ka marrë në dorëzim, në të kundërt detyrohet të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha rregullimet ose të paguajë vlerën përkatëse të shpenzimeve të përcaktuara me një ekspert të emëruar me marrëveshje dypalëshe.

6. Me përfundimin e kontratës, qiramarrësi ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga hapësira e ambientit të marrë me qira por pa e dëmtuara.

Neni 9 Dispozitat e fundit

1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në kontratë, Palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil.

2. Kontrata përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve, në lidhje me objektin e saj dhe ka epërsi mbi çdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim midis Palëve.

3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Palëve në lidhje me kontratën apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga Palët për zbatimin e kontratës do të zgjidhet nga Palët me mirëkuptim, në të kundërt zgjidhja e

mosmarrëveshjes do të jetë në kompetencën e gjykatës kompetente.

4. Kontrata është hartuar në katër kopje origjinale, në gjuhën shqipe ose në gjuhën e vendit ku zhvillohet aktiviteti, me të njëjtën vlerë secila.

(Për qiradhënësin)
(emër, mbiemër,
firmë)

(Për qiramarrësin)
(emër, mbiemër
firmë)

SHTOJCA II

KONTRATË TIP ME BASHKËPUNËTORË TË JASHTËM OSE FIGURA TË NJOHURA SHQIPTARE NË DIASPORË

KONTRATË

E lidhur sot, më datë..2021

Mes
Agjencisë Kombëtare të Diasporës
dhe

Z/znj_____, në cilësinë e
bashkëpunëtorit të jashtëm për eventin
“_____”

Data dhe vendi i organizimit_____

Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe
profesionisti/bashkëpunëtori i jashtëm
z/znj_____, në funksion të realizimit me sukses
të aktivitetit “_____”
bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti i kontratës

Marrja nën përgjegjësi e detyrimeve të ndërsjella të Palëve për aktivitetin që do të zhvillohet më datë _____, në (vendi ku do të zhvillohet) _____, me objekt_____. Kjo kontratë lidhet midis Palëve bazuar në ligjin nr. 115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, të ndryshuar, si dhe në nenet 850–876 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.



Neni 2

Detyrimet e Agjencisë Kombëtare të Diasporës

1. Përgatit kërkesat specifike që duhet të plotësojë profesionisti/bashkëpunëtori i jashtëm në përputhshmëri me objektin e aktivitetit.

2. Një muaj para zhvillimit të aktivitetit informon profesionistin/bashkëpunëtorin e jashtëm mbi për zgjedhjen e tij, objektin, vendin dhe datën e zhvillimit të aktivitetit, si dhe merr miratimin e tij për pjesëmarrjen.

3. Vendos në dispozicion të profesionistëve/bashkëpunëtorit të jashtëm të të gjithë teknikës apo faciliteteve të disponueshme për të lehtësuar përgatitjen e tyre.

4. Pagesa e profesionistit/bashkëpunëtorit të jashtëm do të jetë në vlerën _____ lekë ose _____ euro dhe do të kryhet pas përfundimit të aktivitetit.

5. Vendos në dispozicion vlerësimet e bëra nga pjesëmarrësit për eventin.

Neni 3

Të drejtat e Agjencisë Kombëtare të Diasporës

1. Agjencia Kombëtare e Diasporës ka të drejtë të kërkojë nga profesionistët/bashkëpunëtorë të jashtëm, të njihet me materialet që ata përgatisin dhe në marrëveshje me ta të bëjë publikimin e tyre.

2. Për aktivitetet kulturore-artistike mund të asistojë në provat fundore të përgatitjes së tyre.

3. Nëse nuk plotësohen kërkesat specifike të përcaktuara në specifikimet teknike të eventit, Agjencia Kombëtare e Diasporës mund ta prishë në mënyrë të njëanshme këtë kontratë, duke njoftuar më shkrim Palën tjetër ku të shpjegojë arsyet e vendimit të saj.

Neni 4

Të drejtat e profesionistëve/bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Të informohen në kohë për aktivitetin dhe kërkesat specifike për realizimin e eventit.

2. Të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës çdo material në ndihmë të përgatitjes për eventin.

3. Të kërkojë suport teknik të specializuar nga stafi i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Neni 5

Zgjidhja e kontratës

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo kërkesë që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë kontratë, apo shkelja, ndërprerja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit ndërmjet Palëve.

2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 3(tre) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra Palë për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila Palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë gjykatës kompetente.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kontrata hyn në fuqi, në ditën e nënshkrimit nga Palët.

2. Kontrata nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku secilës Palë i vihet në dispozicion një kopje autentike.

**BASHKËPUNËTOR
I JASHTËM**

**PËR AGJENCINË
KOMBËTARE TË
DIASPORËS**

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 7, datë 15.6.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 9, DATË 17.6.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR
KRIJIMIN E NJË BAZE TË DHËNASH
TË POSAÇME PËR ÇËSHTJET E
DHUNËS NË FAMILJE NË GJYKATA
DHE UNIFIKIMIN E REGJISTRIMIT
TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7, pika 3, shkronja “ç”, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor,



UDHËZOJNË:

1. Në udhëzimin nr. 9, datë 17.6.2020, “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”, formulari nr. 1 zëvendësohet me formularin me të njëjtin numër, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor për njoftimin dhe për komunikimin e këtij udhëzimi pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
Naureda Llagami

Formulari nr. 1

Ligji 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithësej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Neni 10	1	2	3	4	5	6	7
Vendime sipas Nenit 10							
Subjekte sipas Nenit 13							

Ligji 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithësej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Neni 10, pika 1	1	2	3	4	5	6	7
Pika 1.a							
Pika 1.b							
Pika 1.c							
Pika 1.ç							
Pika 1.d							
Pika 1.dh							
Pika 1.e							
Pika 1.ë							
Pika 1.f							
Pika 1.g							
Pika 1.gj							
Pika 1.h							
Pika 1.i							
Pika 1.j							
Pika 1.k							
Pika 1.l							
Pika 1.ll							
Pika 1.m							
Pika 1.m/1							
Neni 13	1	2	3	4	5	6	7
Pika 1.a							
Pika 1.b							
Pika 1.c							
Pika 2.a							
Pika 2.b							
Pika 2.c							
Pika 2.ç							
Pika 2.d							
Pika 2.dh							
Pika 2.e							
Pika 3.a							
Pika 3.b							
Pika 3.c							
Pika 3.ç							
Pika 3.d							
Pika 3.dh							

**URDHËR****Nr. 139, datë 2.7.2021****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, germës “b” dhe “ç”, të nenit 13 dhe germës “a”, të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, si dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 7 dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 30, të Rregullores “për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, e ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të znj. Laerta Rooze. Me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të kryer procedurat dhe nënshkruar aktet në emër të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për marrjen në përdorim të godinës ku ushtron veprimtarinë Kolegji i Posaçëm i Apelit, sipas përcaktimit në VKM- në nr. 518, datë 29.9.2017, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit, institucion i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga ligji nr. 84/2016, VKM-në nr. 230, datë 26.4.2018, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për rikonstruksionin e hyrjes kryesore për Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe legjislacionit në fuqi.

2. Znj. Laerta Rooze nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Albana Shtylla

VENDIM**Nr. 143, datë 16.6.2021**

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s MBI KËRKESËN E SHOQËRISË W.T.S.
- ENERGJI SHPK, PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS NR. 16, SERIA PV04P,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 39,
DATË 22.7.2004, TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 15 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 92/1 prot., datë 14.6.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “W.T.S. - ENERGJI” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE-s për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 4.5.2021, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “W.T.S. - Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P, miratuar me vendimin nr. 39, datë 22.7.2004, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshuar me vendimin nr. 26, datë 9.4.2009 dhe vendimin nr. 115, datë 7.10.2013, të bordit të ERE-s.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me njoftimin për modifikim licence nr. 6/13 prot., datë



4.5.2021, u krye njoftimi në medien e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “W.T.S. - Energji” sh.p.k.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 617/3 prot., datë 11.6.2021, shoqëria “W.T.S. - Energji” sh.p.k. paraqiti kërkesën për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s, për të mundësuar paraqitjen e disa dokumenteve dhe argumenteve shtesë të kërkuara, në përputhje me rregulloren e sipërcituar.

- Kërkesa e “W.T.S. - Energji” sh.p.k., rezulton e depozituar brenda afatit të përcaktuar në nenin 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative”, i cili përcakton, se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

- Po ashtu, “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 14, pika 3, të saj përcakton, se: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “W.T.S. - Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 16, seria PV04P në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 118/10, datë 6.7.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi projektit “Rigjenerim urban i shëtitores bregdetare qendrore të Vlorës, sheshit 'Isa Boletini' dhe Portit, Bashkia Vlorë”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 70,237,995.34 (shtatëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e katër) lekë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë” është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 70,237,995.34 (shtatëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA REALIZIMI PROJEKTTT “RIGJENERIM URBAN I SHËTTTORES BREGDETARE QENDRORE TË VLORËS, SHESHIT 'ISA BOLETINI' DHE PORTIT, BASHKIA VLORË”

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe e pronës “truallt”	Sipërfaqe e pronës ndërtesë	Sip. truallt që preket nga projekti	Çmimi i truallit, lek/m ²	Vlera e truallit, lek	Sipërfaqe ndërtimi	Vlera e ndërtimit me situacion, lek	Vlera e truallit dhe e ndërtesës	Shënime
1	8602	33/22	Vlorë	Loni Llambro	Truall	750		273	10,903	2,976,519		-	2,976,519	Mungon dosja e origjinës
2	8602	33/23	Vlorë	Safet Abazi	Truall	800		20	10,903	218,060		-	218,060	
3	8602	28/147	Vlorë	Augusto Agolli	Truall	49		49	10,903	534,247		-	534,247	
4	8602	28/153	Vlorë	Bp. Inataj, Karagiannidis, vino, Murri	Truall	190		190	10,903	2,071,570		-	2,071,570	
5	8602	28/121	Vlorë	Flavio Bejleri, Ardian Dauti	Truall	2015.2		2015.2	10,903	21,971,726		-	21,971,725.60	
6	8602	28/120	Vlorë	Flavio Bejleri, Ardian Dauti	Truall	439.18		439.18	10,903	4,788,380		-	4,788,379.54	
7	8602	28/92	Vlorë	Rudina Hitaj	Truall	200	200	200	10,903	2,180,600	200	3,950,786	6,131,386	Ka 2 hipotekime banke. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh
8	8602	28/95 T	Vlorë	Shpresa Taushani	Truall	460		460	10,903	5,015,380		-	5,015,380	RVP
9	8602	29/85-Nd. 1	Vlorë	Shpresa Taushani	Ndërtesë		235				235	8,787,943	8,787,943	RVP. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh
10	8602	28/95-Nd. 2	Vlorë	Shpresa Taushani	Ndërtesë		16				16			Të dyja pronat 29/85-ND1 dhe 28/95-ND2 janë llogaritur në një situacion të vetëm.
11	8602	28/48/5	Vlorë	Edmond Rexho	Truall	498	67	498	10,903	5,429,694	67	2,954,938	8,384,632	Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh
12	8602	28/111	Vlorë	BP Çela, Mehmeti	truall	346	98.6	346	10,903	3,772,438	98.6	2,310,454	6,082,892	Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh
13	8602	27/46	Vlorë	Liri Gjijnuri	Truall	335		127.7	10,903	1,392,313		-	1,392,313.10	
14	8602	27/41	Vlore	BP Hondro	Truall	300		78.2	10,903	852,615		-	852,614.60	
15	8602	28/34-T	Vlore	Aldo, Fatmira Serjani	Truall	900		94.5	10,903	1,030,334		-	1,030,333.50	
VLERA TOTALE PARAPRAKE								4,791	10,903	52,233,874.34	617	18,004,121.00	70,237,995.34	

Shënime:

1. Për vlerësimin e pasurive të llojit “tokën truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016, ku për ZK 8603 është 10,903 lekë/m².

2. Për vlerësimin e pasurive të llojit “ndërtesë”, çmimi/m² është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërbimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë